



Ludwig Boltzmann Institute
of Human Rights (BIM)


ANALIZË E GJENDJEVE NË PËRFSHIRJEN SOCIALE NË NIVEL LOKAL



ВЛАДА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
МИНИСТЕРСТВО ЗА ТРУД
И СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА

TETOR, 2010


Financed by

Austrian
 Development Cooperation



Analizë e gjendjeve në përfshirjen sociale në nivel lokal

Tetor, viti 2010



financed by

Austrian
 Development Cooperation

Botues

Lludvig Bolltman Instituti për të drejtat e njeriut – BIM FV Shkup

Përgatitja dhe botimi i këtij publikimi financiarisht është përkrahur nga Bashkëpunimi austriak për zhvillim (ADC)

Përgatitje

Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave në R.M. - ESE

Projekt

Të drejtat njerëzore dhe përfshirja sociale në Maqedoni
Lludvig Bolltman Instituti për të drejtat njerëzore (BIM FV Shkup)
Rr. Velko Vllahoviq nr. 1A-1/4 1000 Shkup
Tel: +389 (0)2 3216 956
Faks: +389 (0)2 3216 982

Zyra përkrahëse e BIM – FV në Shkup

Petranka Dellova Milladinova – Drejtuese e projektit
Stojan Mishev – Këshilltar për të drejta njerëzore
Ninosllav Mlladeoviq – Këshilltar për të drejta njerëzore
Jagoda Iljov – Asistent administrativ

Person për përkrahje nga Ministria për punë dhe politikë sociale

Irena Todoroska - Udhëheqëse e sekcionit për përfshirje sociale

Qëndrimet e shprehura këtu si dhe ato të autorëve jo gjithmonë e shfaqin qëndrimin zyrtar të *Lludvig Bolltman Institutit për të drejtat e njeriut (BIM-FV)* dhe *Bashkëpunimit austriak për zhvillim (ADC)*

Në vend të parafjalës

Ky botim është përgatitur për nevojat e Llundvig Bolltman Institutit për të drejtat e njeriut – BIM FV Shkup, në suazat e projektit *Përfshirja sociale dhe të drejtat njerëzore në Maqedoni*. Qëllimi i projektit është zbatimi i qasjes së bazura mbi të drejtat njerëzore në sferën e uljes së varfërisë dhe ç'kyçjes sociale në nivel kombëtar dhe lokal; gjë e cila përfshin identifikimin e grupeve të prekshme, përfshirjen e tyre të drejtëpërdrejtë në proceset e sjelljes së vendimeve të cilat ndikojnë mbi jetën e tyre, si dhe themelimin e sistemit të vëzhgimit dhe përgjegjësisë së bartësve të detyrave. Subjekt i kësaj analize ishte verifikimi i gjendjes, gjegjësisht nevojave lidhur me përfshirjen sociale në nivel lokal në 6 komunat e ardhshme: Shtip, Prilep, Kërçovë, Saraj, Çashkë dhe Radovich.

Dokumenti është i qëlluar për njësitë e qeverisjes lokale, Ministrinë për punë dhe politikë sociale, shoqatat qytetare, organizatat ndërkombëtare etj., si bazë për njohjen e gjendjeve aktuale me varfërinë, diskriminimin dhe ç'kyçjen sociale, si dhe planifikimin e masave dhe aktiviteteve adekuate për tejkalimin e të njejtave. Rekomandimet e përmbajtura në të njejtën, janë një bazë solide për përmirsim të politikave, strategjive dhe planeve vepruese në sferën e përfshirjes sociale, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal.

Kjo analizë do të jetë bazë për veprimin e Platformës maqedonase kundër varfërisë – PMKV. Gjegjësisht, në suazat e të së sivjetshmes fushatë për luftë kundër varfërisë dhe ç'kyçjes sociale të cilën e organizoi PMKV, më sakt tribunat e organizuara me përfaqësues të grupeve të prekshme, në një pjesë të komunave të cekura u prezantua një pjesë e zbulimeve të kësaj analize.

Shpresojmë se e njejtja do të paraqesë bazë për themelimin e bashkëpunimit të ardhshëm mes BIM-FV me komunat e përfshira, me qëllim të përmirësimit të jetës së grupeve më të prekshme dhe të varfëra të popullatës lokale.

PËRMBAJTJE:

1. Titulli, qëllimet dhe metodologjia e hulumtimit	5
2. Përfshirja sociale dhe bartësit e saj në Republikën e Maqedonisë	9
3. Gjendjet me përfshirjen sociale nga perspektiva e institucioneve kompetente dhe qytetarëve	13
3.1. Njësitë e vetëqeverisjes lokale	13
3.2. Qendra për punë sociale	22
3.3. Të dhëna nga fokus grupet e organizuara	30
4. Sfera brengosëse	34
4.1. Njësi të vetëqeverisjes lokale	34
4.2. Qendra për punë sociale	37
4.3. Të dhëna nga fokus grupet e organizuara	39
5. Rekomandime	41
5.1. Njësi të vetëqeverisjes lokale	41
5.2. Qendra për punë sociale	44
5.3. Rekomandime lidhur me grupet e prekshme	45
6. Gjendjet me përfshirjen sociale nga perspektiva e institucioneve kompetente dhe qytetarëve veçmas në secilën komunë	47
A. Komuna e Sarajit	47
B. Komuna e Kërçovës	57
C. Komuna e Çashkës	66
Ç. Komuna e Radovishit	76
D. Komuna e Shtipit	85
DH. Komuna e Prilepit	99

1. Titulli, qëllimet dhe metodologjia e hulumtimit

Titulli: Analizë faktike për përcaktimin e gjendjeve dhe nevojave për përfshirje sociale në nivel lokal.

Qëllime të hulumtimit: Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është përcaktimi i gjendjeve dhe nevojave për përfshirje sociale në nivel lokal, me theks të veçantë mbi sferat e ardhshme:

- Sigurimi i shërbimeve sociale nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale, qendrat për punë sociale dhe aktorë të tjerë në nivel lokal;
- Mekanizma për identifikim të grupeve të varfëra dhe të prekshme;
- Mekanizma për mbrojtje dhe përkrahje të grupeve të varfëra dhe të prekshme;
- Mekanizma për konsultim dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal dhe kombëtar;
- Identifikim i diskriminimit struktural lidhur me qasjen në shërbimet sociale (përfshirje sociale dhe mbrojtje sociale);
- Identifikimi i problemeve strukturale lidhur me përfshirjen sociale dhe varfërinë në nivel lokal dhe kombëtar.

Metodologjia: Analiza faktike ka për qëllim që ta vlerësojë diskrepancën mes politikës sociale të përcaktuar me ligj, në krahasim me zbatimin faktik në nivel lokal në gjashtë komunat e përzgjedhura. Për qëllimet e kësaj analize u përfshinë gjashtë komuna edhe atë: Saraj, Çashkë, Kërçovë, Prilep, Shtip dhe Radovish. Gjatë përzgjedhjes së tyre u morrën parasyshë parimet e përfaqësues gjeografike, karakteristikat demografike, heterogjenizmi etnik dhe parimi i përfshirjes urbane/rurale.

Procesi i metodologji përbëhet prej:

- zbatimit të intervistave me profesionistët relevant në nivel lokal nga ana e skuadrës eksperte të ESE dhe
- organizimi i fokus grupeve me popullatën në komunat e përfshira.

Për këtë qëllim u përgatitën dy pyetësor (për përfaqësues të QPS dhe përfaqësues të pushtetit lokal), si dhe skenari për organizimin e fokus grupeve.

Pyetësori për komunën përbëhet nga shtatë pjesë tematike edhe atë sipas kompetencave, sferës/punës dhe veprimin të cilin komuna e kryen në sferën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. Përmes pjesëve tematike qëllueshëm që të përcaktohen dhe analizohen gjendjet lidhur me çështjet e ardhshme:

1. Mekanizma institucionale për mbrojtje sociale,
2. Programe dhe plane vepruese për mbrojtje sociale në nivel lokal, duke përfshirë edhe programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve,
3. Mekanizma për konsultime dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal dhe kombëtar dhe bashkëpunimi mes institucioneve relevante nga sfera e mbrojtjes sociale dhe shoqatave qytetare,
4. Mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme,
5. Dhënia e shërbimeve sociale nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale,
6. Përmirësim i gjendjes së personave socialisht të rrezikuar dhe
7. Investime kapitale dhe infrastrukturë në sferën e mbrojtjes sociale.

Për krijimin e pyetësorit për komunitat dhe më vonë analizën e të njëjtit u përdorën ligjet e ardhshme:

1. Ligji për vetëqeverisje lokale i R.M.(Gazeta zyrtare nr. 5/2002);
2. Ligji për mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e R.M. nr. 79/2009) dhe
3. Ligji për financimin e njësisve të vetëqeverisjes lokale (Gazeta zyrtare e R.M. nr. 61/2004, 96/2004, 67/2007 dhe 156/2009).

Përpos ligjeve u përdorën edhe burime të tjera:

- Statutet e komunave të përfshira;
- Raportet vjetore për punën e komunave të përfshira;
- Programet për punë të këshilleve të komunave të përfshira dhe
- Planet vepruese dhe programet nga sfera e mbrojtjes sociale (Komuna e Çashkës, Kërçovës, Shtipit dhe Radovishit).

Pyetësori për qendrat për punë sociale përbëhet nga pesë pjesë tematike edhe atë sipas kompetencave, punës dhe veprimit të cilin e kanë qendrat për punë sociale në sferat e tyre të veprimit. Përmes pjesëve tematike qëllorë që të përcaktohen dhe analizohen gjendjet lidhur me çështjet e ardhshme:

1. Identifikim i grupeve të varfëra dhe të prekshme;
2. Shërbime dhe qasje në shërbimet e qendrave për punë sociale;
3. Previcion dhe përkrahje e grupeve të varfëra dhe të prekshme;
4. Konsultim dhe pjesëmarrje e grupeve të varfëra dhe të prekshme dhe
5. Bashkëpunim i qendrave për punë sociale me pushtetin lokal dhe institucionet/organizatat tjera.

Për krijimin e pyetësorit për qendrat për punë sociale dhe më vonë analizimin e tyre u përdorën ligjet e ardhshme:

1. Ligji për mbrojtje sociale (Gazeta zyrtare e R.M. nr. 79/2009);
2. Ligji për familje (Gazeta zyrtare e R.M. nr. 84/2008, 67/2010) dhe
3. Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (Gazeta zyrtare e R.M. nr. 98/2000, 17/2003, 65/2004, 113/2005, 98/2008, 107/208, 83/2009, 156/2009).

Në secilën nga gjashtë komunitat e identifikuar u intervistuan nga dy pjesëmarrës të cilët punojnë në sferën e mbrojtjes sociale dhe atë:

- Përfaqësues i pushtetit lokal – përfaqësues nga Sektori/Sekcioni për çështje juridike dhe të përgjithshme, nën mandatin e të cilit është edhe mbrojtja sociale (me përjashtim të Komunës së Sarajit, në të cilën intervista u realizuar me sekretarin e komunës dhe Komuna e Shtipit, në të cilën intervista u realizuar me përfaqësuesin e Sekcionit për zhvillim ekonomik lokal) dhe
- Përfaqësues nga Qendra për punë sociale e cila regjionalisht e përfishin komunitetin e identifikuar.

Përfaqësuesit e intervistuar të komunave dhe qendrave për punë sociale të përfshirë në këtë analizë janë të ardhshmit:

Njësi të vetëqeverisjes lokale

- **Komuna e Sarajit** – intervista u realizua me Z. Xhelaj Jakupi, sekretar i komunës së Sarajit.
- **Komuna e Kërçovës** – intervista u realizuar me Z. Marjan Dimovski, udhëheqës i Sektorit për çështje juridike dhe të përgjithshme në komunën e Kërçovës.
- **Komuna e Çashkës** – intervista u realizuar me Znj. Bojanka Mirova, udhëheqës i Sekcionit për çështje juridike dhe të përgjithshme në komunën e Çashkës.
- **Komuna e Radovishit** – intervista u realizuar me Znj. Olivera Dudullova, udhëheqës i Sektorit për çështje normativo-juridike, të përgjithshme dhe publike në komunën e Radovishit.
- **Komuna e Shtipit** – intervista u realizuar me Znj. Vishna Shorova – Angelova, bashkëpunues në Sekcionin për zhvillim ekonomik lokal.
- **Komuna e Prilepit** – intervista u realizuar me Z. Marjan Prodanoski, udhëheqës i Sekcionit për çështje juridike në komunën e Prilepit.

Qendra për punë sociale

- **Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale** – intervista u zbatuar me Znj. Penka Nikolloska, punonjës social, udhëheqës i Sekcionit për punë sociale të njësive rajonale të qytetit të Shkupit.
- **Qendra për punë sociale - Kërçovë** – intervista u zbatuar me Znj. Dragica Naumovska, punonjës social në Qendrën për punë sociale në Kërçovë.
- **Qendra për punë sociale – Veles** – intervista u realizuar me Znj. Nada Trajkova, drejtoreshë e Qendrës për punë sociale në Veles.
- **Qendra për punë sociale – Radovish** – intervista u realizuar me Znj. Pavlinka Petrusheva, punonjës social në Qendrën për punë sociale në Radovish.
- **Qendra për punë sociale - Shtip** – intervista u realizuar me Znj. Natalija Panova, drejtoreshë e Qendrës për punë sociale në Shtip.
- **Qendra për punë sociale – Prilep** – intervista u realizua me Z. Zoran Mallkovski, punonjës social në Qendrën për punë sociale në Prilep.

Përpos intervistave u organizuan edhe nga dy fokus grupe në secilën prej komunave. Të njëjtat u organizuan me popullatën e përgjithshme, me qëllim të sigurimit të informatave relevante për gjendjen faktike të grupeve të prekshme lidhur me qasjen në të drejtat bazike, llojet e diskriminimit me të cilat ato ballafaqohen dhe mekanizmat për konsultime dhe pjesëmarrje në nivel lokal.

Fokus grupet u organizuan sipas kriterëve të ndryshme, në pajtim me specifikat e komunave të përzgjedhura, gjegjësisht në shumicën e komunave kriter primar për organizimin e fokus grupeve ishte përkatësia etnike e popullatës dhe pastaj

gjinia e tyre. Vetëm në një nga komunat, fokus grupet u formuan sipas kriterit të vendbandimit të banorëve në atë komunë, gjegjësisht urbane/rurale ndërsa kriteri sekondar ishte gjinia.

1. Komuna e Sarajit: fokus grupe me shqiptarë/shqiptare dhe maqedonasë/maqedonase;
2. Komuna e Çashkës: fokus grupe me maqedonasë/maqedonase, shqiptarë/shqiptare dhe turqë/turke;
3. Komuna e Kërçovës: fokus grupe me maqedonasë/maqedonase dhe shqiptarë/shqiptare;
4. Komuna e Prilepit: fokus grupe me romë/rome dhe maqedonasë/maqedonase;
5. Komuna e Radovishit: fokus grupe me maqedonasë/maqedonase nga mjedise urbane dhe rurale;
6. Komuna e Shtipit: fokus grupe me maqedonasë/maqedonase dhe romë/rome.

Ky raport është konceptuar në një mënyrë e cila do të japë një pikturë gjithëpërfshirëse për gjendjen dhe trajtimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme në secilën nga komunat e përfshira, të cilat janë subjekt i kësaj analize dhe atë nga perspektiva e aktorëve kryesor në këtë sferë:

1. Njësitë e vetëqeverisjes lokale;
2. Qendrat për punë sociale dhe
3. Qytetarët, gjegjësisht grupet e prekshme.

Përpos të gjeturave, raporti përmban sfera të identifikuara brengosëse dhe rekomandime për institucionet relevante në nivel lokal (njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe qendrat për punë sociale).

2. Përfshirja sociale dhe bartësit e saj në Republikën e Maqedonisë

Çdoherë kur flasim për konceptin e përfshirjes sociale, atë e shohim si të kundërtën e ç'kyçjes sociale, që do të thotë ç'kyçje të shumëfishtë të individëve ose grupeve nga pjesëmarrja në jetën ekonomike, sociale dhe politike, në vendin në të cilin jetojnë.¹ Mirëpo, për të kuptuar më mirë se çfarë paraqet përfshirja sociale, më së pari duhet të definohet koncepti i ç'kyçjes sociale.

Koncepti i ç'kyçjes sociale konceptualizohet përmes proceseve dhe dimensioneve të ndryshme sociale në jetën e përditshme: ekonomike, kulturore, kufizim mental ose fizik, ç'kyçje politike ose institucionale.

Nga kjo nënkuptohet se, ç'kyçja sociale është rezultat i një procesi kompleks dhe jo rezultat i varfërisë më veti. Prandaj ç'kyçja sociale duhet të kuptohet si kornizë e një strukture sociale e cila përfshin më tepër sfera:

- sferën politike (si një sistem i shpërndarjes demokratike);
- sferën ekonomike (tregu i punës dhe instrumente të tjera të integritimit ekonomik);
- sistemin social (sistem i mirëqenies dhe integritimit social);
- sistemin e bashkësisë dhe familjes.²

Sipas kësaj, përfshirja sociale duhet të paraqesë krejtësisht një proces të kundërt, i cili do të ndryshojë kushtet dhe shprehjet të cilat çojnë në ç'kyçje sociale. Përfshirja sociale duhet të përmbledhë më tepër elemente: të jetë proces, strategji dhe të jetë objektive zhvillimore në afat të gjatë. Ajo duhet të paraqesë një përgjigje të koordinuar për sistemin e komplikuar të problemeve nga sfera politike, ekonomike, sociale, kulturore, shëndetësore dhe e gjitha sfera shoqërore e jetesës njerëzore.

Përfshirja sociale duhet t'ju sigurojë grupeve më të prekshme dhe më të marginalizuara në shoqëri pjesëmarrje më të madhe në procesin e sjelljes së vendimeve, me çfarë do t'ju mundësojë që ta përmirësojnë të gjithë standardin dhe mirëqenien jetësore³. Ajo duhet të jetë korrekтив i shërbimeve të cilat ofrohen në nivel kombëtar dhe lokal, me qëllim që të njejtat t'ju sigurohen sipas kushteve të njejtat të gjithë grupeve në shoqëri.

Për këtë qëllim, duhet të mobilizohen të gjithë aktorët në nivel kombëtar dhe posaçërisht në atë lokal, që të mundësojnë që përfshirja sociale të jetë imperativ zhvillimor për të gjithë qytetarët, duke filluar nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, shoqatat qytetare, personat fizik dhe juridik dhe të ngjajshme.

Bartësit e përfshirjes sociale në nivel lokal janë njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe qendrat për punë sociale.

¹ Hilary Silver, "Social Exclusion: Comparative Analysis of Europe and Middle East Youth", Middle East Youth Initiative Working Paper (September 2007), f. 15

² http://www.europace.org/s2net/docs/Soc_incl_discus.doc, e qasur më 28.10.2010.

³ www.combatpoverty.ie, e qasur më 28.10.2010.

Kompetenca e njësive të vetëqeverisjes lokale lidhur me këtë çështje është e përcaktuar me **Ligjin për vetëqeverisje lokale, Ligjin për mbrojtje sociale dhe Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.**

Ligji për vetëqeverisje lokale⁴ paraqet kornizë bazike juridike, përmes të cilit realizohet procesi i decentralizimit. Përmes këtij ligji, komuna, në pajtim me politikën ekonomike të shtetit, financohet nga burime vetanake të të ardhurave si dhe nga burime të tjera të financimit.⁵

Njësitë e vetëqeverisjes lokale si bartës kryesor të mbrojtjes sociale janë përgjegjëse për **themelimin** e institucioneve publike për mbrojtje sociale, **zhvillim** të formave jashtë-institucionale për mbrojtje sociale dhe **realizimin** e programeve sociale në bashkëpunim me segmentet tjera në sektorin publik, sektorin privat dhe shoqatat joqeveritare.

Në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale⁶, komunat dhe qyteti i Shkupit janë kompetente për:

- mbrojtje sociale dhe mbrojtje fëmimore – çerdhet fëmimore dhe shtëpitë e të moshuarve (pronësi, financim, investime dhe mirëmbajtje);
- realizimin e kujdesit social për personat me invaliditet;
- fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror;
- fëmijët me probleme edukativo-sociale;
- fëmijët me nevoja të posaçme;
- fëmijët nga familjet me një prind;
- fëmijët në rrugë;
- personat e ekspozuar në rrezik social;
- personat që keqpërdorin drogë dhe alkool;
- rritjen e vetëdijes së popullatës,
- banimin e personave në rrezik social;
- realizimin e së drejtës dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore.

Qyteti i Shkupit dhe komunat mund të themelojnë institucion publik për **mbrojtje jashtë-institucionale dhe institucionale** në bazë të miratimit i cili do të jetë në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale, përveç qendrës për punë sociale dhe institucion edukues publik për vendosje të fëmijëve dhe të rinjve me sjellje asociale.⁷

Ligji për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale⁸ i definon dhe veçmas i përpunon burimet e të ardhurave, dhe atë si të hyra vetjake të komunave si dhe ato të cilat sigurohen si transfere nga buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe buxhetet e fondeve si dhe mundësia e financimit përmes huazimit.⁹

Të hyrat vetanake duhet të sigurojnë pavarësi funksionale dhe financiare të komunave të përcaktuara me Ligjin për financim të vetëqeverisjes lokale:

- tatimet lokale (tatimet e pronës dhe tatime të tjera lokale të përcaktuara me ligj);
- taksat lokale (taksta komunale, taksat administrative dhe taksa të tjera të përcaktuara me ligj);

⁴ Gazeta zyrtare e R.M. nr. 5/2002

⁵ Neni 11 i Ligjit për vetëqeverisje lokale, Gazeta zyrtare e R.M. nr. 5/2002.

⁶ Njejt, neni 22.

⁷ Neni 87 nga Ligji për mbrojtje sociale.

⁸ Gazeta zyrtare e R.M. nr. 61/2004, 96/2004, 67/2007 dhe 156/2009.

⁹ Njejt, neni 3.

- kompenzimet lokale (kompenzim për rregullim të tokës ndërtimore, kompenzime komunale, kompenzime për plane hapsinore dhe urbane dhe kompenzime të tjera të përcaktuara me ligj);
- të ardhura nga prona (të ardhura nga qiraja, nga kamata dhe nga shitja e pronës me të cilën nuk prishet zbatimi i funksioneve publike dhe kompetencave të Komunës);
- pjesë e të ardhurave nga tatimi personal i fitimit të paguar në vitin vijues (100% i paguar nga personat fizik të cilët kryejnë veprim zejtarë në territor të komunës në pajtim me Ligjin për veprim zejtar dhe 3% nga të ardhurat e tatimit personal nga të hyrat personale të personave fizik me banim të përhershëm ose qëndrim në komunën përkatëse);
- të hyra dhe vetëkontribute;
- të hyra nga dënimet në para të përcaktuara me ligj;
- të hyra nga donacionet dhe
- të hyra tjera të përcaktuara me ligj.

Më në fund, Qeveria e Republikës së Maqedonisë në bazë të Ligjit për financim të njësive të vetëqeverisjes lokale (*Gazeta zyrtare e R.M. nr. 61/2004, 96/2004, 67/2007 dhe 156/2009*), miraton Rregulloren për metodologjinë e shpërndarjes së të hyrave nga tatimi i vlerës së shtuar nëpër komuna.

Qendrat për punë sociale si bartëse kyresore të kësaj çështjeje kanë kompetencë dhe në përdorimin dhe zbatimin e programeve dhe akteve të tjera të përgjithshme nga sfera e mbrojtjes sociale, të miratuara dhe financuara nga komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe inkurajimi, organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve vullnetare të qytetarëve, shoqatave të tyre, organizatave humanitare, shoqatave për zbatim të programeve për mbrojtje sociale në territorin e komunës, qytetit të Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit.

Në bazë të drejtave nga mbrojtja sociale, ndërsa nën kushte të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje sociale, QPS ndërmarrin masa përmes të cilave realizohet **preventiva sociale, mbrojtja jashtë-institucionale dhe institucionale dhe ndihmë në para nga mbrojtja sociale.**¹⁰

Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton **Program kombëtar për zhvillim të mbrojtjes sociale**, në të cilin përcaktohen qëllimet, prioritetet dhe drejtimet e zhvillimit të mbrojtjes sociale të qytetarëve të R.M., me masa të politikës sociale aktive në afat të mesëm dhe të gjatë.¹¹ Më tej, qeveria, miraton program për realizimin e mbrojtjes sociale me të cilin i përcakton sferat e mbrojtjes sociale, nevojat e popullatës, preventivën sociale dhe mënyrën dhe mjetet për realizimin e të njejtës.

Komuna, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit mund të sigurojnë realizim të mbrojtjes sociale për:

- personat me invaliditet,
- fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror,
- fëmijët me pengesa në zhvillimin mental dhe fizik,
- fëmijët në rrugë,
- fëmijët me probleme edukativo-sociale,
- fëmijët nga familjet me një prind,
- personat të ekspozuar në rrezik social,
- personat që keqpërdorin drogë, supstanca tjera psiko-tropike, prekurzorë dhe alkool,

¹⁰ Njejt, neni 6.

¹¹ Njejt, neni 4.

- personat viktima të dhunës familjare,
- personat viktima të tregtisë me njerëz,
- personat në moshë pa kujdes familjar.

përmes formave të mbrojtjes sociale jashtë-institucionale¹² dhe institucionale¹³, banimit të personave të ekspozuar në rrezik social, rritje të vetëdijes së popullatës për nevojë e sigurimit të mbrojtjes sociale, në pajtim me dispozitatat nga Ligji për mbrojtje sociale¹⁴.

Me masa dhe aktivitete për **preventivë sociale** parandalohet krijimi i rreziqeve sociale, bëhet zbulim i hershëm dhe trajtim i hershëm i qytetarit të ekspozuar në rrezik social, me qëllim të tejkalimit ose zbutjes të pasojave të dëmshme nga ekspozimi në rrezik social.¹⁵

Për realizimin e preventivës sociale ndërmerren masa për parandalimin e krijimit të rrezikut social tek qytetari, familja ose grupi i njerëzve, posaçërisht përmes punës edukativo-këshilluese, zhvillim të formave të vetë-ndihmës, punë vullnetare me angazhim personal dhe zbatimit të metodave tjera të cilat janë në pajtim me nevojat e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale.¹⁶

¹² Mbrojtje jashtë-institucionale e përfshin të drejtën e: shërbimit të parë social për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale, ndihmë për një person, ndihmë familjare, kujdes shtëpiak dhe ndihma për një person dhe familje, përkujdesje ditore dhe e përkohshme dhe strehim si ndihmë për një person apo familje, vendosje në familje përkujdesëse, vendosje në shtëpi të vogël grupore dhe banim i pavarur me përkrahje. (neni 26 nga Ligji për mbrojtje sociale)

¹³ Mbrojtja institucionale përfshin të drejtën e aftësisimit për aktivitet punueso-prodhues dhe të drejtën e vendosjes në institucion për mbrojtje sociale (neni 41 nga Ligji për mbrojtje sociale)

¹⁴ Njejt, neni, 11.

¹⁵ Njejt, neni 24, alinea 1.

¹⁶ Njejt, neni 25, alinea 1.

3. Gjendjet me përfshirjen sociale nga perspektiva e institucioneve kompetente dhe qytetarëve

3.1.Njësi të vetëqeverisjes lokale

3.1.1. Mekanizma institucionale të mbrojtjes sociale në komuna

Mbrojtja sociale në njësitë e vetëqeverisjes lokale zhvillohet në dy aspekte: **1. përmes të punësuarve në administratën komunale dhe 2. përmes komisioneve të përhershme të Këshillit të komunave të cilat punojnë në sferën sociale, mbrojtje fëmimore, arsim, sport dhe kulturë.** Prej këtu, mekanizmat institucionale për mbrojtje sociale më poshtë janë të konceptuara përmes këtyre dy mekanizma, ndërmjetësisht të ndërlidhura.

1. Në pajtim me të miratuarin sistematizim të vendeve të punës, në katër nga gjashtë komunat e identifikuar ekzistojnë sektore për punë juridiko-normative dhe publike. Në komunat Saraj dhe Çashkë, si komuna rurale, ekzistojnë sekcione për punë të përgjithshme dhe juridike. Në këto sektore, gjegjësisht sekcione, në sferën e veprimeve sociale të punësuarit në administratën komunale, punojnë në sferën sociale, mbrojtjen fëmimore, shëndetësore, sport dhe kulturë. Në pesë, nga gjashtë komunat e identifikuar, nuk ka person të punësuar në administratën komunale, i cili punon vetëm në sferën e mbrojtjes sociale. Personat të cilët janë të punësuar në sekcionet për zhvillim ekonomik lokal, zakonisht punojnë me çështjet e mbrojtjes sociale, në korelacion me sekcionin, gjegjësisht me sektorin për punë publike. Në Komunën e Prilepit ka këshilltarë për kulturë dhe arsim, si pjesë e administratës komunale, mirëpo nuk merren me sferën e mbrojtjes sociale.

Komuna e Çashkës është e vetmja komunë nga të identifikuarat, e cila ka person veçmas të punësuar – bashkëpunor për shëndetësi, mbrojtje sociale dhe civile, në suazat e Sekcionit për arsim, kulturë, shëndetësi, mbrojtje sociale, sport dhe bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve dhe fondacioneve. Komuna e Sarajit aspak nuk ka person i cili punon në sferën e mbrojtjes sociale, i cili është pjesë e administratës komunale. Personi i cili ka punuar në Sekcionin për resurse njerëzore e ka braktisur vendin e punës dhe që atëherë vendi s'është plotësuar.

2. Lidhur me trajtimin e mbrojtjes sociale brenda komisioneve, si trupa për ndihmë të këshillit të komunave, në katër nga gjashtë komunat e identifikuar ekzistojnë komisione të përhershme, të cilat edhe pse në secilën komunë ndryshe emrohen, (Komun e Kërçovës - Komision për shëndetësi, Komuna e Radovishit - Komisioni për shëndetësi dhe mbrojtje sociale, Komuna e Shtipit - Komision për punë shoqërore, Komuna e Prilepit – Komision për punë shoqërore dhe të drejtat fëmimore, ndërsa në Komunën e Çashkës në suazat e Komisionit për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave trajtohen edhe çështjet e mbrojtjes sociale) punojnë në sferën e mbrojtjes sociale. Komisionet përbëhen prej pesë anëtarëve, të cilët janë anëtarë të Këshillit të komunave.

Saraji është komuna e vetme e cila nuk ka komision të përhershëm për mbrojtje sociale, ndërsa në Komunën e Çashkës, Komisioni për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave, i cili është komision i përhershëm i Këshillit, i trajton çështjet e mbrojtjes sociale, shëndetësinë dhe arsimin e grave. Në këto dy komuna, nëse

paraqitet problem nga kjo sferë i cili duhet të zgjidhet, thirret ad hoc komision i përbërë nga të punësuarit dhe anëtarët e Këshillit të komunës të cilët i trajtojnë çështjet nga sfera e mbrojtjes sociale.

3.1.2. Programe dhe plane vepruese nga sfera e mbrojtjes sociale, përfshirë edhe programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve

Sa i përket programit për mbrojtje sociale në vetë komunat, vetëm tre nga komunat e identifikuar kanë program shumëvjeçar për mbrojtje sociale.

Komuna e Shtipit, është komuna e vetme nga të identifikuarat e cila përpos programit për mbrojtje sociale, ka edhe Plan lokal për veprim për periudhën 2007-2012. Plani i veprimit është përpiluar sipas grupeve synese në Komunë dhe për secilin grup të synuar ka program dhe plan për veprim. Është përgatitur dhe detajisht është përpiluar buxhet për realizimin e aktiviteteve. Afatet për realizimin e aktiviteteve nuk janë qartësisht të definuara. Në plotësim, kjo komunë ka përgatitur edhe Plan lokal për veprim për të drejtat femënore për periudhën 2009-2014. Plani është ndarë në gjashtë programe, gjegjësisht qëllime strategjike, mirëpo nuk ka kornizë kohore dhe buxhet të përpikët për realizimin e aktiviteteve. Në Komunën e Shtipit janë realizuar aktivitete nga të dy planet – Plani veprues për mbrojtje sociale dhe Plani veprues për të drejtat femënore.

Komuna e Sarajit është komuna e vetme, në të cilën asnjëherë s'është miratuar program dhe plan veprues për mbrojtje sociale.

Komuna e Prilepit nuk ka program dhe plan veprues për mbrojtje sociale por ka përgatitur tre plane lokale për veprim dhe atë: Plan veprues për të drejtat femënore (2009-2013), Plan lokal për veprim për personat me hendikep (2008-2010) dhe Plan lokal për veprim për punësim 2009-2010. Nuk ka informata për atë se çfarë nga këto plane është realizuar.

Në Komunën e Radovishit vetëm në vitin 2007, është miratuar Plan veprues për mbrojtje sociale, mirëpo aktivitetet e tij nuk janë zbatuar. Që prej atëherë nuk është miratuar një plan i tillë.

Në Komunën e Kërçovës ekziston program pune për mbrojtje sociale, femënore dhe shëndetësore për vitin 2010, i përgaditur nga një punonjës në administratën komunale, i cila nuk është miratuar nga Këshilli i Komunës edhe pse një pjesë e aktiviteteve të tij janë të zbatuara. Për këtë program nuk është përgatitur plan veprues, as kornizë e përshtatshme kohore për zbatim të aktiviteteve. Gjegjësisht, programi i përgatitur përbëhet nga 10 projekte. I konceptuar në këtë mënyrë, ai është shumë i përgjithshëm, pa qëllime specifike dhe rezultate evidente nga zbatimi eventual i tij.

Në Komunën e Çashkës ekziston program për zhvillimin e arsimit, sportit, kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për vitet 2009-2013. Edhe në këtë plan mungon korniza kohore dhe plani veprues. Në Komunën e Çashkës është zbatuar një aktivitet nga ky program.

Në të gjitha gjashtë komunat e identifikuar në suazat e komisioneve të këshilleve të komunave nuk ka program pune për mbrojtje sociale.

Në të gjitha planet ose programet vepruese ekzistuese mungon kornizë sistematike për ndjekje të progresit të aktiviteteve të zbatuara nga ana e trupave koordinative të formuara. Përgatitja e raporteve për projektet e realizuara bëhet ad hoc, nëse kjo është e nevojshme për qëllimet e hulumtimit. Kjo bëhet nga ana

e të punësuarve në administratën komunale dhe jo edhe nga anëtarët e këshillit të cilët në të njëjtën kohë janë edhe anëtarë të trupit koordinues.

Në shumicën e planeve dhe programeve vepruese mungon buxhet përshtatshëm i konceptuar, si dhe tregues specifik për ndjekjen e gjendjeve.

Në asnjërën nga komunat e identifikuar nuk janë miratuar programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve.

Në komunat ka bashkëpunim ndër-sektoral dhe bashkëpunim i administratës komunale dhe komisionet për mbrojtje sociale gjatë krijimit të planeve dhe programeve vepruese.

3.1.3. Mekanizma për konsultime dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal dhe kombëtar dhe bashkëpunimi mes institucioneve relevante nga sfera e mbrojtjes sociale dhe shoqatat qytetare

Në të gjitha komunat mungon mekanizëm formalisht i pëcaktuar për pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal. Komunikimi me qytetarët bëhet përmes kontakteve të drejtëpërdrejta, nëse qytetarët drejtohen në komunë për të kërkuar ndonjë ndihmë të caktuar, përgatitje të dokumenteve dhe të ngjajshme, ose gjatë krijimit të planeve dhe projekteve lokale.

Bashkëpunimi qytetarë në komuna më së shpeshti ndodh përmes kryetarëve të bashkësive urbane, gjegjësisht bashkësive lokale, të cilët i tregojnë problemet e vendbanimeve të tyre.

Pjesëmarrja e drejtëpërdrejtë e qytetarëve në komunat, lidhur e çështjet të cilat janë në interes lokal, bëhet përmes iniciativave qytetare, tubimeve të qytetarëve dhe referendumit, në pajtim me nenin 25, alinea 1 nga Ligji për vetëqeverisje lokale, që si iniciativë është shumë pak prezente.

Komuna e Çashkës është e vetmja komunë, në të cilën është inicuar iniciativë qytetare e organizuar sipas rregullave normative, lidhur me hapjen e qendrës ditore për personat e moshuar në fshatin Bogomillë.

Të gjitha aktet e miratuara nga këshillet e komunave shpallen në gazetën zyrtare të komunave, pjesë e informatave shpallen në ueb faqen, ndërsa në disa komuna mediat informohen përmes gazetës elektronike (për shembull në Prilep dhe Shtip).

Sa i takon bashkëpunimit të komunave me shoqatat qytetare, është notuar tendenca e bashkëpunimit kryesisht në aktivitete projektuese, në të cilat shoqatat qytetare realizojnë takime për bashkëpunim me komunën. Komunat në përgjithësi i thirrin shoqatat qytetare për konsultime dhe pjesëmarrje në grupe punuese në rast kur duhet të përgatiten plane apo programe të caktuara vepruese. Megjithatë, ekziston mungesë e kontinuitetit në këtë bashkëpunim lidhur me vëzhgimin e projekteve të zbatuara në komunë nga ndonjë program apo plan veprues i caktuar, në të cilin vëzhgim duhet të përfshihen shoqatat qytetare.

Komunat bashkëpunojnë me qendrat për punë sociale kryesisht në fitimin e informatave për marrësit e llojeve të ndryshme të ndihmës. Pjesë e këtij bashkëpunimi lidhet edhe me përfshirjen e pjesëmarrësve të qendrave për punë sociale në krijimin e planeve lokale vepruese si për shembull në komunën e Çashkës, Shtipit dhe Prilepit.

Sidoqoftë, në të gjitha komunat nuk ka bashkëpunim të mjaftueshëm me të gjithë aktorët relevant në nivel lokal sa i takon sigurimit të preventivës sociale.

3.1.4. Mekanizma për identifikimi e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Në asnjërën nga komunat e identifikuara nuk ekziston mekanizëm i përcaktuar për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme. Komunat nuk mbajnë bazë të dhënash për çështje lidhur me mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, me qëllim që ti klasifikojnë të dhënat sipas kategorive të marrësve të ndihmës, sipas kategorive të grupeve synuese etj.

Në të gjitha komunat, të dhënat për listat e personave të cilët fitojnë ndonjë lloj ndihme merren vetëm nga qendrat për punë sociale. Qytetarët të cilët kanë problem ju drejtohen me kërkesë kryetarëve të komunave. Sipas përfaqësuesit të intervistuar nga Komuna e Prilepit, *„këto punë duhet të kryhen vetëm nga Qendra për punë sociale për shkak se Komuna nuk është qendër“*.

Në Komunën e Shtipit, gjegjësisht në Sekcionin për punë publike ekziston një person i cili është përgjegjës për çështjet lidhur me fëmijët dhe mirëmban bazë të dhënash për këtë kategori të personave.

Gjatë përgatitjes së planeve lokale për veprim, komunat më së shpeshti i identifikojnë nevojat e një grupi të caktuar synues. Shumë shpesh në këto plane nuk përfshihen të gjitha grupet synuese të cilat ekzistojnë në komunë. Për shembull, në një komunë të caktuar ekziston grup synues i cili është i mapuar, me të cilën punohet, ndërsa i njejti nuk është e përfshirë si grup i identifikuar synues në planin veprues dhe e kundërta.

Për ilustrim të gjendjeve të këtylla, gjegjësisht për mungesën e mekanizmit të përshtatshëm jua prezantojmë praktikën e cila zbatohet në një pjesë të komunave. Për shembull: në Çashkë, Shtip dhe Radovish, kryetarët e bashkësive lokale e vizitojnë komunën, e cila ju tregon atyre një problem, për të cilin bisedojnë a është i përshtatshëm për tu zgjidhur dhe i njejti vendoset në rendin e ditës të Këshillit të Komunës.

Edhe përpos asaj që praktika e tillë siguron informata të drejtëpërdrejta nga terreni, e njejta nuk siguron efekte gjithëpërfshirëse dhe afatgjata në procesin e identifikimit të grupeve të varfëra dhe të prekshme.

3.1.5. Sigurimi i shërbimeve sociale nga ana e njësisë për vetëqeverisje lokale dhe aktivitete proektuese/programore të realizuara nga fusha e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale

Në të gjitha komunat e identifikuara ndahen mjete financiare nga buxheti komunal për qëllime sociale. Këto mjete sigurohen nga alinea buxhetore – rezerva vijuese. Shuma më e vogël vjetore e mjeteve financiare të ndara për qëllime sociale në komunë urbane (Radovish) për vitin 2009, është 191.200 denarë, ndërsa shuma më e lartë është 1.100.000 denarë (Shtip). Në Komunën e Kërçovës, janë ndarë mjete financiare prej 760.000 denarë, ndërsa në Komunën e Prilepit, 600.000 denarë. Sa u takon komunave rurale, në Saraj janë ndarë mjete financiare në shumë prej 379.400 denarë, ndërsa në komunën e Çashkës 314.464 denarë.

Përveç sigurimit të mjeteve financiare për qëllime sociale, komunat sigurojnë edhe lloj tjetër të shërbimeve sociale, pjesë me pjesëmarrje vetanake dhe një pjesë me pjesëmarrje të pushtetit qendror.

Pesë nga gjashtë komunat (me përjashtim të Sarajit), janë të përfshira në projektin e qeverisë "Kuzhina popullore", përmes të cilit marrësve të ndihmës sociale ju sigurohet ushqim. Numri më i vogël i shfrytëzuesve të këtij shërbimi është 63 (Komuna e Radovishit) dhe më i madhi - 100 persona (Komuna e Prilepit).

Në katër, nga gjashtë komunat e identifikuar (me përjashtim të Sarajit dhe Çashkës), komunat kanë dhënë në shfrytëzim objekte të komunës për qëllimet e qendrave ditore për fëmijët me nevoja të posaçme. Komuna e Shtipit, si pjesë e planit veprues për mbrojtje sociale ka inicuar ndërtimin e infrastrukturës së përshtatshme për personat me nevoja të posaçme dhe në kërkesë të kryetarit të komunës, të gjitha institucionet publike kanë qenë të detyruara që të ndërtojnë hyrje/trape të qasëshme për personat me nevoja të posaçme. Në Komunën e Prilepit, Kërçovës dhe Radovishit janë zbatuar aktivitete për vendosjen e trapeve qasëse përpara të gjitha institucioneve. Komuna e Kërçovës, ka organizuar akcion për markimin e parkimeve për personat me invaliditet, ndërsa Komuna e Prilepit është shpallur si komuna më e qasëshme për vitin 2007.

Në Komunën e Çashkës, komuna përpara 10 viteve ka dhënë objekt i cili për momentin përdor si **Klub për të moshuarit**. Komuna ka hapur edhe një klub të tillë në vendbanimin **Bogomillë**. Në spitalin për sëmundjet e mushkërive "Jasenovo" duhet të hapet njësi për geriatri.

Komuna e Shtipit është e vetmja nga të identifikuarat në të cilën ka aktivitete konkrete të realizuara nga Plani lokal për veprim për mbrojtje sociale dhe Plani lokal për veprim për të drejtat femënore. Në Komunën e Çashkës deri tani është realizuar një aktivitet nga programi për zhvillim të arsimit, sportit, kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për vitet 2009-2013.

Në Komunën e Kërçovës, përmes programit punës për mbrojtje sociale, femënore dhe shëndetësore për vitin 2010, i cila nuk është i miratuar nga Këshilli i Komunës së Kërçovës, u janë dhënë mjete financiare një kategorie të caktuar të njerëzve. Komuna e Kërçovës, personave të cilët marrin ndihmë sociale u jep nga 4 kub dru për familje, kuartalisht. Komuna gjithashtu ka siguruar ndihmë me para për mbrëmjen e maturës për fëmijët pa prindër etj.

Edhe përpos asaj që komunat sigurojnë shërbime sociale, mungon numri i mjaftueshëm i këtyre iniciativave për grupet e prekshme dhe të marginalizuara.

Komunat edhe pse në përgjithësi aplikojnë për projekte të jashtme, jo mjaftueshëm e shfrytëzojnë mundësinë për të aplikuar tek institucionet ndërkombëtare, fondacione dhe donatorë. Zakonisht, njësitë e vetëqeverisjes lokale aplikojnë për projekte nga sfera e mbrojtjes sociale dhe përfshirja, kryesisht kur pushteti qendror shpall konkurse të tilla.

Komuna e Shtipit, sa i takon thirrjes së Ministrisë për punë dhe politikë sociale, ka dorëzuar kërkesë për qendër ditore për fëmijë mbi 18 vjeç me kufizime fizike dhe psiqike. Komuna e Kërçovës përsëri përmes projektit të inicuar nga Ministria për transport dhe lidhje është përfshirë në projektin për përfshirjen e fëmijëve romë në institucionet parashkollore. Gjithashtu, një numër i madh i projekteve të realizuara në procesin arsimor, janë zbatuar me përkrahje financiare nga Ministria për arsim dhe shkencë (për shembull, në Komunën e Prilepit).

Aktivitetet projektuese të realizuara nga ana komunave janë të ardhshmet:

Komuna e Kërçovës, në sferën e banimit posedon baraka për qëndrim të personave në rrezik social, të cilat janë dhënë nga Republika e Bullgarisë në të cilat banojnë 17 familje. Komuna e Kërçovës, përmes diasporës në Australi dhe Amerikë ka shpërndarë paketa ndihme. Është realizuar edhe projekt nga USAID për kursim të energjisë për nxemje me avull.

Komuna e Radovishit, përmes CARDS projektit i ka përforcuar kapacitetet e institucioneve relevante për të zbatuar, vëzhguar dhe vlerësuar efektivisht qëllimet e vendosura në Startegjinë kombëtare për punësim 2010 dhe Planin kombëtar veprues për punësim 2006-2008. Për këtë qëllim është përgatitur edhe **Plani lokal për punësim** për Komunën e Radovishit. Përmes programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara, është zbatuar projekti EMI 2 – për praktikë vullnetare dhe punësimin e personave të rinj me arsim të lartë të cilët janë të papunësuar. Komuna ka realizuar projekt për efikasitet energjetik me të cilin në tre objektet e çerdheve janë ndërruar dyert dhe dritaret, me qëllim të kursimit të energjisë elektrike dhe ndriçimit më të mirë. Me një pjesë të mjeteve të këtij projekti në bulevardin e Komunës së Radovishit është ndërruar ndriçimi, me qëllim që i njëjti të bëhet energjetikisht efikas.

Komuna e Shtipit, përmes programit të UNICEF-it për zhvillim të hershëm femënor, ka organizuar vizitë të fëmijëve të moshës parashkollore dhe të fëmijëve nga vendet rurale, në të cilat nuk ka institucion parashkollor. Për këtë qëllim, Komuna ka organizuar transport, ndërsa për hir të edukimit, në bashkëpunim me universitetin, ka angazhuar profesorë dhe studentë të cilët mund të punojnë me këto fëmijë. Është i vlefshme të përmendet edhe **projekti për ndërtim të shtëpisë për personat e moshuar**. Gjegjësisht, për qëllimet e këtij projekti Komuna e Shtipit ka bërë hulumtim në 5 qytete për rreth komunës (Radovish, Sveti Nikole, Probishtip, Karbinci dhe Vinicë). Janë bërë 800 anketa me qytetarë, nga të cilët 300 janë deklaruar si të interesuar për tu shpërngulur në shtëpinë e të moshuarve në Shtip, sapo e njëjti të ndërtohet. Komuna synon që këtë projekt ta ndërtojë përmes modelit të partneritetit publiko-privat. Në gusht të vitit 2010, është përgatitur dhe është dërguar një projekt deri te donatori potencial për hapjen e **klasave speciale në moshën parashkollore për fëmijët me nevoja të posaçme**.

Komuna e Prilepit në bashkëpunim me shoqatën joqeveritare italiane INTERSOS, dhe më tej edhe me COSVI, e ka realizuar dhe përkrahur projektin Qendër multikulturore në lagjen Trizlla (kryesisht e banuar me popullatë Rome) për përmirësim të kualitetit të jetesës së romëve dhe përmirësim të marrëdhënieve mes bashkësive ekzistuese në Prilep.

3.1.6. Përmirësim i gjendjes së personave socialisht të rrezikuar

Ligji për mbrojtje sociale¹⁷ parasheh që për realizim të së drejtës së ndihmës sociale në para, secila njësi e vetëqeverisjes lokale të ketë mundësi që të angazhojë shfrytëzues të cilët janë të aftë për punë për zbatimin e punëve të interesit publik për punë sezonale dhe të përkohshme.

Në këtë drejtim, në të gjitha komunat e identifikuara janë anagazhuar shfrytëzues të cilët janë të aftë për punë, kryesisht për punë nga sfera komunale. Aktivitetet e tilla në të gjitha komunat kanë ndodhur në vitin 2009 në pajtim me programin e qeverisë për punë publike.

Komuna e Sarajit deri tani ka angazhuar persona prej familjeve të cilat kanë më shumë fëmijë dhe persona të cilët marrin ndihmë sociale, për të kryer kryesisht punë nga sfera komunale. Këtyre personave u ka paguar nga 100 denarë për ushqim dhe 100 denarë për shpenzime rrugore pa honorar shtesë. Përmes Entit për punësim, gjegjësisht programit për të papunësuarit në territorin e Komunës së Sarajit janë përfshirë 100 persona të cilët kanë marrë kompenzim deri më 6.000 denarë në muaj për kryerjen e punëve komunale. Ato kanë qenë të angazhuar për 5-6 muaj, nga shtatori i vitit 2009 deri më janar të vitit 2010.

Komuna e Kërçovës ka angazhuar 30 persona përmes Sekcionit për punë komunale, për zbatimin e llojit të këtyre të punëve sezonale. Angazhimi i këtyre personave është bërë pjesërisht përmes masave aktive për punësim të qeverisë së R.M., ndërsa pjesa tjetër përmes UNDP-së. Komuna, këtyre personave u ka paguar honorar prej 8.500 denarë për zbatimin e kryesisht punëve komunale. Këto angazhime kanë zgjatur pesë muaj.

Në Komunën e Çashkës, përmes projektit të qeverisë, gjegjësisht aktiviteteve për masa aktive për punësim, gjithashtu janë angazhuar 38 persona të papunësuar nga 9 vendbanime për kryerjen e punëve komunale në periudhë gjashtë mujore gjatë vitit 2009.

Në Komunën e Radovishit për një kohë më të gjatë të papunësuarit dhe personat të cilët marrin ndihmë sociale, fitojnë përkrahje financiare prej 6.000 denarë, transport dhe ushqim falas, si dhe sigurim në rast të aksidentit në periudhë prej 6 muajsh. Numri i këtyre personave që kanë kryer punë publike komunale për vitin 2008 ka qenë 45, ndërsa në vitin 2009 numri gati është dyfishuar, gjegjësisht bëhet fjalë për 100 persona të angazhuar për kryerjen e punëve publike.

Në Komunën e Radovishit, përpos angazhimit të personave për kryerjen e punëve sezonale të interesit publik, janë zbatuar edhe aktivitetet dhe masat e ardhshme të përkrahura nga më tepër institucione:

Në territorin e Komunës së Radovishit janë angazhuar 8 persona të papunësuar nga regjionet më të pazhvilluara për kryerjen e punëve ndërtimore. Me këtë masë është siguruar kompenzim për punën e kryer në shumë prej 5.100 denarë, tatim personal dhe kompenzim për ushqim dhe transport në shumë prej 3.200 denarë në muaj për një periudhë 6 mujorëshe.

Me masën për trajnime dhe këshillimi për kualifikime të reja, kontakte me punëdhënës, përmirësim të dijenisë dhe trajnim për kompjutera, është organizuar trajnim për persona të papunësuar me obligim që punëdhënësi ti punësojë personat të cilët me sukses do ta kryejnë trajnimin. Përkrahja është përbërë në dhënie e mjeteve financiare mujore në shumë prej 2.000 denarë për

¹⁷ Neni 55 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 79/2009

punëdhënësin dhe 4.000 denarë për personin e papunësuar në një periudhë 3 mujorëshe. Qendra për punësim në Radovish rregullisht ka organizuar trajnime të tilla për kompjutera dhe gjuhë angleze.

Komuna e Shtipit deri tani përmes programit të qeverisë për zbatim të punëve publike ka angazhuar 50 persona të cilët kanë marrë ndihmë sociale, për kryerjen e kryesisht punëve komunale. Ky aktivitet është zbatuar vetëm në vitin 2009. Komuna ka marrë pjesë me financa vetanake në shumë prej 2.298.920 denarë nga shuma totale prej 4.578.920 denarë. Në plotësim, Komuna e Shtipit ka organizuar kurse për mësimin e gjuhës angleze përmes të cilave kurse rreth 1500 shtipjanë kanë marrë diplomë për kurset e kryera.

Komuna e Prilepit me programin për punë publike ka angazhuar 328 persona për kryerjen e punëve sezonale. Këto persona kanë marrë honorar prej 6.300 denarë për zbatimin e kryesisht punëve komunale. Këto angazhime kanë zgjatur 6 muaj dhe janë realizuar gjatë vitit 2009.

Këto aktivitete, në të gjitha komunat, janë realizuar vetëm në vitin 2009 me përjashtim të Komunës së Radovishit, ku këto aktivitete janë realizuar që nga viti 2008.

Në të gjitha komunat mungon plan strategjik për përmirësimin e gjendjes së grupeve të varfëra dhe të prekshme. Nga aspekti tjetër, në komuna mungon bashkëpunimi aktiv me biznes sektorin për iniciativa donuese, për përmirësim të gjendjes së grupeve të prekshme dhe të marginalizuara. Në të gjitha komunat mungon aktiviteti i vazhdueshëm për angazhimin e punonjësve të aftë për punë për kryerjen e punëve publike. Masa varet nga mjetet financiare të pushtetit qendror dhe nuk është e përhershme.

3.1.7. Investime kapitale dhe infrastrukturë në sferën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale

Të gjitha komunat e identifikuar kanë hyrë në fazën e dytë të decentralizimit. Komuna e Radovishit është komuna e parë nga të identifikuarat e cila ka hyrë në fazën e dytë të decentralizimit, që në vitin 2005. Komunat e Sarajit, Shtipit dhe Prilepit kanë hyrë në fazën e dytë të decentralizimit në vitin 2009, ndërsa Kërçova në vitin 2010. Si të tilla, komunat përveç pronësimit të objekteve të cilat i kanë trashëguar gjatë procesit të decentralizimit ose i kanë ndërtuar, kanë detyrë që të njejtat ti financojnë, të investojnë në ta dhe ti mirëmbajnë.¹⁸

Në këtë drejtim, të gjitha komunat e involvuara kanë kontribuar në infrastrukturë, kryesisht në institucionet e moshës parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme.

Komuna e Sarajit, në shkollën fillore **ka ndërtuar 6 klasa shtesë**, dhe përpos kësaj ka **kontribuar me 50% nga buxheti komunal në ndërtimin e një ure**, ndërsa 50% për ndërtimin e urës janë siguruar nga qytetarët e komunës.

Komuna e Kërçovës në çerdhe ka ndërtuar edhe një pjesë shtesë për personat me nevoja të posaçme.

Në Komunën e Çashkës, si komunë rurale është hapur qendër ditore për personat e moshuar në vendbanimin e Çashkës dhe në vendbanimin Bogomillë.

¹⁸ Neni 22 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 5/2002.

Komuna e Radovishit në institucionin për moshën parashkollore, në periudhën 2005-2010, ka investuar prej 4.500.000 deri më 5.000.000 denarë pjesëmarrje vetanake komunale në infrastrukturë. Në plotësim, ka investuar në një shkollë të mesme dhe në një filllore dhe atë si kontribut për kanalizimin atmosferik (SHF) dhe rindërtim të çatisë në shkollën e mesme.

Komuna e Shtipit ka filluar me ndërtimin e lulishtes së re feminare në lagjen "Senjak" dhe e ka vendosur gurë themelin për ndërtimin e dy klasave shtesë në ndërtesën e çerdhes. Më në fund, komuna i ky bërë aktivitetet përgatitëse për ndërtimin e 6 klasave dhe një salle sportive në shkollën filllore.

Komuna e Prilepit, është e vetmja nga të lartëpërmendurat, e cila ka investuar më së shumti, edhe atë në shkollat fillore dhe të mesme, në bashkëpunim me Ministrinë për arsim dhe shkencë dhe një projekt infrastrukturual me ndihmën e një OJQ-je italiane. Komuna ka bërë renovim në tre shkolla fillore dhe dy të mesme. Në një nga shkollat fillore e cila gjendet në lagjen "Trizlla", në të cilën shumica e nxënësve janë të nacionalitetit rom, Komuna ka investuar në renovimin e dyshemeve, korridoreve, mureve dhe tavaneve, gjë me të cilën janë siguruar kushte më të mira për zbatimin e mësimin dhe integritetin mes dy grupeve etnike. Nga investimet kapitale në sferën sociale, Komuna e Prilepit në vitin 2008 ka investuar 600.000 denarë investim vetanak në ndërtimin e parkut zbavitës për fëmijë. Investimet totale janë në shumë prej më tepër se 3.000.000 euro.

Në katër, nga gjashtë komunat e identifikuara, ekzistojnë qendra ditore për personat me nevoja të posaçme, me përjashtim të komunës së Sarajit dhe Çashkës. Këtu medoemos të ceket se Komuna e Çashkës ka dorëzuar kërkesë deri tek Ministria për punë dhe politikë sociale për hapjen e një qendre të tillë ditore.

Komuna e Kërçovës është komuna e vetme në të cilën ka shtëpi për personat e moshuar.

Në katër, nga gjashtë komunat, ekzistojnë qendra ditore për personat e moshuar me përjashtim të Komunës së Prilepit dhe Sarajit.

Shtipi është e vetmja komunë në të cilën në një nga shkollat fillore ka klasë për fëmijët me autizëm. Në plotësim, Shtipi është edhe e vetmja komunë në të cilën është hapur qendër ku personat e varur nga droga e marrin terapinë e tyre dhe një herë në javë bisedojnë me psikolog.

Komuna e Sarajit është e vetmja komunë në të cilën nuk ekziston qendër ditore për personat me nevoja të posaçme, shtëpi për personat e moshuar dhe qendër ditore për personat e moshuar.

Komunat e Çashkës dhe Sarajit nuk kanë institucione për moshën parashkollore.

Në të gjitha komunat mungojnë programe ose qendra për zhvillim të hershëm feminor. Deri tani, Shtipi është e vetmja komunë e cila ka zbatuar një masë të tillë në suazat e çerdhes ekzistuese.

3.2. Qendra për punë sociale

3.2.1. Identifikimi i grupeve të varfëra dhe të prekshme

Në komunat ku u zbatua hulumtimi, qendrat për punë sociale i identifikuan kategoritë e ardhshme të personave të prekshëm: **persona të moshuar, persona me nevoja të posaçme, rom, pakica dhe konsumues të drogës. Në asnjërën nga komunat aspak nuk njihen nevojat e personave me orientim të ndryshëm seksual.** Personat të cilët gjenden në rrezik social nuk janë mjaft të mbrojtur nga ligji, funksioni i të cilit paraqet parandalim dhe tejkalim të reziqeve sociale kryesore në të gjitha komunat. Gjithashtu, kërkuesit e ndihmave në para, për shkak të kriterëve të cilat ligji i përcakton, nuk kanë mundësi që ti realizojnë të drejtat që i kanë të garantuara me ligj.

Personat e moshuar si klientë të QPS, paraqiten atëherë kur gjenden në rrezik social, që kanë të bëjnë me reziqe të pleqërisë dhe rrezik të shëndetit. Personat e moshuar nuk kanë mundësi që të plotësojnë një pjesë të kushteve të parashtruara me Ligjin për mbrojtje sociale dhe Ligjin për familje, dhe mu për shkak të kësaj ju shkurtohen të drejtat të cilat i kanë të garantuara me ligj (shiqo informatat nën pikën 2.2. në këtë raport). Shuma e ndihmës në para nga mbrojtja sociale e cila ju dedikohet personave të moshuar, nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e nevojave bazike ekzistenciale.

Gratë si kategori e prekshme më së shpeshti paraqiten si viktima të dhunës familjare, nëna të vetme dhe shfrytëzuese të së drejtave të mbrojtjes sociale. Viktimat e dhunës familjare për shkak të pasigurisë ekonomike dhe banuese nuk e paraqesin dhunën familjare dhe nuk e braktisin dhunuesin. Sa i takon shfrytëzimit të ndihmave në para, gratë ballafaqohen me një sërë problemesh për shkak se shumica e parave nga ndihma sociale nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e nevojave bazike ekzistenciale. Me probleme të veçanta gjatë shfrytëzimit të së drejtës së ndihmës në para ballafaqohen gratë të cilat janë në proces të divorcit. Këto gra nuk kanë të drejtë të marrin ndihmë në para derisa të sillen vendimi përfundimtarë për divorcin. Duke e ditur se procedurat e divorcit mund të zgjasin prej disa muajve deri në më tepër se një vit, edhe koha për të aplikuar për shfrytëzimin e ndihmës në para po shtyhet. Pas procedurës për divorc, gratë të cilat janë të papunësuara mund të paraqiten në Agjencinë për punësim dhe të fitojnë sigurim shëndetësor duke e dhënë si dëshmi vendimin në fuqi lidhur me divorc. Nëse e marrim parasysh se në shumicën e rasteve fëmijët jetojnë me nënën, përveç nënës edhe fëmijët i shfrytëzojnë të drejtat nga mbrojtja sociale. Gjithashtu, është e rëndësishme të ceket se gjatë bashkësisë martesore, si bartës i sigurimit të mbrojtjes shëndetësore paraqitet burri (mund të jetë në bazë të punësimit ose papunësisë). Në të dy rastet, anëtarët e tjerë të familjes shfrytëzojnë mbrojtje shëndetësore përmes atij i cili është i siguruar.

Fëmijët si kategori e prekshme paraqiten në më tepër raste edhe atë: gjatë proceseve të divorcit dhe në proceset e vizitave me prindërin me të cilin nuk jetojnë; fëmijët si viktima sekondare të dhunës familjare; fëmijë të abuzuar; fëmijë të lënë pas dore nga aspekti edukativ; delikuentë; fëmijë pa prindër dhe fëmijë pa kujdes prindëror; fëmijë si shfrytëzues të kompenzimit fëmënor dhe kompenzimit të posaçëm fëmënor. Shuma e kompenzimit në para nga kompenzimi fëmënor dhe kompenzimi i posaçëm fëmënor nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e nevojave bazike ekzistenciale të fëmijëve.

Personat me hendikep paraqiten si kategori e prekshme në të gjithë komunat. Në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale, paraqiten si shfrytëzues të kompenzimeve në para. Shuma e kompenzimeve në para nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e nevojave bazike ekzistenciale të kësaj kategorie të personave.

Romët si kategori e prekshme paraqiten në shumicën e komunave, me përjashtim të komunës së Çashkës. Tek kjo bashkësi etnike ende ekzistojnë bashkësitë tradicionale jashtë-martesore të të miturëve, varfëria si dhe tek fëmijët e komunitetit rom është prezente delikuenca e mitur dhe braktisja e procesit arsimor. Numri më i madh i romëve paraqiten si shfrytëzues të ndihmës sociale në para.

Pakicat janë prezente në të gjitha komunat. Në secilën komunë dominon përfaqësi e ndryshme etnike e qytetarëve. Problemi më i shpeshtë me të cilin ballafaqohen është pamundësia për të fituar nënshtetësi. Si kategori e prekshme ata paraqiten si shfrytëzues të të gjitha kompenzimeve në para nga mbrojtja sociale.

Konsumuesit e drogës njihen si kategori e prekshme e posaçme, jo vetëm në nivel kombëtar por edhe në nivel lokal. Si rezultat i përpjekjeve të Ministrisë për punë dhe politikë sociale në disa vende të caktuara, gjegjësisht disa qendra për punë sociale kanë krijuar këshilltore dhe qendra ditore për këto persona. E vetmja këshilltore er cila ekziston për këtë kategori të personave është në territorin e qytetit të Shkupit. Kjo këshilltore në pajtim me mandatin e saj duhet të japi një sërë të shërbimeve siqë janë: drejtimi i shfrytëzuesve të drogës deri tek institucionet tjera; punë këshillë-dhënëse; përkrahje psiko-sociale dhe trajtim; drejtimi deri tek disa shoqata qytetare të caktuara të cilat janë të specializuara dhe ofrojnë ndihmë për këtë kategori si dhe ndihmë juridike. Për dallim të këshilltores në më tepër qytete, gjegjësisht komuna funksionojnë edhe qendra ditore për këtë kategori të personave, të cilat mundësojnë zbatimin e aktiviteteve të fokusuara dhe të dedikuara vetëm për ta. Nga komunat të cilat ishën subjekt i këtij hulumtimi kështu qendër ditore ka vetëm në Komunën e Shtipit. Është e vlefshme të përmendet se metodologjia, gjegjësisht mënyra e punës së këtyre qendrave ditore atje ku janë të formuara është e ndryshme. Gjegjësisht, diku këto qendra menaxhohen nga ana e QPS ndërsa në disa vende ajo bëhet në bashkëpunim me institucionet shëndetësore me çfarë mundësohet qasje më përfshirëse gjatë punës me këtë kategori të personave.

Personat me orientim të ndryshëm seksual: për dallim të konsumuesve të drogës, të cilët njihen, personat me orientim të ndryshëm seksual, duke e pasur parasysh faktin se nuk njihen si kategori e prekshme në nivel shoqëror aspak, edhe nuk trajtohen në shtetin tonë. Kjo gjendje është karakteristike edhe në nivel kombëtar edhe në nivel lokal. Në këtë aspekt derisa ekziston mungesa për kuptimin e nevojave të kësaj kategorie do të mungojë edhe reagimi zyrtar për sigurim të mbrojtjes adekuate dhe përmbushjes së nevojave të tyre.

Në bazë të gjendjes faktike të qendrave për punë sociale është përcaktuar se nuk kanë mekanizma dhe mënyra të posaçme për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme. Qendra për punë sociale (më tej në tekst QPS) identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme e përcakton individualisht, gjegjësisht përmes drejtimit të drejtëpërdrejtë të klientëve në QPS dhe përmes kontrollit të drejtëpërdrejtë tek kërkuesit e ndonjë të drejte. Në të gjitha QPS u cek se për shkak të mungesës së personelit profesional, veturës terrenike dhe kushteve të përshtatshme për punë nuk kanë mundësi që ti identifikojnë grupet e varfëra dhe të prekshme.

3.2.2. Shërbime dhe qasja në shërbime në Qendrën për punë sociale

Të gjitha QPS si institucione publike për mbrojtje sociale, me ingerenca publike për zbatimin e punëve nga sfera e mbrojtjes sociale, veprojnë në pajtim me ligjet sipas të cilave kanë ingerenca për të vepruar, si dhe sipas mandatit të tyre.

QPS zakonisht shërbejnë më tepër se dy komuna dhe më së shpeshti janë të vendosura në komunat më të mëdha. Në komunat më të vogla dhe rurale nuk ka përfaqësi të QPS. Mungesa e përfaqësive në vendet rurale paraqet problem për shkak se qytetarët janë të detyruara që të udhëtojnë deri tek QPS më e afërt. Me këtë në plotësim vështirësohet gjendja e tyre financiare.

Identifikuam më tepër pengesa me të cilat qytetarët ballafaqohen në realizimin e të drejtave të tyre nga sfera e mbrojtjes sociale, të cilat si mungesa strukturale zvarriten në të gjitha komunat në të cilën bëjnë përcaktim të gjendjes faktike. Në këtë aspekt të gjitha pengesat e më poshtme, të cilat i kufizojnë/pamundësojnë grupet e varfëra dhe të prekshme, janë të vlefshme për të gjitha komunat dhe nuk përsëriten në tekstin e më tutjeshëm. Kështu që, **Ligji për mbrojtje sociale parasheh kushte të caktuara për fitimin e ndihmës në para mes të cilave kushte edhe kufizimin e të ardhurave në amvisërinë e kërkuesit**, për shkak të cilit klientët e interesuar nuk mund ti realizojnë të drejtat e tyre nga mbrojtja sociale. Për shembull, në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale për fitim të ndihmës së përhershme në para në bazë të pleqërisë dhe sëmundjes, kërkuesi – anëtarët në familjen e tij nuk duhet të kenë të ardhura mujore më të mëdha se 4.000 denarë për person. Nëse ndodh që kjo shumë të tejkalohet, qoftë edhe për një denarë, atëherë kërkuesi nuk do të ketë të drejtë që ta realizojë këtë lloj të ndihmës në para. Kërkuesit e ndihmës së përhershme në para në bazë të pleqërisë dhe sëmundjes nuk duhet të kenë më tepër se 5 vite eksperiencë pune. Personat të cilët kanë eksperiencë pune prej 6 deri më 14 vite, ndërsa i plotësojnë kushtet tjera nuk kanë të drejtë që ti realizojnë këto të drejta.

Gjithashtu, **familje me më tepër gjenerata të cilat jetojnë në një amvisëri ndeshen me problem në fitimi e ndihmës në para**. Në këtë mënyrë në vend që t'ju kushtohet kujdes nevojave për ndihmë anëtarëve të familjes së kërkuesit të ndihmës në para, merren parasysh të ardhurat e ndonjë anëtari të familjes më të gjërë si bazë për dhënien e ndihmës në para. Përcaktuam se përpos rasteve të cekura nga praktika në realizimin e ndihmës në para, pengesë paraqet edhe kujdesi dhe ndihma e supozuar nga familja e afërt. Kështu kërkuesit e ndihmës në para intervistohen dhe investigohen lidhur me mundësitë për ndihmë dhe përkrahje të cilën mund t'ja japin familjarët e afërt, duke mos i marrë parasysh lidhjet e tyre të ndërmjetëshme (lidhje familjare të prishura). Në rast kur familjarët e afërt nuk mund ta japin ndihmën e nevojshme, atëherë nga qendra për punë sociale incohet padi penale. Kërkuesi, duke e pasur parasysh përgjegjësinë kriminale të familjarëve të afërt, automatikisht e tërheq kërkesën për ndihmë në para.

Gjithashtu, vërtetuam edhe një **mungesë të caktuar lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të shtesës feminare**. Gjegjësisht, kusht për ta shfrytëzuar këtë të drejtë është ajo që njëri ose të dy prindërit duhet të jenë të punësuar. Me këtë kusht pengohen prindërit të cilët nuk janë të punësuar, gjegjësisht shfrytëzuesit e ndihmës në para. E njëjta vlen edhe për prindërit të cilët janë të punësuar dhe marrin të ardhura me të larta nga ato të cilat i parasheh ligji për ta fituar këtë shtesë. Përpos kësaj, sipas ligjit (Ligji për mbrojtje feminare), shtesa feminare mund të jepet në një shumë prej maksimum 2.415 den (40 euro), pa e marrë parasysh numrin e fëmijëve në atë familje. Ndihmë e njëhershme në para në disa prej qendrave momentalisht nuk mundësohet ose është e kufizuar për shkak

të mungesës së mjeteve financiare nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale (në tekstin e mëtutjeshëm MPPS).

Nga ana tjetër, mjetet nga të gjitha format e ndihmës në para nga sfera e mbrojtjes sociale dhe nga Ligji për mbrojtjen e fëmijëve nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave bazike ekzistenciale të personave të cilët i shfrytëzojnë këto lloje të mbrojtjes. Për shkak të kësaj, shfrytëzuesit e ndihmave në para edhe përpos asaj që mbrohen me Ligjin për mbrojtje sociale dhe me Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, ende gjenden nën rrezik social. Kjo në veçanti ka të bëjë me shumën e ndihmës sociale në para, e cila shumë nuk është fikse dhe zvoglohet sipas gjatësisë kohore të shfrytëzimit. Nga kjo del nevoja që ndihma në para të llogaritet individualisht për çdo rast, gjegjësisht e njejtat të llogaritet sipas nevojave – shpenzimet e aplikuesit (shporta shpenzuese në shtetin tonë nuk i përfshin shpenzimet për veshje, shpenzimet e regjisë dhe nevojat tjera të një familjeje, kështu që nuk paraqet një bazë relevante për përcaktimin e lartësisë të ndihmave në para). Në plotësim, gjendja e shfrytëzuesve të të gjitha llojeve të ndihmës në para vështirësohet për shkak të sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm. Një pjesë e dokumentacionit sigurohet me pagesën e një shume të caktuar. Si problem shtesë me të cilin ballafaqohen klientët gjatë dorëzimit të kërkesës për ndihmë në para është procedura për nxjerrjen e letërnjoftimit. Takimet për nxjerrjen e letërnjoftimit të ri në Ministrinë për punë të brendshme caktohen në një afat më të gjatë kohor. Pa këtë dokument për identifikim personal, klienti nuk mund të bëjë kërkesë në QPS.

Në të gjitha QPS të cilat ishën të përfshira në hulumtim, nga numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të ndihmave në para të të gjitha llojeve, në një përqindje më të madhe janë të përfaqësuar shfrytëzuesit e ndihmës sociale në para. Kjo kategori e qytetarëve është e aftë për punë dhe gjenden në rrezik social për shkak të papunësisë. Sipas dëshmive të shumicës së përfaqësuesve të QPS, u cek se shumicën e kohës së tyre në punë jua dedikojnë kësaj kategorie të qytetarëve dhe kjo është arsyeja përse nuk mund të kushtojnë më tepër kohë për pjesën profesionale të detyrave të tyre të punës. Me qëllim që në mënyrë adekuate të përmbushen nevojat e qytetarëve është e nevojshme që të lehtësohet puna administrative, gjegjësisht janë të mendimit se shërbimet e ndihmës sociale në para duhet ti kryej Agjencia për punësim, siqë ka funksionuar ndonjëherë. Klientëve kjo do t'ju ndihmojë duke ju mundësuar që mos të duhet që dy herë në muaj ta vërtetojnë statusin e papunësisë (për momentin ato duhet këtë status ta vërtetojnë një herë në muaj edhe në QPS edhe në Agjencinë për punësim).

Të gjitha QPS, shfrytëzuesve të ndihmës sociale dhe ndihmës së përhershme në para, ju japin edhe lloje tjera të ndihmës. Nga ky vit (viti 2010), jepen subvencione për energji elektrike në shumë prej 600 denarë në muaj. Gjithashtu, të gjitha QPS kanë hapur kuzhina popullore. Kuzhinat popullore ju mundësojnë shfrytëzuesve të ndihmave një ushqim në ditë, mirëpo numri i ushqimeve është i kufizuar dhe nuk është i qasëshëm për të gjithë shfrytëzuesit e ndihmës sociale. Me këtë lloj ndihmë përfshihet vetëm një pjesë e familjeve më të rrezikuara. Vetëm QPS në Veles ka siguruar kuzhinë ditore e cila i shërben shfrytëzuesit të cilët jetojnë në vendet rurale. Në disa QPS për shkak të numrit të kufizuar të ushqimeve, të njejtat ju jepen vetëm bartësve të të drejtave të ndihmës në para, ndërsa jo edhe për anëtarët tjerë të familjes së tij (bashkë-shfrytëzuesit e ndihmës në para).

Disa nga QPS me qëllim që ta bëjnë këtë shërbim të qasëshëm për të gjithë klientët, shfrytëzuesve ju mundësojnë që këtë shërbim ta shfrytëzojnë në kohëzgjatje prej një viti. Vitin e ardhshëm këtë shërbim e shfrytëzojnë shfrytëzues të tjerë. Shkak kryesor për kufizimin e këtij lloji të shërbimit janë mjetet e pamjaftueshme financiare të cilat i siguron MPPS.

Sa u takon llojeve të tjera të ndihmë sociale, vetëm në QPS në Shkup jepen kartela për blerjen e artikujve ushqimor për çmime më të ulta në disa markete të caktuara. Kjo lloj ndihme jepet nga viti i kaluar (viti 2009). Në komunat e tjera ku u zbatua hulumtimi lloji i tillë i ndihmës nuk ekziston.

Të gjitha llojet e ndihmës plotësuese janë paraparë me programin e punës të qeverisë, mirëpo nuk është e qartë a do të bëhen të njejtat pjesë përbërëse e ndihmës dhe përkrahjes së rregulltë të qendrave për punë sociale. Në fakt, inicimi i një ndihme të llojit të tillë, qartësisht e paraqet nivelin e varfërisë, për shkak se jepet ndihmë për të siguruar një "ekzistencë lakuriqe".

Qendrat ditore në të gjitha komunat e përfshira në hulumtim janë prezente në numër të ndryshëm. Në të gjitha komunat u identifikua nevoja për të hapur më tepër qendra ditore me kapacitete më të mëdha se ato ekzistueset, që të mundësojnë plotësimin e nevojave të më tepër kategorive të qytetarëve. Për shembull, në QPS në Prilep është ngritur iniciativa për hapjen e strehimoreve për viktimat e dhunës familjare dhe qendër ditore për personat konsumues të drogës dhe substancave tjera psiko-tropike, mirëpo për shkak të mungesave të financave nga ana e MPPS dhe nga pushteti lokal, të njejtat ende nuk janë hapur. Është e rëndësishme të ceket se qendrat ditore dhe shërbimet të cilat ato i ofrojnë duhet të përshtaten sipas nevojave të shfrytëzuesve. Të tilla janë qendrat ditore për persona të moshuar në Komunën e Çashkës dhe Komunën e Bogomillës. Shërbimet të cilat i ofrojnë këto qendra janë të përshtatura, siqë janë ato në klubin ditor përmes të cilit mundësohet socializimi, shoqërimi dhe ahengu për personat e moshuar, ndërsa ato të cilët janë më të rrezikuar kanë mundësi që ti lajnë teshat. Gjithashtu, personave më të rrezikuar ju jepet ushqim. QPS kanë eksperiencë pozitive me punën e deritanishme të qendrave ditore.

Në shumicën e QPS edhe përpos ekzistimit të qendrave ditore u cek nevoja për hapjen e strehimoreve për: gra-viktima të dhunës familjare, persona të moshuar, persona pa shtëpi dhe fëmijë në rrugë. Sa u takon këshilltoreve vetëm në një QPS është hapur një e tillë, ndërsa në QPS e tjera të përfshira në hulumtim nuk ka këshilltore ku qytetarët në nevojë do të mund ti shfrytëzojnë shërbimet e saj.

Një kategori e caktuar e personave të prekshëm, gjegjësisht gra-viktima të dhunës familjare, në suazat e masave aktive për punësim kanë qenë të punësuar. Kjo lloj e ndihmës është siguruar nga MPPS, Agjencia për punësim dhe biznes sektori. Këto masa për viktimat e dhunës familjare u ofruan këtë vit, gjatë të së cilit një pjesë e tyre i shfrytëzuan dhe u punësuan. Masat aktive për punësim ishën të vlerësuara si negative, jo të qasëshme dhe diskriminuese, mu për shkak të kriterit i cili ishte i përcaktuar. Gjegjësisht, kriteri përcakton se nëse viktimat - e punësuar përmes këtyre masave vendos që ta braktisë punën e dhënë përpara afatit të caktuar, Agjencia për punësim ka të drejtë që mos ta regjistrojë të njejtën si të papunësuar, gjegjësisht ta pamunësojë atë për ta shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes shëndetësore në kohëzgjatje prej tre viteve. Në asnjërin prej komunave nuk ka të zhvilluara programe serioze dhe afatgjata për punësim të grupeve të varfëra dhe të prekshme nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale në bashkëpunim me Agjencinë për punësim dhe sektorin privat të biznesit.

Të gjitha QPS nuk disponojnë me numër të mjaftueshëm të personelit profesional dhe teknik si dhe me paisje teknike të përshtatshme, zyra, vetura terrenike, aparaturë kompjuterike; gjëra të cilat do t'ju mundësojnë atyre kushte adekuate për punë me të gjitha kategoritë e qytetarëve. Në të gjitha QPS nuk ka vend

adekuatë për pritje. Jo rallë në një dhomë të njejtë priten dhe punohet me nga dy kërkues të ndihmës në para, gjë me të cilën anashkalohet diskrecioni i të gjithë klientëve. Asnjëra prej QPS nuk ka njësi të shpërndara në të gjitha komunat rurale të cilat janë nën territorin e tyre. Duhet të ndërmerren më tepër aktivitete për pasurimin e diturisë dhe profesionalitetit të personelit profesional. Është e rëndësishme të ceket se në një nga QPS nuk ka person të punësuar për mirëmbajtjen e higjienës së objektit dhe nuk jepen mjete për higjienë personale për të punësuarit, si dhe nuk sigurohen mjete për mirëmbajtjen e higjienës së objektit nga ana e MPPS. Punonjësit profesional në QPS nuk marrin pagë shtesë për punën jashtë orarit të punës dhe për shkak të kësaj nuk kanë kushte për zhvillimin e një programi për terapi grupore. Është e nevojshme që në QPS të angazhohet sigurim privat si dhe detektor për armë. Një pjesë e përfaqësuesve të QPS e ceken nevojën për krijimin e shërbimit të posaçëm, i cili do ta mbajë evidencën e regjistrimit të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para. Në të gjitha QPS është e nevojshme që të krijohet shërbim për përzgjedhje dhe grupim dhe sekcion i posaçëm për preventivë sociale. Personat e shërbimit të përzgjedhjes dhe grupimit do të jenë përgjegjës për të gjitha lëndët dhe të njejtat do t'ju dorëzojnë profesionistëve. Profesionistët nga Sekcioni për preventivë sociale të njejtën do të zbatojnë në terren dhe do të inicojnë bashkëpunim me të gjitha institucionet publike dhe private. Përfaqësuesit e QPS si të veçantë e cekin nevojën për zbatimin e preventivës sociale nëpër shkolla.

Në moment përgatitet program për rrjetëzimin e të gjitha QPS me institucionet tjera shtetërore, qëllimi i të cilit është lehtësimi i punës gjatë kompletimit të dokumentacionit të nevojshëm për dorëzim të kërkesës për secilën të drejtë nga sfera e mbrojtjes sociale. Me këtë program afatgjatë do të lehtësohet puna administrative e profesionistëve. Përfaqësuesit e QPS ceken se edhe deri tani ka pasur inicim për programe të reja për mirëmbajtjen e punës administrative, mirëpo ato nuk janë të kënaqur për shkak të modelit të vjetërsuar të mirëmbajtjes së punës administrative. Përqindjen më të madhe të punës së tyre e humbin me punën administrative, në vend që ta bëjnë punën e tyre profesionale e cila është më se e nevojshme për klientët të cilët ato i shërbejnë.

3.2.3. Preventivë dhe përkrahje e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Sipas Ligjit për mbrojtje sociale, preventivën sociale parashikohet ta kryejnë qendrat për punë sociale. Gjendjet aktuale tregojnë se e njehta nuk praktikohet. Sipas deklaratave të përfaqësuesve të QPS, ato nuk kanë kushte për të kryer punë preventive, për shkak të kushteve të papërshtatshme të punës, punën administrative tepër të madhe, mungesë të kuadrove profesionale dhe veturave terrenik. Punonjësit profesional propozojnë që preventivën sociale ta kryejnë sekcion i posaçëm brenda organizatave të tyre. Në këtë mënyrë punonjësit profesional do të mund ta kryejnë preventivën përmes punës në terren. Në veçanti ceket nevoja për punë preventive në procesin arsimor dhe punësimi i punonjësve social në shkolla dhe në firma ku ka më tepër se 300 të punësuar. Ekziston nevoja që të krijohen kushte për zbatimin e preventivës sociale në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Asnjëra nga QPS nuk ka përcaktuar mekanizma dhe veprime të posaçme për mbrojtjen dhe përkrahjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme. Është i nevojshëm një program i posaçëm i cili do të përmbajë instrumente matëse, me të cilat do të vepohet në moment gjatë dhënies së ndihmës dhe mbrojtjes për grupet e varfëra dhe të prekshme.

Asnjëra nga QPS nuk ka program të posaçëm dhe qasje të përshtatshme për informimin dhe njohjen e kategorive të varfëra dhe të prekshme. Atëherë kur ka

ndryshime ligjore, QPS i informojnë qytetarët përmes broshurave, mediave elektronike dhe të shtypit dhe drejtëpërdrejt kur klienti vjen në qendër. Një pjesë e QPS, me qëllim që ti informojnë dhe njohin për së afërmi qytetarët kanë organizuar një ose dy punëtori në nivel vjetor.

3.2.4. Konsultime dhe pjesëmarrje e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS përpos asaj që nuk kanë mekanizma dhe mënyra për identifikim e grupeve të varfëra dhe të prekshme as që këshillohen me to. Të gjitha këshillimit zbatohen në premisat e QPS individualisht dhe gjatë kontrollës së drejtëpërdrejtë në terren. Në këtë mënyrë, me të gjithë shfrytëzuesit punohet në nivel individual, pa mos i përcaktuar nevojat e tyre të përbashkëta dhe çfarë është edhe më e rëndësishme, pa mos i përcaktuar mënyrat më të përshtatshme të sigurimit të ndihmës dhe përkrahjes për të njejt.

3.2.5. Bashkëpunimi i qendrave për punë sociale me vetëqeverisjen lokale

Mbrojtja dhe ndihma e përshtatshme e kategorive të varfëra dhe të prekshme nënkupton edhe bashkëpunim të ndërmjetshëm mes QPS, si bartës të mbrojtjes sociale nga njëra anë, dhe institucionet dhe organizatat e tjera të cilat kanë kompetenca ose ofrojnë mbrojtje nga sfera sociale nga ana tjetër. Mu prej këtu doli interesi për bashkëpunimin që QPS e realizon me njësitë e vetëqeverisjes lokale (në tekstin e mëtutjeshëm NJVL), Ministrinë për punë dhe politikë sociale, shoqatat qytetare dhe biznes sektorin.

Bashkëpunimi i të gjitha QPS me njësitë e vetëqeverisjes lokale, territorin e të cilave, gjegjësisht qytetarët e të cilave i shërben mund të vlerësohet si i pakënaqësëm. Eksperienca e bashkëpunimit është e ndryshme mes QPS dhe NJVL të ndryshme. Në të gjitha komunat, praktika është që njësitë e vetëqeverisjes lokale të drejtohen tek QPS për marrjen e të dhënave lidhur me numrin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale të cilët jetojnë në territorin e tyre. Forma e vetme konkrete e bashkëpunimit mes këtyre dy subjekteve, të cilat kanë ingerencë të përbashkët në mbrojtjen sociale, në të gjitha gjashtë komunat ndodh përmes angazhimeve të përkohshme të një pjese të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para (në periudhë prej pesë ditëve deri më gjashtë muaj) për nevojat e sekcioneve komunale të NJVL. Për shkak të periudhës së kufizuar të angazhimit në punë, klientët hekin dorë nga ky shërbim dhe e drejta e ndihmës në para nga ana e QPS ju anulohet për një periudhë gjashtë mujore. Pas angazhimit në punë, shfrytëzuesve të ndihmës në para përsëri ju aktivizohet e njejta ndihmë. Një numër shumë i vogël i kësaj kategorie kanë krijuar marrëdhënie pune.

Dallimet që ekzistojnë sa i takon nivelit të bashkëpunimit do ti paraqesim përmes shembujve të ardhshëm: QPS në Shkup një pjesë të bashkëpunimit me NJVL e realizon përmes pjesëmarrjes të një përfaqësuesi të QPS në këshillet lokale në ato NJVL ku të njejtat ekzistojnë. Bashkëpunimi i QPS në Shtip me NJVL ndodh përmes krijimit të një trupi koordinues për përmirësimin e gjendjes së klientëve të cilët ato bashkërisht i shërbejnë. Në QPS në Kërçovë bashkëpunimi me NJVL ndodh përmes pjesëmarrjes së QPS në seancat përfundimtare vjetore të komunës, ku qendra e informon Këshillin për programin e punës i cili ka qenë i zbatuar gjatë vitit të kaluar. Në Komunën e Velesit puna e QPS ndihmohet nga ana e NJVL, përmes sigurimit të donacionit për mjete shkollore për fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror. Komuna këtë vit, për herë të parë ka ndarë mjete financiare për viktimat e dhunës familjare. Bashkëpunimi i QPS me pushtetet lokale krejtësisht mungon në vendet rurale.

Sa i takon bashkëpunimit me ministrinë kompetente, gjegjësisht MPPS, të gjitha QPS e vlerësojnë të njëjtën si të përditshme dhe të kënaqshme. Problemi i vetëm gjatë bashkëpunimit është mungesa e mjeteve financiare për plotësimin e nevojave të qytetarëve socialisht të rrezikuar, gjegjësisht mungesën e mjeteve për realizimin e mandatit të QPS. Gjendja ekonomiko-politike në shtet, si dhe përqindja e lartë e varfërisë, mbi 30%, e rrisin numrin e qytetarëve të cilat mund të jenë të eksponuar në rrezik të lartë social.

Nevoja për ti ndihmuar dhe përkrahur qytetarët është shumë e madhe, mirëpo gjithashtu e shumëllojshme (prej këtu del se ndihma dhe përkrahje e cila është e nevojshme për këto qytetarë është e madhe dhe e shumëllojshme mu për shkak të dukurive të cilat zhvillohen si rezultat i rreziqeve sociale). Mu për shkak të kësaj na duket se këto vlerësime për bashkëpunim me ministrinë e përgjegjëshme duken si joreale. Të gjitha QPS kanë bashkëpunim të mirë me Agjencinë për punësim në sferën e bashkëpunimit të informatave, ndërsa sa u takon projekteve për punësim të shfrytëzuesve të ndihmës sociale (masat aktive për punësim), ato nuk kanë në disponim të dhëna. Sipas deklartarës së përfaqësueses të QPS në Shkup, me këto të dhëna disponon ministria resore. Agjencitë për punësim në të gjitha komunat, nuk ju mundësojnë punësim shfrytëzuesve të ndihmës sociale.

Në asnjërin nga QPS, nuk është krijuar një politikë apo strategji për bashkëpunim me shoqatat qytetare. Një pjesë e QPS bashkëpunojnë me disa shoqata qytetare. Informatat tona tregojnë se bëhet fjalë për bashkëpunim i cili është i inicuar dhe financiarisht është i përkrahur nga vetë shoqatat qytetare. Sa u takon fushave të bashkëpunimit mes QPS dhe shoqatat qytetare ato janë të ardhshmet: përmirësim i gjendjes së popullatës rome; tregtia me njerëz; të sëmurit nga paraliza celebrale; personat me nevoja të posaçme; gra-viktima të dhunës familjare. Ato QPS të cilat bashkëpunojnë me shoqatat qytetare, bashkëpunimin e vlerësojnë si pozitiv.

Të gjitha QPS nuk kanë kurrëfar bashkëpunimi me biznes sektorin. Në disa komuna të caktuara, biznesi paraqitet si donues i mjeteve financiare për qendrat ditore. I vetmi shembull për bashkëpunim të vazhdueshëm realizohet në komunën e Shkupit me marketet Tineks, të cilat markete punësojnë fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror. Ndërsa si shembull i bashkëpunimit jo të vazhdueshëm nga ana e të gjitha QPS, identifikohet bashkëpunimi me disa ndërmarje të cilat punësojnë persona me hendikep. Në QPS Radovish bashkëpunimi me sektorin e biznesit privat krejtësisht mungon.

3.3. Të dhëna nga fokus grupet e organizuara

3.3.1. Personat e moshuar

Personat e moshuar në të gjitha komunat janë mjaftë të përfaqësuar. Ato gjenden në një gjendje të pafavorshme për shkak të shumës së ulët të pensionit, me të cilën s'munden ti përmbushin nevojat elementare për ekzistencë. Në të gjitha komunat është prezente papunësia, gjë që është shkak që personat e moshuar të jetojnë në familje bashkarisht me më shumë gjenerata, ku jo rrallë pensioni edhe përpos të qenit shumë i vogël është i vetmi burim i të ardhurave për të gjithë anëtarët e familjes. Ka raste ku personat e moshuar financiarisht shfrytëzohen nga të afërmit e tyre dhe të njejtit nuk kujdesen për to. Në disa raste të caktuara është prezente edhe dhuna familjare mbi personat e moshuar. Problem tjetër me të cilin ballafaqohen personat e moshuar është joqasëshmëria e shtëpive për persona të moshuar. Nga njëra anë, numri i vendeve në këto strehimore është i kufizuar, a nga ana tjetër personat e moshuar nuk kanë mundësi financiare për ta shfrytëzuar këtë shërbim. As po të afërmit e tyre nuk kanë mundësi që të kontribuojnë për vendosjen e personave të moshuar në shtëpitë për persona të moshuar.

Personat e moshuar kanë kushte jetese relativisht të mira. Në shtëpitë publike për personat e moshuar kushtet jetësore janë të mira. Kjo kategori e personave ka më tepër nevojë që ti shfrytëzojë shërbimet nga mbrojtja shëndetësore terciare. Në klinikat kushtet janë nën nivelin e të gjitha standardeve. Nuk i kushtohet kujdes higjienës, inventari është i vjetër më tepër se disa dekada, piasjet dhe veglat mjekësore janë të vjetërsuara ose nuk ekzistojnë, krevatët dhe mbulesat janë në gjendje shumë të keqe. Ndërtesat nuk janë renovuar që nga fillimi i përdorimit të tyre. Në disa komuna nuk ka institucione shëndetësore për kujdes primar shëndetësor, ku qytetarët do të mund ti shfrytëzojnë këto shërbime shëndetësore. Kjo situatë edhe më tepër e vështirëson gjendjen shëndetësore tek personat e moshuar dhe të njejtit ngarkohen me shpenzime shtesë për ti shfrytëzuar shërbimet e mbrojtjes shëndetësore në komunat dhe qytetet tjera. Shërbimet shëndetësore, shumë shpesh i paguajn në plotësi përfshirë edhe shumicën e barnave. Dukuria e mungesës së barnave të cilat janë në barrën e Fondit për sigurim shëndetësor, në plotësim e vështirëson gjendjen e personave të moshuar, për shkak se duhet ti blejnë barnat e nevojshme edhe pse të njejtat janë në listën pozitive, si dhe ato barna të cilat nuk janë në listën pozitive të Fondit për sigurim shëndetësor. Ndihma e shpejtë vonohet gjatë intervencës tek personat e moshuar, si dhe ka pasur edhe raste kur aspak edhe nuk ka intervenuar. Personat e moshuar kanë nevoj për terapi fizikale, mirëpo për shkak të gjendjes së keqe financiare nuk kanë mundësi që ti shfrytëzojnë këto shërbime. Është e nevojshme që të krijohen programe të posaçme për mbrojtje shëndetësore të personave të moshua. Gjithashtu, personat e moshuar duhet të lirohen nga participimi për shërbime dhe barna shëndetësore.

Procedura për realizimin e të drejtave nga sfera e mbrojtjes sociale është e gjatë. Për realizimin e të drejtës së ndihmës dhe kujdesit nga personi i huaj, ku si kërkues më prezent janë personat e moshuar, merret parasysh gjendja shëndetësore dhe disa lloje të caktuara të diagnozave. Për shkak të pamundësisë të sigurimit të dokumenteve të nevojshme dhe kushtet për realizim të ndihmës në para nga mbrojtja sociale, personat e moshuar nuk mundin ti fitojnë të drejtat e tyre nga sfera e mbrojtjes sociale.

3.3.2. Gra

Si kategori posaçërisht e prekshme janë gratë-viktima të dhunës familjare dhe mobingut, si dhe gratë të cilat për shkak të papunësisë gjenden në rrezik social. Kushtet e jetesës për gratë janë relativisht të mira. Gratë më së shpeshti janë të punësuar në fabrikat tekstile dhe sektorin privat, ndërsa në administratë dhe në institucionet tjera publike punësimi bëhet sipas përkatësisë politike. Gratë mbi 35 vjeç janë të diskriminuara në tregun e punës për shkak të moshës së tyre. Gjithashtu, si kusht shtesë për punësim përcaktohet edhe planifikimi i familjes, gjegjësisht gruaja nuk duhet të planifikojë zgjerim të familjes nëse do që të punësohet, në të kundërtën marrëdhëniet e punës do të ndërpriten.

Nga ana e fabrikave tekstile nuk respektohen të drejtat nga Ligji për marrëdhënie pune, gjegjësisht gratë punojnë të paregjistruara, me orar pune të pacaktuar. Të punësuarit në këto fabrika nuk marrin paga shtesë për punën jashtë orarit të punës, ndërsa të ardhurat personale janë minimale. Më së shpeshti gratë keqpërdoren si fuqi pune e lirë dhe janë viktima të mobingut nga ana e punëdhënësve. Gratë nuk e paraqesin mobingun për shkak të asaj se nuk kanë mundësi që të gjejnë punë tjetër dhe të ardhurat minimale të tyre janë burimi kryesor për ekzistencë.

Tek gratë vetëdija për nevojën e mbrojtjes shëndetësore të rregullt është e zhvilluar në një nivel të kënaqshëm. Gratë i dinë të drejtat e tyre nga mbrojtja shëndetësore, mirëpo për shkak të gjendjes së keqe financiare nuk mundën rregullisht ti shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore. Masat PAP, të cilat i promovon qeveria për mbrojtje shëndetësore, nuk janë të mjaftueshme për të siguruar shërbime kualitative për gratë. Gratë të cilat kanë gjendje të keqësuar shëndetësore dhe sipas kësaj kanë të drejtë që të fitojnë ndihmë të njëhershme në para, jo gjithmonë e marrin këtë ndihmë nga QPS. Gratë-viktima të dhunës familjare nuk janë të kënaqura nga mënyra se si vepron QPS dhe Ministria për punë të brendshme (në tekstin e mëtutjeshëm MPB). MPB rastin e regjistron si ankesë, ndërsa QPS rastin e regjistron si marrëdhënie të prishura bashkëshortore. Dhuna psikike nuk sanksionohet nga këto dy institucione. Shelter qendra nuk është një zgjidhje e përshtatshme për gratë-viktima të dhunës familjare për shkak të kufizimit kohor. Është e nevojshme që organet persekutuese të reagojnë në moment, ku dhunuesi mënjëherë do të jetë i sanksionuar për veprën penale dhe do të largohet nga shtëpia. Gratë viktima të dhunës familjare nuk janë ekonomikisht të pavaruara dhe nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, gjë që paraqet një shkak të madh për mos ta paraqitur dhunën familjare në institucionet kompetente. Banesat sociale nuk janë të qasëshme për këtë kategori të grave.

3.3.3. Fëmijë

Varfëria ceket si shkak për paraqitjen e fëmijëve si kategori e prekshme në komuna dhe paraqet parakusht që fëmijët të fillojnë të konsumojnë alkool, drogë dhe të merren me dukuri të tjera negative. Vërehet edhe prezenca e keqpërdorimit të fëmijëve për punë nga ana e prindërve të tyre, të cilët i detyrojnë që të lypin. Mjetet të cilat fëmijët i fitojnë nga lëmosha, jua japin prindërve të tyre. Ka shumë raste të shpeshta, ku babai i përdor mjetet financiare për të blerë alkool, ndërsa fëmijët edhe më tej mbesin të paushqyer dhe të paveshur. Numri i fëmijëve të cilët lypin vazhdimisht po rritet, por gjithashtu vërehen edhe fëmijët me nevoja të posaçme të cilët janë të detyruar në këtë lloj të keqpërdorimit të punës feminare. Si shembull tjetër, ceken fëmijët të cilët punojnë punë fizike me prindërit e tyre me çfarë familja siguron mjete minimale

për tu ushqyer. Në hulumtim u vërejt se si pasojë e varfërisë më tepër rriten dukuritë sociale negative siqë është pedofilia, delikuenca juvenile, tregtia me fëmijë dhe prostitucioni i të miturit. Për shkak të prezencës së vlerave patriarkale mes qytetarëve, këto pasoja/dukuri shumë rrallë paraqiten tek institucionet relevante.

Në më tepër komuna mungojnë objekte për aktivitete sportive dhe rekreim të fëmijëve në moshën parashkollore dhe shkollore. Si pasojë e kësaj ceket mungesa e socializimit të fëmijëve përmes lojrave shoqëruese. QPS kujdeset për fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror. Pas largimit të këtyre fëmijëve nga institucioni, disa QPS inicojnë bashkëpunim me më tepër institucione duke e përfshirë edhe Agjencinë për punësim dhe vetëqeverisjen lokale, për punësim të kësaj kategorie të fëmijëve. Mirëpo, me këtë lloj të bashkëpunimit nuk përfshihen të gjithë fëmijët e kësaj kategorie. Problem i madh paraqet edhe mosigurimi i vendbanimeve për këtë kategori të fëmijëve.

Diskriminimi i fëmijëve është i dukshëm mu për shkak të pamundësisë që të gjithë fëmijët ta shfrytëzojnë shtesën fëminore. Si kusht për fitimin e të drejtës së shtesës fëminore është përcaktuar kufizimi i të ardhurave për çdo anëtar në një familje dhe punësim i më së paku njërit të prindërve. Fëmijët, prindërit e të cilëve janë të papunësuar nuk kanë të drejtë që ta shfrytëzojnë shtesën fëminore. Kur fëmijët paraqiten si bashkë-shfrytëzues të ndihmës sociale në para, nuk kanë të drejtë që të shfrytëzojnë edhe shtesë fëminore. Shuma e ndihmës në para e shtesës fëminore dhe shtesës fëminore të posaçme është minimale dhe nuk i plotëson nevojat kryesore për ekzistencë. Shtesa fëminore duhet të jetë e qasëshme për të gjithë fëmijët dhe të drejtën e shfrytëzimit fëmijët duhet ta kenë që në lindje. Shuma e këtyre llojeve të ndihmës në para duhet të përcaktohet sipas nevojave të fëmijëve.

Fëmijëve me nevoja të posaçme ju sigurohen kushte të përshtatshme për ndjekje të mësimi në shkollat e specializuara. Prindërit e fëmijëve të gjinisë femrore shqiptare dhe rome nuk e lejojnë arsimimin e tyre. Si shkak theksohen varfëria dhe vlerat tradicionale patriarkale.

Fëmijët të cilët ndjekim arsim fillor dhe të mesëm nuk kanë kushte të përshtatshme për ndjekjen e mësimi. Si shembull ceket mungesa e nxemjes gjatë dimrit, inventari i vjetruar për shkak të cilit shpeshohet dukuria e deformitetit të penit kurrizor, higjiena në shkolla ku posaçërisht në banjo nuk përdoren mjete dezinfektuese, mungesa e ndihmesave teknike për ndjekje të mësimi, ndërtesa shkollore të vjetruara etj.

Në Komunën e Sarajit fëmijëve maqedonë nuk u janë siguruar kushte normale për ndjekje të mësimi. Në arsim, gjithashtu mungon procesi edukativ dhe prezent është vetëm procesi arsimor. Në këtë mënyrë fëmijët më tepër u janë të eksponuar rreziqeve të ndryshme sociale. Në shkolla është e nevojshme që të zbatohet preventiva sociale dhe edukata shëndetësore e fëmijëve. Gjithashtu, duhet të punësohet më së paku nga një punonjës social nëpër shkolla.

3.3.4. Persona me nevoja të posaçme

Në komunat ku u zbatua hulumtimi, personat me nevoja të posaçme nuk pranohen nga mjedisi dhe nuk i kanë të siguruara kushtet e nevojshme për socializimin e tyre. Për këtë qëllim është e nevojshme hapja e numrit të përshtatshëm të qendrave ditore për personat me nevoja të posaçme. Në sferën e punësimit, nga ana e sektorit privat bëhet keqpërdorim i kësaj kategorie të personave, gjegjësisht të njejtive nuk u sigurohen kushte të përshtatshme për

punë dhe nuk u jepen rroga të përshtatshme. Gjithashtu, personave me nevoja të poaqme nuk ju evidentohet plotësisht vjetërsia e punës.

Të drejtat nga sfera e mbrojtje sociale këto persona i shfrytëzojnë vetëm deri në një masë. Ato janë të kufizuar nga kushtet e parashikuara me Ligjin për mbrojtje sociale. Mjetet nga ndihma financiare janë minimale dhe nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale të personave me nevoja të poaqme. Shuma e ndihmës në para duhet të llogaritet sipas nevojave të personave me nevoja të poaqme. Personat me nevoja të poaqme nuk janë të liruar nga participimi gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore dhe blerjes së barnave.

3.3.5. Rom

Romët janë kategoria më e prekshme dhe janë të përfaqësuar në të gjitha komunat me përjashtim të komunës së Çashkës. Më së shpeshti, kjo kategori e qytetarëve jeton në objekte të palegalizuara. Një numër i madh i fëmijëve romë nuk janë të vaksinuar, as po janë të regjistruar në institucionet relevante. Në veçanti theksohet se fëmijët e gjinisë femrore aspak nuk evidentohen për dallim të fëmijëve të gjinisë mashkullore të cilët regjistrohen në librin amë të të lindurve. Sipas traditë të popullatës rome ende janë prezente martesat e mitura (bashkësi jashtë-martesore). Fëmijët më së shpeshti marrin pjesë në bashkësitë martesore në moshë 12 deri më 15 vjeç. Romët të cilët kanë arsim të përshtatshëm janë të punësuar dhe gjendja e tyre materiale është më e mirë për dallim të romëve analfabet. Arsimi është shkaku kryesor për shkak të cilit ato nuk mund të krijojnë marrëdhënie pune dhe nuk janë mjaft të informuar për të drejtat të cilat ju takojnë sipas ligjit.

Në Komunën e Radovishit, në kohën e fundit popullata rome deklarohet si pjesë e bashkësisë etnike turke. Shkak për dukurinë e tillë janë donacionet e inicuar nga disa organizata turke. Romët mendojnë se nëse deklarohen si turq, do të mund të shfrytëzojnë një pjesë të këtyre donacioneve.

3.3.6. Pakica

Në të gjitha komunat janë prezente më tepër pakica edhe atë romë, turqë, vlllehë, boshnjakë, serbë, kroatë dhe të tjerë. Problemi më i madh me të cilin ballafaqohen pakicat është papunësia. Problem tjetër me të cilin ballafaqohet kjo kategori është procedura për fitimin e nënshtetësisë. Një numër i madh i tyre për shkak të asaj se janë analfabetë ose nuk dinë se si të informohen, nuk kanë marrë nënshtetësi dhe për shkak të kësaj nuk mund ti realizojnë të drejtat tjera në pajtim me ligjet e R.M. Si një bashkësi e marginalizuar u theksua bashkësia e jurukëve, e cila jeton vetëm në vendet malore të Komunës së Shtipit dhe Radovishit.

4. Sfera brengosëse

4.1. Njësi të vetëqeverisjes lokale

4.1.1. Mekanizma institucionale për mbrojtje sociale

- Në pesë nga gjashtë komunat e përfshira, nuk ka person të punësuar i cili do të punojë me çështjet e sferës së mbrojtjes sociale;
- Sekcionet për punë publike në komuna janë jo adekuatish të ekuipuara sipas nevojave të sferës së mbrojtjes shëndetësore, sociale, feminare për grupet e prekshme;
- Nuk ekziston komision i përhershëm për mbrojtje sociale në Komunën e Sarajit, si dhe kjo komunë nuk ka program për punën e Këshillit për vitin 2010.

4.1.2. Programe dhe plane vepruese nga sfera e mbrojtjes sociale, duke përfshirë edhe programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve

- Në të gjitha komunat nuk ka program pune për komisionin e përhershëm për mbrojtje sociale në suazat e Këshilleve;
- Në njërin nga komunat e identifikuar asnjëherë nuk është miratuar program pune dhe plan veprues për mbrojtje sociale (Saraj);
- Nuk ekziston bashkëpunim ndër-sektoral për krijimin e planeve dhe propozimeve me komisionet dhe sektoret tjera nga mbrojtja dhe përfshirja sociale (Saraj);
- Në një pjesë të komunave nuk janë miratuar programe dhe plane vepruese për mbrojtje sociale (Radovish dhe Prilep);
- Në një pjesë të komunave nuk janë përgatitur plane vepruese për zbatim të programeve të miratuara (Kërçovë dhe Çashkë);
- Asnjëra nga komunat e përfshira nuk ka miratuar as po ka propozuar programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve;
- Nuk ka buxhet të përcaktuar për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në një pjesë të planeve lokale vepruese ekzistuese (Shtip, Prilep dhe Çashkë);
- Nuk është përcaktuar kornizë kohore e përshtatshme për realizim të aktiviteteve të parashikuara me planet vepruese/programet lokale (Prilep, Shtip dhe Çashkë);
- Nuk ka vazhdimësi lidhur me vëzhgimin dhe vlerësimin e planeve për veprim lokal (një pjesë e personave në trupin koordinues për ndjekje të planeve për veprim lokal janë edhe këshilltarë të Këshillit të komunës, të cilët pas mbarimit të mandatit nuk marrin pjesë në trupin koordinues për vëzhgim të aktiviteteve). Procesi i zbatimit ju mbetet në barrë nëpunësve shtetëror, për shkak se trupi koordinativ nuk ka rol aktiv (Shtip dhe Prilep);

4.1.3. Mekanizma për konsultimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme dhe bashkëpunimi mes institucioneve relevante nga sfera e mbrojtjes sociale dhe shoqatat qytetare

- Nuk ka mekanizëm të përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme. Komunikimi për problemet e qytetarëve bëhet vetëm në kërkesë të qytetarit ose përmes konsultimeve me kryetarët e bashkësive urbane/lokale;
- Nuk mbahet bazë e të dhënave lidhur me çështjet e mbrojtjes sociale, për shembull sipas grupit synues, sipas kategorive të marrësve të ndihmës dhe të ngjajshme;
- Nuk ka bashkëpunim të përshtatshëm mes komunave, sektorit qytetarë dhe qendrave për punë sociale; e njëjta ndodh vetëm përmes pjesëmarrjes së përfaqësuesve të institucioneve të cekura në miratimin e planeve vepruese të caktuara, dorëzimit të projekteve ose marrjen e të dhënave lidhur me komunën nga QPS;
- Ngecën pjesëmarrja më e madhe e shoqatave qytetare në proceset e vëzhgimit dhe vlerësimit të planeve vepruese në nivel lokal;
- Sa i takon preventivës sociale nuk ekziston bashkëpunim i përshtatshëm mes komunës dhe qendrave për punë sociale, institucioneve shkollore dhe parashkollore, institucioneve shëndetësore dhe trupave dhe organeve të tjera shtetërore, personat juridik dhe fizik, si dhe me shoqatat qytetare.

4.1.4. Mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme

- Nuk ekziston mekanizëm formalisht i përcaktuar për identifikimin e grupeve të prekshme dhe të varfëra i cili rregullisht do të përdoret, a jo vetëm gjatë krijimit të planeve lokale për veprim. Shumë shpesh në këto plane mungojnë grupe synuese të mapuara të cilat ekzistojnë në komunë, ndërsa të njëjtat nuk janë të përfshirë në atë plan;
- Mungojnë aktivitete për preventivë sociale, të cilat do të zbatohen në bashkëpunim me shoqatat qytetare dhe qendrat për punë sociale;
- Mungon qasja e përshtatshme multi-sektorale për realizimin e preventivës sociale e komunave me qendrat për punë sociale, me institucionet parashkollore, shkollore, shëndetësore dhe trupave dhe organe të tjera shtetërore, persona juridik dhe fizik, si dhe me shoqatat qytetare.

4.1.5. Sigurimi i shërbimeve sociale nga ana e njësive për vetëqeverisje lokale dhe aktivitetet projektuese/programike të realizuara në sferën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale

- Në komuna mungojnë klasa speciale në moshën parashkollore për fëmijët me nevoja të posaçme;
- Nuk ka numër të mjaftueshëm të iniciativave nga ana e komunave lidhur me dhënien e shërbimeve sociale për grupet e prekshme dhe të marginalizuara, posaçërisht për banorët e vendeve rurale të cilat janë nën komunën e tyre;

- Nuk ka numër të mjaftueshëm të iniciative në komuna për të aplikuar deri tek institucionet ndërkombëtare financiare për çështjet e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale;
- Komunat më tepër aplikojnë për projekte të cilat financohen nga qeveria qendrore dhe më pak tek institucionet e huaja.

4.1.6. Përmirësim i gjendjes së personave socialisht të rrezikuara

- Komunat nuk kanë plan strategjik për përmirësimin e gjendjes së personave socialisht të rrezikuar. Masat të cilat ndërmerren janë projekte afatshkurtëra pa rezultate në një afat më të gjatë;
- Mungon bashkëpunimi proaktiv i komunës me biznes sektorin ose iniciativat vjetore për grumbullimin e mjeteve për grupet e varfëra dhe të prekshme, me të cilat mjete do të përkrahen iniciativa për përmirësimin e kushteve jetësore të këtyre personave, bartës të së cilave do të jenë komunat;
- Nuk ka aktivitete të vazhdueshëm të komunave për angazhimin e punëtorëve të aftë për punë për kryerjen e punëve të interesit publik. Kjo masë varet nga mjetet financiare të pushtetit qendror dhe prandaj nuk është e përhershme.

4.1.7. Investime dhe infrastrukturë kapitale në sferën e mbrojtjes sociale

- Në të gjitha komunat ka mungesë të investimeve të planifikuara në infrastrukturën e sferës së mbrojtjes sociale. Komunat në përgjithësi investojnë në investime kapitale në institucionet për moshën parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme;
- Nuk ka investime për ndërtimin e shtëpive për personat e moshuar dhe qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve¹⁹;
- Në vendet rurale nuk ka çerdhe.

¹⁹ Ligji për mbrojtje fëmimore e definon zhvillimin e hershëm fëmimor si arsim parashkollor, i cili përpos masave për strehim të fëmijëve përfshin edhe masa dhe aktivitete për promovimin e shëndetit dhe përmirësimin e zhvillimit emocional, fizik dhe social. Strehimi dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollore bëhet në çerdhet fëmimore, a për fëmijët e papërfshirë nga këto institucione janë paraparë mundësi për organizimin e formave të tjera jashtë-institucionale (Ligji për mbrojtje fëmimore, Gazeta zyrtare e R.M. n 98/2000). Në ardhmëri, përpos formave të strehimit gjithë-ditorë të fëmijëve në çerdhet ekzistuese, duhet të promovohen edhe forma të shkurtëra të përfshirjes në varësi nga nevojat, mundësitë dhe interesat e bashkësisë lokale. Dokument i Ministrisë për punë dhe politikë sociale „Standarde për mësim dhe zhvillim të hershëm tek fëmijët 0-6 vjeç”, fq.2. Deri tani, Komuna e Shtipit është e vetmja nga komunat e identifikuara, e cila ka zbatuar iniciativë të tillë për edukim të fëmijëve të moshës parashkollore në grupe të vogla, të llojit të çerdheve fëmimore. Fëmijët, kanë mundësi që të shoqërohen dhe të fitojnë eksperiencë dhe dituri dhe të cilët më vonë do të përfshihen në arsimin.

4.2. Qendra për punë sociale

4.2.1. Identifikim i grupeve të varfëra dhe të prekshme

- Nuk ka mekanizma dhe mënyra për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme në QPS dhe nga kjo mund të përfundohet se të dhënat e këtyre institucioneve lidhur me kategoritë e varfëra dhe të prekshme në territorin të cilin ato e shërbejnë, jo domosdo e paraqesin situatën reale;
- Nevojat e disa grupeve të prekshme nuk janë mjaftë ose aspak të njohura, siqë janë konsumuesit e drogës dhe posaçërisht personat me orientim të ndryshëm seksual në nivel lokal.

4.2.2. Shërbime dhe qasja në shërbimet e QPS

- QPS nuk e kryejnë punën e përshtatshme (punën profesionale), për shkak të procedurës së madhe administrative lidhur me dhënien e ndihmës në para;
- Ka mungesa sistemore, gjegjësisht kushte të përcaktuara me ligjin lidhur me shfrytëzimin e disa të drejtave të caktuara, të cilat kushte i pamundësojnë grupet e varfëra dhe të prekshme që ti shfrytëzojnë disa të drejta të caktuara ose më saktësisht ti plotësojnë disa nevoja të tyre reale (Kushtet e parapara me ligj për fitimin e ndihmës në para, gjegjësisht shumën e paraparë të të ardhurave, si kusht për fitimin e ndihmës në para; familje me më shumë gjenerata të cilat jetojnë në një shtëpi dhe ballafaqohen me problemin e mosfitimit të ndihmës në para dhe pamundësinë për ta shfrytëzuar të drejtën e shtesës feminare; kufizim sipas numrit të viteve të vjetërsisë së punës);
- Shuma e mjeteve nga ndihma sociale në para nuk është e mjaftueshme për plotësimin e nevojave kryesore ekzistenciale të bartësve dhe familjeve të tyre. Gjithashtu, mjetet nga ndihma në para e cila është miratuar, merren pas përfundimit të muajit kur është miratuar kërkesa;
- Jo vazhdimisht jepet ndihmë e njëhershme në para, gjegjësisht në një pjesë të komunave ajo nuk jepet (në tre komuna);
- Nuk ka mekanizma me të cilat do të lehtësohet situata e shfrytëzuesve të të gjitha llojeve të ndihmës në para gjatë sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm për fitimin e të njejtës, posaçërisht për shkak se për një pjesë të saj ato vetë duhet të paguajnë një shumë të caktuar;
- Nuk ka masa dhe aktivitete sistematike të përshtatura sipas nevojave të grupeve të varfëra dhe të prekshme. Ato të cilat aktualisht zbatohen (kuzhinat popullore, kartelat për blerjen e produkteve ushqimore për çmime më të ulta dhe subvencione për energji elektrike), realizohen si aktivitete projektuese të parapara me programin për punë të qeverisë. Ka shqetësim për atë se pas mbarimit të këtyre projekteve, ato nuk do të jenë pjesë përbërëse e ndihmës dhe përkrahjes së rregullt të qendrave për punë sociale;
- Nuk ka qasëshmëri të barabartë në aktivitetet projektuese të qeverisë (kuzhinat popullore dhe kartelat për blerjen e produkteve ushqimore për çmime më të ulta). Këto shërbime nuk janë të qasëshme për të gjithë shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale dhe nuk janë prezente në çdo vend të shtetit;

- QPS nuk kanë numër të mjaftueshëm të personelit profesional dhe teknik si dhe paisje teknike të përshtatshme, vetura terrenike, paisje kompjuterike; gjëra të cilat do ta mundësojnë sigurimin profesional dhe të përshtatshëm të ndihmës;
- Në të gjitha QPS nuk ka kushte të përshtatshme për pritjen dhe punën me klientët;
- Nuk ka njësi të shpërndara të QPS në vendet rurale, dhe një pjesë e tyre janë vetëm me një punonjës social të i cili një ditë në muaj e kryen funksionin e njesisë së shpërndarë të QPS;
- Nuk ka shërbime specifike dhe të specializuara për plotësimin e nevojave të personave socialisht të rrezikuar siqë janë qendrat ditore, strehimoret, strehimoret për personat në rrugë etj.

4.2.3. Preventiva dhe përkrahja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

- Nga asnjëra QPS nuk ndërmerren aktivitete preventive.

4.2.4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e grupeve të prekshme

- Nuk ndërmerren aktivitete për konsultime dhe kryerje të vlerësimit për nevojat e qytetarëve, gjegjësisht veçmas të grupeve të varfëra dhe të prekshme. Përpjekjet e tyre të deritanishme në këtë drejtim janë sporadike dhe josistematike.

4.2.5. Bashkëpunimi i QPS me NJVL dhe institucionet dhe organizatat tjera

- Bashkëpunimi i QPS me NJVL lokale është i pakënaqshëm dhe jo i përhershëm, posaçërisht në vendet rurale. Bashkëpunimi i deritanishëm në të gjitha komunat përbëhet nga angazhimi i përkohshëm i shfrytëzuesve të ndihmës në para për mirëmbajtjen e higjienës në komunë;
- Mungojnë masa për punësimin e personave të cilat shfrytëzojnë shërbime të QPS. Disa iniciativa, gjegjësisht masa aktive për punësim janë vlerësuar si të paqasëshme dhe diskriminuese;
- QPS nuka kanë realizuar bashkëpunim real me Agjencinë për punësim dhe e njëjta për momentin përbëhet vetëm nga shkëmbimi i listave të personave/shfrytëzuesve të ndihmës në para;
- Qendrat për punë sociale nuk kanë politikë, as po strategji për bashkëpunim me shoqatat qytetare;
- QPS nuk bashkëpunojnë me biznes sektorin, vetëm në raste të donacioneve dhe bashkëpunim me disa firma individuale të cilat punësojnë disa kategori të caktuara të qytetarëve të prekshëm.

4.3. Të dhëna nga fokus grupet e organizuara

4.3.1. Persona të moshuar

- Të ardhurat nga pensionet e personave të moshuar janë minimale dhe nuk i kënaqin nevojat kryesore ekzistenciale për këtë kategori të qytetarëve;
- Kapaciteti i shtëpive për personat e moshuar nuk është i mjaftueshëm sipas nevojave të këtyre personave;
- Personat e moshuar të cilët kanë të ardhura minimale nuk mund ti shfrytëzojnë shërbimet në shtëpitë për personat e moshuar;
- Në asnjërën prej komunave nuk ka qendra ditore për personat e moshuar;
- Nuk ka programe të posaçme për mbrojtje shëndetësore për personat e moshuar;
- Nuk ka servise të posaçme të cilat do të jenë të dedikuara për ti shërbyer personat e moshuar.

4.3.2. Gra

- Shteti nuk siguron përkrahje të mjaftueshme ekonomike dhe banuese për gratë
- viktima të disa llojeve të caktuara të dhunës;
- Dhuna familjare nuk është mjaft e sanksionuar nga ana e institucioneve kompetente;
- Nuk ka mbrojtje të përshtatshme për gratë-viktima të mobingut;
- Gratë të cilat nuk e kanë procesin e divorcit të përfunduar nuk mund ti realizojnë të drejta nga sfera e mbrojtjes sociale.

4.3.3. Fëmijë

- Në asnjërën komunë nuk ka çerdhe;
- Asnjëra prej shkollave nuk ka kushte të përshtatshme për ndjekjen e mësimin nga ana e nxënësve;
- Fëmijët nuk janë plotësisht të liruar nga pagimi i participimit për shërbimet shëndetësore;
- Nuk ka programe edukative për rritjen e vetëdijes mes qytetarëve për pranimin e fëmijëve me nevoja të posaçme;
- Nuk ka fond solid i dedikuar për nevojat e fëmijëve;
- Për shkak të kushteve të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore jo të gjithë fëmijët kanë mundësi që ta shfrytëzojnë të drejtën e shtesës fëminore;

- QPS nuk ka program të posaçëm për punë me fëmijët e abuzuar dhe fëmijët të cilët indirekt janë viktimë të dhunës familjare;
- QPS nuk ofron ndihmë të përshtatshme për fëmijët në rrugë.

4.3.4. Personat me pengesa

- Personat me nevoja të posaçme nuk janë të liruar nga participimi për të gjitha shërbimet shëndetësore dhe barnat;
- Në asnjërën nga komunat nuk ka të hapura qendra ditore për personat me nevoja të posaçme (posaçërisht për personat mbi 26 vjeç);
- Për shkak të kushteve të parapara me Ligjin për mbrojtje sociale, jo të gjithë personat e kësaj kategorie janë të mbrojtur me të;
- Shuma e parave të ndihmës sociale është minimale dhe e njejta nuk i plotëson nevojat kryesore ekzistenciale për personat me nevoja të posaçme;
- Nuk ka kontroller të përforcuara në sektorin privat ku këta persona janë të punësuar.

4.3.5. Rom

- Nuk ka aktivitete dhe masa të posaçme për përfshirjen e romëve në procesin arsimor;
- Nuk ka aktivitete dhe masa të posaçme për zbulimin e romëve të cilët nuk kanë dokumentacion për identifikim, me qëllim që të njejtit të regjistrohen në librin e të lindurve.

4.3.6. Pakica

- Nuk ndërmerren mjaftueshëm aktivitete dhe masa të posaçme për informimin dhe ndihmimin e personave të bashkësive joshumicë, të cilët nuk kanë nënshtetësi.

5. Rekomandime

5.1. Njësi të vetëqeverisjes lokale

5.1.1. Mekanizma institucionale për mbrojtje sociale

- Komunat duhet të posedojnë strukturë të formuar institucionale të kuadrove profesionale, të cilët do të mund të punojnë në përgatitjen e akcioneve dhe udhëzimeve të cilat do të shërbejnë si bazë për krijimin e politikave lokale për përfshirje sociale;
- Të punësuarit në komunë duhet rregullisht të ndjekin trajnime për aftësim të mëtutjeshëm dhe zgjerim të dijenisë së tyre, në veçanti në fushën e përfshirjes sociale dhe qasjen e bazuar mbi të drejtat e njeriut;
- Në Komunën e Sarajit të formohet komision i përhershëm për mbrojtje sociale në Këshill dhe rregullisht të miratohet programi për punë të Këshillit të komunës;
- Në Komunën e Sarajit të bëhet ndryshim i Statutit dhe të inkorporohet dispozitë, me të cilën do të parashikohet formimi i komisionit për mbrojtje sociale si dhe komision i përhershëm i Këshillit.

5.1.2. Programe dhe plane vepruese nga sfera e mbrojtjes sociale, duke përfshirë edhe programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve

- Komunat duhet të miratojnë programe për përfshirje sociale të cilat do të shërbejnë si metod për një planifikim integral, multi-sektoral dhe multi-koordinues në zhvillimin social me institucionet dhe aktorët institucional adekuat në nivel lokal;
- Komunat duhet të krijojnë korniza të përshtatshme për vëzhgim dhe vlerësim të aktiviteteve të planifikuara;
- Komunat duhet të definojnë dhe realizojnë objektiva zhvillimore në të gjitha sferat e zhvillimit social (kushte jetësore, kushte punuese, kushte arsimuese) në nivel lokal;
- Komunat duhet të krijojnë kornizë për definimin, planifikimin, zhvillimin, zbatimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e aktiviteteve nga sfera sociale dhe përfshirëse në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë;
- Komunat për secilin program dhe plan veprues të miratuar, duhet të zhvillojnë një buxhet specifik dhe të detajuar dhe jo indikativ për zbatimin e aktiviteteve.

5.1.3. Mekanizma për konsultimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme dhe bashkëpunimi mes institucioneve relevante dhe shoqatave qytetare nga sfera e mbrojtjes sociale

- Komunat duhet të mbajnë bazë të dhënave për çështje lidhur me mbrojtjen sociale, për shembull sipas grupit synues, sipas kategorive të marrësve të ndihmës etj;

- Komunitat duhet të identifikojnë kërkesat e qytetarëve dhe në bazë të tyre ta përcaktojnë qarkun e nevojave. Kjo duhet të shërbejë si bazë për planifikimin e aktiviteteve nga sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale;
- Komunitat duhet të krijojnë mekanizëm formal për konsultime me grupet e prekshme të qytetarëve dhe në përgjithësi me qytetarët në nivel lokal, për shkak se ekziston tendenca e ndryshueshmërisë së nevojave njerëzore;
- Komunitat duhet të identifikojnë shoqatat qytetare adekuate, të cilat funksionojnë në nivel lokal në sferën e përfshirjes sociale dhe të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe të njejtë të shpallin në ueb faqen e tyre;
- Komunitat duhet të koordinohen me këto shoqata qytetare, të planifikojnë dhe aplikojnë për projekte nga sfera sociale dhe të jenë bashkëpuntori i tyre adekuat në zbatimin e të njejtave;
- Komunitat duhet të kenë bashkëpunim më aktiv me qendrat për punë sociale gjatë propozimit, inicimit dhe zbatimit të veprimeve të cilat do ta ulin rrezikun social të qytetarëve;
- Komunitat duhet të krijojë mekanizma të posaçme për përfshirjen e banorëve rural, me theks të veçantë tek gratë rurale dhe fëmijët, si kategori e veçantë e prekshme në programet dhe planet vepruese të saj.

5.1.4. Mekanizma për identifikim e grupeve të varfëra dhe të prekshme

- Komunitat duhet të fusin në përdorim mekanizma të formalizuar për identifikimin e nevojës së grupeve të prekshme dhe të varfëra dhe ta praktikojnë këtë mekanizëm në nivel vjetorë;
- Komunitat gjatë miratimit të planeve vepruese për mbrojtje dhe përfshirje sociale duhet detyrimisht të planifikojnë dhe përfshijnë aktivitete për prevencion social, në bashkëpunim me shoqatat qytetare dhe qendrat për punë sociale;
- Komunitat duhet të sigurojnë qasje të përshtatshme multi-sektorale për realizimin e preventivës sociale me qendrat për punës sociale, institucionet parashkollore, shkollore, shëndetësore dhe trupat dhe organet e tjera shtetërore, personat juridik dhe fizik, si dhe me shoqatat qytetare.

5.1.5. Sigurimi i shërbimeve sociale nga ana e njësive për vetëqeverisje lokale dhe aktivitetet projektuese/programore të realizuara në sferën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale

- Komunitat duhet të inicojnë lloje të posaçme të shërbimeve nga mbrojtja dhe përfshirja sociale për banorët e vendeve rurale, posaçërisht për të rinjtë dhe personat e moshuar (psh. përgatitja e ushqimit në një vend të caktuar të vendit rural, sigurimi i mjeteve për higjienë personale nga shitëria lokale, sigurimin e transportit, një herë deri më dy herë në javë deri tek, nga komuna deri tek institucionet e përshtatshme ose qendrat shëndetësore etj.);
- Në komunë duhet të futen në përdorim klase speciale për moshën parashkollore për fëmijët me nevoja të posaçme;
- Komunitat duhet të kenë rol më aktiv në aplikimin për projekte tek institucionet ndërkombëtare dhe jo vetëm të përgjigjen në thirrjet nga pushteti qendror ose shoqatat qytetare;

- Komunat duhet në nivel vjetor të organizojnë konferencë donuese për bashkësinë e biznesit e cila funksionon në nivel lokal me qëllim që të sigurohet fond i mjeteve financiare të cilat do të dedikohen për përmirësimin e gjendjes së grupeve të varfëra dhe të prekshme. Kjo konferencë duhet të mbahet në nivel vjetor. Në këtë mënyrë do të realizohet një bashkëpunim pro-aktiv i komunës me biznes sektorin;

- Komunat duhet secilin vit të organizojnë shpërblime për përgjegjësi shoqërore në nivel lokal, për person më të suksesshëm juridik/fizik, i cili do të ketë meritë më të madhe në sigurimin e ndihmës dhe iniciativave për përfshirje sociale.

5.1.6. Përmirësim i gjendjes së personave socialisht të rrezikuar

- Komunat duhet të krijojnë programe vetanake për nevojat specifike të grupeve të prekshme, që do të krijohen si rezultat i nevojave paraprakisht të përcaktuara të grupeve të prekshme, përmes të së cilave dhënia e shërbimeve nga mbrojtja sociale vazhdimisht do të realizohet për plotësimin e nevojave të qytetarëve në një afat më të gjatë. Programet zhvillimore të përpiluara në këtë mënyrë duhet të financohet nga aspekti multi-sektoral, me pjesëmarrjen e organizatave qeveritare, joqeveritare dhe biznes sektorin;

- Konceptet e tilla zhvillimore do të kontribuojnë kah largimi i gradualshëm nga koncepti i "projekteve" lidhur me rregullimin e punëve publike, nën të cilave gjendet edhe mbrojtja sociale dhe do të krijojnë një plan strategjik për përmirësimin e gjendjes së personave socialisht të rrezikuar;

- Në nivel qendror duhet të miratohet ligj për ndryshimin e ligjit për buxhete, sipas të cilit do të duhet që veçmas të planifikohet aline e posaçme buxhetore për mbrojtjen sociale dhe jo e njejta çështje të trajtohet përmes alines buxhetore për rezervat vijuese.

5.1.7. Investime kapitale dhe infrastrukturë në sferën e mbrojtjes sociale

- Komunat duhet më tepër të përfshihen në aplikimin për projekte investuese, të aplikojnë deri tek institucionet dhe organizata ndërkombëtare dhe të sigurojnë grante nga sfera e përfshirjes sociale;

- Komunat duhet në mënyrë më aktive ta shfrytëzojnë qasjen e partneritetit publiko-privat në planifikimin, financimin dhe zbatimin e projekteve kapitale;

- Komunat rurale duhet të ndërtojnë institucione për moshën parashkollore;

- Komunat duhet të investojnë në ndërtimin e shtëpive për persona të moshuar dhe qendra për zhvillim të hershëm femënor.

5.2. Qendrat për punë sociale

5.2.1. Identifikimi i grupeve të varfëra dhe të prekshme

- QPS duhet të përgatisin program dhe të krijojnë mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme;
- QPS duhet të krijojnë mekanizma të posaçme për identifikimin e nevojave, veçmas për secilin grup specifik të prekshëm, siqë janë konsumuesit e drogës dhe posaçërisht personat me orientim të ndryshëm seksual.

5.2.2. Shërbime dhe qasja në shërbime e QPS

- QPS duhet në vazhdimësi t'ju sigurojë ndihmë profesionale të gjithë kategorive të shfrytëzuesve;
- Duhet të ndryshohet Ligji për mbrojtje sociale lishur me kriteret për fitimin e ndihmës në para (ndihmë sociale në para, ndihmë e vazhdueshme në para dhe shtesa fëmimore) dhe posaçërisht lidhur me kufizimin e të ardhurave, si parakusht për realizimin e të gjitha llojeve të ndihmës;
- Duhet të ndryshohet Ligji për mbrojtje sociale sa i takon shumës së të gjitha ndihmave në para dhe është e nevojshme që ndihma në para të llogaritet individualisht, për secilin rast të veçmas, gjegjësisht e njejta të llogaritet sipas nevojave – shpenzimeve të kërkuesit;
- Shteti duhet të mundësojë dhënie të vazhdueshme të ndihmës së njëhershme në para;
- Duhet të përshpejtohet procesi i futjes në përdorim të rrjetëzimit ndër-sektoral i QPS me institucionet tjera, me qëllim që të lehtësohet sigurimi i dokumenteve të nevojshme për klientët;
- Duhet të bëhet ndjekje e rregullt dhe sistematike e gjendjes së kategorive të varfëra dhe të prekshme, duke praktikuar procese adekuate konsultative, të përshtatura për këtë kategori të qytetarëve;
- Duhet të përpilohen programe për mbrojtjen e kategorive të posaçme të personave, si dhe të bëhet revidimi i atyre ekzistuese, me qëllim që të njejtat të përputhen me ndryshimet dhe nevojat e kësaj kategorie të qytetarëve;
- Duhet që të ç'rrenjose qasja ad hoc dhe zgjidhja e përkohshme e nevojave të kategorive të varfëra dhe të prekshme të qytetarëve (siqë janë projektet qeveritare për kuzhinat popullore, subvencionet për energji elektrike etj);
- Duhet të mundësohet punësimi i kategorive të varfëra dhe të prekshme të qytetarëve përmes bashkëpunimit intensiv mes QPS dhe agjencive për punësim;
- Duhet të sigurohen kushte të përshtatshme për pranimin dhe punën me klienta në QPS;
- Duhet të hapen njësi të shpërndara të QPS dhe në veçanti njësi qarkore ao të shpërndara në vendet rurale;
- Duhet të zgjerohen, gjegjësisht të futen në përdorim shërbime të specializuara sociale në të gjitha komunat.

5.2.3. Preventivë dhe përkrahje e grupeve të varfëra dhe të prekshme

- Është e nevojshme që të zbatohet preventiva sociale përmes organizimit të njësive të veçanta organizuese në suazat e QPS.

5.2.4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e grupeve të prekshme

- Duhet të krijohen programe për zbatimin e konsultimeve me kategoritë e varfëra dhe të prekshme të qytetarëve nga ana e QPS.

5.2.5. Bashkëpunimi i QPS me NJVL dhe institucionet dhe organizatat tjera

- Duhet të bëhet një vlerësim i të gjitha mundësive për bashkëpunim mes QPS, NJVL, shoqatave qytetare dhe biznes sektorin në nivel lokal, në veçanti nga perspektiva e koordinimit dhe ndërtimit të një sistemi të unjësuar për mbrojtjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme.

5.3.Rekomandime lidhur me grupet e prekshme veçmas

5.3.1. Persona të moshuar

- Duhet që shuma e pensionit të zmadhohet me zmadhimin e shumës së shportës shpenzuese dhe shpenzimeve të regjisë;

- Duhet të rritet kapaciteti i shtëpive për personat e moshuar dhe të zvoglohen shpenzimet për shfrytëzimin e të njejtave;

- Është më se e nevojshme që shteti të gjejë zgjidhje për vendosjen në shtëpitë për persona të moshuar për ato të cilët kanë të ardhura të vogla;

- Në të gjithë komunat është e nevojshme hapja e një numri të përshtatshëm të qendrave ditore;

- Duhet të futen në përdorim programe të posaçme për mbrojtje shëndetësore të personave të moshuar. Personat e moshuar kanë nevojë për një servis i cili do të jetë specialisht i dedikuar për shërbimin e kësaj kategorie të njerëzve.

5.3.2. Gra

- Shteti duhet të mundësojë siguri banuese dhe ekonomike për gratë – viktimat të disa llojeve të caktuara të dhunës, me çfarë do të mundësohet socializim adekuat i këtyre grave dhe drastikisht do të zvoglohen rreziqet të cilat janë parakusht për shfaqjen e këtyre dukurive;

- Duhet t'ju jepen banesa sociale grave-viktimit të dhunës familjare si dhe kategoive të tjera të prekshme të grave;

- Duhet të ndërmerren masa adekuate për sanksionimin e dhunës psikike;

- Shteti duhet të sigurojë mbrojtje për gratë - viktimat të mobigut.

5.3.3. Fëmijë

- Duhet të hapen çerdhe fëmimore si dhe të bëhet sigurimi i kushteve adekuate për ndjekje të mësimi nëpër shkolla;
- Fëmijët duhet krejtësisht të lirohen nga pagesa e participimit për shërbime shëndetësore;
- Duhet të rritet vetëdija e qytetarëve për pranimin e fëmijëve me nevoja të posaçme;
- Duhet të krijohet fond solidarë i dedikuar për nevojat e fëmijëve;
- Duhet të mundësohet shfrytëzimi i të drejtës së shtesës fëmimore si dhe të rritet shuma e ndihmës në para për shtesën fëmimore dhe shtesën e posaçme fëmimore, në pajtim me nevojat e fëmijëve;
- QPS duhet të krijojnë program të posaçëm për punë me fëmijët e keqpërdorur dhe fëmijët të cilët janë viktime të drejtëpërdrejta të dhunës familjare;
- QPS duhet të mundësojë mbrojtje më të madhe për fëmijët në rrugë.

5.3.4. Personat me nevoja të posaçme

- Shteti duhet ti marrë përsipër shpenzimet e participimit për mbrojtjen shëndetësore të personave me nevoja të posaçme;
- Shteti duhet të ndihmojë në hapjen e qendrave ditore për socializimin e personave me nevoja të posaçme në të gjitha komunat (në veçanti për personat mbi 26 vjeç);
- Duhet të ndryshohet Ligji për mbrojtje sociale, me çfarë personat me nevoja të posaçme do të mund ti shfrytëzojnë të drejtat nga mbrojtja sociale vetëm në bazë të sëmundjes dhe paaftësisë së tyre për punë;
- Duhet të inicohen kontrolla të rrepta në biznes sektorin privat ku janë të punësuar persona me nevoja të posaçme;
- Duhet të rritet shuma e të dhënave në para sipas nevojave të personave me nevoja të posaçme.

5.3.5. Rom

- Duhet të ndërmerren aktivitete dhe masa të posaçme për ti përfshirë romët në procesin arsimor;
- Duhet të ndërmerren aktivitete dhe masa të posaçme për romët të cilët nuk kanë dokumente për identifikim personal, për ti zbuluar ato dhe pastaj për ti regjistruar në librin e të lindurve.

5.3.6. Pakica

- Duhet të ndërmerren masa për ti informuar personat për realizimin dhe fitimin e të drejtës së nënshtetësisë.

6. Gjendjet me përfshirjen sociale nga perspektiva e institucioneve kompetente dhe qytetarëve, veçmas në secilën komunë

A. Komuna e Sarajit

1. Njësia e vetëqeverisjes lokale – intervista u realizua me Z. Xhelaj Jakupi, sekretarë i Komunës së Sarajit.

1.1. Mekanizma institucionale për mbrojtje sociale në Komunën e Sarajit

Komuna e Sarajit ka Seksion për punë të përgjithshme dhe juridike. Në këtë seksion, nuk ka person të punësuar i cili do të punojë në sferën mbrojtjen sociale, në rolin e nëpunësit shtetëror. Këtë detyrë e ka kryer një bashkëpunëtor nga Sekcioni për resurse njerëzore, i cili ka qenë përgjegjës për mbrojtjen sociale. Në moment ky person nuk është më i punësuar në komunë dhe vendi i tij është ende i lirë. Nga kjo përfundojmë se **në Komunë nuk ka person të punësuar i cili punon në sferën e mbrojtjes sociale.**

Nuk ka komision të përhershëm për mbrojtje sociale në suazat e Komunës së Sarajit. Komuna asnjëherë deri tani nuk ka pasur ndonjë komision të tillë. Në rast se paraqitet ndonjë problem nga mbrojtja sociale i cili i prek qytetarët, kryetari formon ad hoc komision të përbërë nga këshilltarët dhe nëpunësit shtetëror të cilët e hulumtojnë situatën në terren, përgatisin raport, në bazë të cilit raporti kryetari pastaj vepron.

1.2. Programe dhe plane vepruese nga sfera e mbrojtjes sociale, përfshirë edhe programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve

Komuna e Sarajit **asnjëherë nuk ka pasur program**, dhe sipas kësaj as edhe plan veprues për mbrojtje sociale. Komuna e Sarajit **nuk ka program pune për Këshillin për vitin 2010**, në prioritetet e të cilit në agjendën ditore mund të vendoset edhe përfshirja sociale. Në Komunë **nuk ka bashkëpunim ndër-sektoral për krijimin e planeve dhe propozimeve** me komisionet dhe sektoret tjera për çështjet e kësaj sfere (për shembull komisioni për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave etj.).

Komuna e Sarajit **asnjëherë nuk ka miratuar, as po ka propozuar programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve**, të cilët jetojnë në territorin e saj.

1.3. Mekanizma për konsultimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal dhe kombëtar si dhe bashkëpunimi mes institucioneve relevante nga sfera e mbrojtjes sociale dhe shoqatat qytetare

Në Komunën e Sarajit, popullata informohet për punën e Komunës përmes ueb faqes së Komunës. Komunikimi zhvillohet përmes bashkësisë lokale, gjegjësisht asaj urbane ose drejtëpërdrejt me qytetarët nëse ato drejtohen në Komunë. Përveç Këshillit, i cili është kompetent për sjelljen e vendimeve, kohë pas kohe konsultohen edhe bashkësitë lokale për probleme të cilat i brengosin ato edhe atë përmes tubimeve publike. Megjithatë, përpos këtyre formave të veprimit dhe

dhënies së informatave, të cilat janë të rregulluara me ligj, **nuk ka mekanizëm të përshtatshëm i cili do ta mundësojë konsultimin ose pjesëmarrjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme në këtë komunë.** Në sferën e mbrojtjes sociale, si shembull i konsultimit me qytetarët është përgatitja e padisë falas të cilën e ofron Komuna për ato shfrytëzues të cilëve ju është shkurtuar ndihma në para. Komunikimi në këtë drejtim bëhet vetëm në rast se kërkesa vjen nga ana e qytetarëve dhe ka të bëjë me sigurimin e ndihmës ose konsultime nga sfera e mbrojtjes sociale.

Deri tani, asnjëherë nuk ka bashkëpunuar me qendrat për punë sociale. E njejta vlen edhe për bashkëpunimin me shoqatat qytetare. Në vitin 2002, një shoqatë qytetare, e cila punon në sferën e barazisë gjinore, përmes një projekti ka organizuar kurs për qepje për gratë e komunës. Që prej atëherë nuk është evidentuar ndonjë tjetër iniciativë e llojit të tillë.

1.4. Mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Në Komunën e Sarajit nuk është bërë vlerësim i nevojave të grupeve të varfëra dhe të prekshme. Nuk ka as klasifikim të të dhënave sipas kategorive, as po grupeve synuese. **Nuk ka kurrëfar mekanizmi për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme.** Përfaqësuesi i Komunës i cili u intervistua është i mendimit se nëse ekziston një bazë e tillë e të dhënave në Komunë, e njejta do të shfrytëzohet si bazë për krijimin e politikave nga sfera e përfshirjes sociale. Sipas kësaj **nuk ka as edhe identifikim të problemeve strukturale** sa i takon ç'kyçjes sociale dhe varfërisë në Komunën e Sarajit.

1.5. Sigurimi i shërbimeve sociale nga ana e vetëqeverisjes lokale

Komuna e Sarajit ndan mjete financiare për mbrojtje sociale nga alinea buxhetore për rezerva vijuese. Nga buxheti i Komunës së Sarajit për qëllime sociale gjatë vitit 2009, janë ndarë 379.400 denarë.

1.6. Përmirësim i gjendjes së personave socialisht të rrezikuar

Ligji për mbrojtje sociale²⁰ parasheh që në realizimin e të drejtës së ndihmës sociale në para, secila njësi e vetëqeverisjes lokale të ketë mundësi që të angazhojë shfrytëzues të ndihmave të aftë për punë, për të kryer punë sezonale dhe të përkohshme të interesit publik. Komuna e Sarajit deri tani për zbatimin e kryesisht punëve të interesit komunal, ka angazhuar persona nga familjet me më tepër fëmijë dhe persona të cilat marrin ndihmë sociale. Këto persona janë paguar nga 100 denarë për ushqim dhe 100 denarë për shpenzime rrugore pa honorar shtesë. Për dallim të kësaj iniciatve lokale, në nivel qendror, gjegjësisht përmes Entit për punësim, përmes programit për të papunësuar në territorin e Komunës së Sarajit janë përfshirë 100 persona të cilët kanë marrë kompenzim prej 6.000 denarë në muaj për kryerjen e punëve të interesit komunal. Ato janë angazhuar për 5-6 muaj, nga shtatori i vitit 2009 deri më janar të vitit 2010.

1.7. Investime kapitale dhe infrastrukturë në sferën e mbrojtjes sociale

Komuna e Sarajit hyri në fazën e dytë të decentralizimit, gjegjësisht në decentralizimin fiskal në vitin 2007. Si e tillë, Komuna përveç posedimit të objekteve të cilat i ka trashëguar me procesin e decentralizimit ose i ka ndërtuar,

²⁰ Neni 55 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta zyrtare e R.M. nr. 79/2009.

ka detyrë që të njejtat edhe ti financojë, të investojë në ta dhe ti mirëmbajë.²¹ Në këtë drejtim, Komuna e Sarajit deri tani në shkollën fillore **ka ndërtuar 6 klasa shtesë** dhe përpos kësaj **ka kontribuar me 50% të buxhetit komunal në ndërtimin e një ure.** 50% tjetër për ndërtimin e urës e kanë siguruar qytetarët e komunës. Në Komunën e Sarajit **nuk ka institucion parashkollor.** Përpara dy muajve me ndihmë të pushtetit qendror, gjegjësisht të Ministrisë për punë dhe politikë sociale janë vendosur themelet për ndërtimin e një institucioni parashkollor. Megjithatë, **nuk ka kornizë kohore** se deri kur e njejtat duhet të përfundohet. Në plotësim, brengos edhe mënyra se si Komuna i ka përcaktuar nevojat prioritare të qytetarëve në sferën e mbrojtjes sociale, përderisa e njejtat nuk ka miratuar program pune. Komuna **nuk ka as shtëpi as po qendër për personat e moshuar.** Komuna gjithashtu **nuk ka edhe qendër ditore për personat me nevoja të posaçme.**

2. Qendra ndër-komunale për punë sociale - Shkup

Institucioni publik Qendra ndër-komunale për punë sociale (në tekstin e mëtutjeshëm IP QNPS) është përgjegjëse për territorin e Shkupit. Prej kësaj përfundojmë se ky institucion është përgjegjës për realizimin e të drejtave nga sfera e mbrojtjes sociale dhe të drejtat nga sfera e Ligjit për familje edhe për Komunën e Sarajit. Të dhënat e prezantuara më poshtë janë relevante për qytetin e Shkupit dhe sipas kësaj edhe për Komunën e Sarajit.

- Intervista u realizua me Znj. Penka Nikollovska, punonjës social, udhëheqës i Sekcionit për punë sociale të njësive lokale të qytetit të Shkupit.

2.1. Identifikimi i grupeve të varfëra dhe të prekshme

Kategoritë e grupeve të prekshme të cilat janë të përfaqësuara në territorin e qytetit të Shkupit, sipas përfaqësueses së qendrës janë: fëmijë, nëna të vetme, persona me nevoja të posaçme dhe personat e moshuar. Nga grupet e prekshme më të përfaqësuar janë personat e moshuar në moshë mbi 65 vjeç. Disa prej tyre kanë familjarë të afërt të cilët mund të kujdesen për ta, mirëpo për shkak të obligimeve të njejtive nuk jua japin në plotësi kujdesin e nevojshëm. Për këtë shkak personat e moshuar edhe pse gjenden në gjendje të mirë materiale, kanë nevojë për shërbime të cilat duhet t'ju jepen atyre në kushte shtëpiake. Grupi i dytë i personave të moshuar janë ato të cilët nuk kanë familjarë të afërt dhe nuk janë materialisht të siguruar, për shkak të cilës edhe numërohen në këtë kategori të prekshme.

IP QNPS – Shkup nuk ka mekanizma dhe mënyra të posaçme për përcaktimin dhe identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme. Personat/Kategoritë e varfëra dhe të prekshme identifikohen në bazë individuale, gjegjësisht përmes drejtimit të klientëve në qendër dhe përmes kontrollit të drejtëpërdrejtë në familje i cili është i detyrueshëm për disa kategori të ndihmës (ndihma sociale në para, ndihma e vazhdueshme në para, kujdesi nga person i huaj dhe ndihma e njëhershme në para). Nga kjo mund të përfundohet se të dhënat e këtij institucioni lidhur me kategoritë e varfëra dhe të prekshme të qytetarëve jo domosdo e prezantojnë gjendjen reale në territorin e qytetit të Shkupit. Gjegjësisht, ky institucion bazohet në informata pasive dhe jo në një rol proaktiv në identifikimin e rreziqeve dhe vështirësive sociale me të cilat ballafaqohen qytetarët, gjë që e bën atë të papërgatitur për përgjigje dhe reagim.

²¹ Neni 22 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta zyrtare e R.M. nr. 5/2002.

2.2. Shërbime dhe qasja në shërbime në Qendrën për punë sociale

IP QNPS – Shkup përfshin, gjegjësisht shërben qytetarë të më tepër se shtatë komunave në territorin e qytetit të Shkupit, mes të cilave edhe Komunën e Sarajit (me ndarjen e fundit të komunave, është rritur numri i komunave të cilat janë nën ingerencat e këtij institucioni). Përpos IP QNPS në territorin e qytetit të Shkupit punojnë edhe shtatë njësi lokale për dhënien e ndihmës në para.

Numri total i shfrytëzuesve të ndihmës në para është 30.000 bartës (këtij numri duhet ti shtohen anëtarët e familjes të shfrytëzuesit, të cilët e bashkëndajnë këtë ndihmë). Për momentin, personat profesional të cilët punojnë në dhënien e ndihmës në para kanë një numër të madh të lëndëve dhe për shkak të procedurës administrative të madhe nuk kanë mundësi që ta kryejnë punën këshilluese (ndihmë psiko-sociale dhe përkrahje të kërkuesve të ndihmës sociale). Kjo praktikë e moszbatimit të punës këshilluese përsëritet edhe gjatë kontrollit të domosdoshëm në familjet e kërkuesit/bartësit të ndihmës në para. Nga kjo mund të përfundojmë se, në mungesë të marrëdhënieve proaktive në identifikimin e kategorive të prekshme të qytetarëve, në plotësim nuk shfrytëzohet mundësia për sigurim të ndihmës dhe përkrahjes për ato të cilët vetë drejtohet tek ky institucion.

Identifikua më tepër pengesa në realizimin e të drejtave nga sfera e mbrojtjes sociale, të cilat si mungesa strukturore depërtojnë në të gjitha komunat në të cilat e zbatuam përcaktimin e gjendjes faktike. Në këtë aspekt, të gjitha pengesat e përmedura më poshtë, të cilat i kufizojnë/pamundësojnë grupet e varfëra dhe të prekshme, janë relevante për të gjitha komunat dhe nuk përsëriten në tekstin e mëtejshëm. Kështu që, **Ligji për mbrojtje sociale parasheh disa kushte të caktuara për fitimin e ndihmës në para, mes të cilave edhe kufizimin e të ardhurave në ekonominë shtëpiake të kërkuesit**, për shkak të cilit kriter klientët që janë të interesuar nuk mund ti realizojnë të drejtat nga mbrojtja sociale. Për shembull, sipas Ligjit për mbrojtje sociale për fitimin e ndihmës së përhershme në para, kërkuesi – anëtarët e familjes së tij nuk duhet të kenë të ardhura mujore më të larta se 4.000 denarë për person. Në rast se ndodh që kjo shumë të tejkalohet, qoft edhe për një denarë, atëherë kërkuesi nuk do ta realizojë të drejtën nga ky lloj i ndihmës në para. Gjithashtu, **familjet me më shumë gjenerata të cilat jetojnë në një shtëpi ballafaqohen me problemin e mos fitimit të ndihmës në para**. Në këtë mënyrë, në vend që të merren parasysh nevojat për ndihmë të anëtarëve të familjes së kërkuesit të ndihmës, merren parasysh të ardhurat e ndonjë anëtari tjetër të familjes, si bazë për mos dhënien e ndihmës në para. Përcaktuam se përpos rasteve të cekura nga praktika lidhur me realizimin e ndihmës në para, ekziston edhe pengesa për një realizim të tillë për shkak të kujdesit dhe ndihmës së supozuar nga ana e familjarëve të afërt. Kështu që, kërkuesit e ndihmës në para intervistohen dhe hulumtohen lidhur me mundësitë për ndihmë dhe përkrahje e cila mund t'ju jepet nga familjarët e afërt, mandej duke mos i llogaritur marrëdhëniet e tyre (marrëdhënie familjare të prishura). Në rast se familjarët e afërt nuk e sigurojnë përkrahjen e nevojshme, nga ana e qendrës për punë sociale inicohet padi penale. Kjo situatë e detyron kërkuesin që automatikisht të hejë dorë nga kërkesa e ndihmës sociale për shkak të përgjegjësisë së mundëshme penale të të afërmeve të tij. Në plotësim, përcaktuam edhe **një mungesë të caktuar sa i takon të drejtës së shfrytëzimit të shtesës feminare**. Gjegjësisht, kusht për shfrytëzimin e saj është ajo që njëri ose të dy prindërit duhet të jenë të punësuar. Me këtë gjë kufizohen prindërit e papunësuar, gjegjësisht shfrytëzuesit e ndihmave në para nuk mund ta shfrytëzojnë edhe këtë ndihmë. E njëjta vlen edhe për prindërit të cilët janë të punësuar, mirëpo realizojnë të ardhura më të larta nga ato të cilat

janë paraparë me ligjin për dhënien e kësaj shtese. Përpos kësaj, sipas ligjit (Ligji për mbrojtjen e fëmijëve), shtesa fëminore mund të jepet në një shumë maksimale prej 2.415 MKD (40 euro), pa e marrë parasyshë numrin e fëmijëve në një familje.

Nga ana tjetër, mjetet nga ndihma sociale nuk janë të mjaftueshme për plotësimin e nevojave kryesore ekzistenciale të një personi. Kjo është relevante edhe për format tjera të ndihmës në para. Është e nevojshme që ndihma në para të llogaritet individualisht, për secilin rast veçmas, gjegjësisht ajo të llogaritet sipas nevojave – shpenzimeve të kërkuarit (shporta shpenzuese në shtetin tonë nuk i përfshin shpenzimet për veshje, shpenzimet e regjisë dhe nevojat tjera të një familjeje dhe nga kjo përfundojmë se ajo nuk është një bazë relevante për përcaktimin e shumës së ndihmave në para). Në plotësim, gjendja e shfrytëzuesve të të gjitha llojeve të ndihmave në para në plotësim vështirësohet gjatë sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm. Një pjesë e dokumentacionit sigurohet duke paguar një shumë të caktuar. Ligji për mbrojtje sociale përcakton kushte me të cilat kufizohen të ardhurat në një ekonomi shtëpiake, për shkak të cilave kushte klientët nuk mund ti realizojnë të drejtat e tyre nga mbrojtja sociale. Mu për shkak të kësaj duhet të bëhet vlerësim i nevojave të personave të cilët kanë nevojë për mbrojtje sociale.

Është e vlefshme të përmendet se në territorin e qytetit të Shkupit punojnë më tepër qendra ditore të dedikuara për fëmijët në rrugë, fëmijët e sëmurë nga paraliza celebrale dhe fëmijët me nevoja të posaçme. Gjithashtu, janë hapur shtatë kuzhina popullore prej të cilave shfrytëzuesit marrin ushqim të ngrohtë. Kapaciteti i një kuzhine ditore është 200 ushqime në një ditë. Ky shërbim nuk është i qasëshëm për të gjithë shfrytëzuesit e ndihmës sociale, gjegjësisht përfshin një pjesë të personave të cilët janë materialisht të rrezikuar. Për shfrytëzuesit e ndihmës sociale dhe ndihmës së përhershme në para nga viti i kaluar (viti 2009) janë krijuar kartela për blerjen e produkteve ushqimore për çmime më të ulta në një numër të caktuar të shitoreve. Nga ky vit janë inicuar subvencione për energji elektrike në një shumë prej 600 denarëve në muaj, për shfrytëzuesit e ndihmës sociale dhe ndihmës së përhershme në para. Një pjesë e këtyre llojeve të ndihmës (kuzhinat popullore, kartelat dhe subvencionet për energji elektrike) realizohen si aktivitete projektuese të parapara me programin për punë të qeverisë dhe nuk është e qartë nëse të njejtat do të bëhen pjesë përbërëse e ndihmës së rregullt dhe përkrahjes së qendrave për punë sociale. Gjegjësisht, iniciimi i një ndihmë të këtillë qartësisht e tregon nivelin e varfërisë për shkak se lloji i kësaj ndihme jepet për sigurimin e "ekzistencës lakuriqe".

Sa u takon kapaciteteve, IP QNPS – Shkup nuk ka në disponim numër të mjaftueshëm të personelit profesional dhe teknik, si dhe paisje të përshtatshme teknike, zyra, vetura terrenike, paisje kompjuterike; gjëra të cilat do të mundësojnë sigurimin profesional dhe të përshtatshëm të ndihmës. Në vijim është edhe përgatitja e programit për rrjetëzim me institucionet tjera shtetërore, qëllimi i të cilit është lehtësimi gjatë kompletimit të dokumentacionit të nevojshëm për bërjen e kërkesës për secilën të drejtë nga sfera e mbrojtjes sociale. Me këtë program të shumëpritur, do të lehtësohet puna administrative e punonjësve social. Në IP QNPS – Shkup, në asnjërin nga sektoret nuk ka të siguruar vend për pritje, përderisa në njësitë lokale nuk ka të siguruar mjedis të përshtatshëm për pritje dhe punë me klientët, gjë me të cilën nuk sigurohet diskrecioni për të gjithë klientët të cilët drejtohen në këtë institucion. Shpesh ndodh që në një zyrë të priten dhe të punohet me nga dy kërkuar të ndihmës në para me çfarë anashkalohet diskrecioni.

Me qëllim që QPS-Shkup ti plotësojë adekuatshëm nevojat e qytetarëve, sipas përfaqësuese së këtij institucioni duhet të punësohet personel profesional dhe të sigurohen kushte ambientale, vetura terrenike dhe ndihmesa teknike. Sa i takon lëndës së punës së tyre janë të mendimit se duhet të zhvillohet puna preventive dhe më tepër të jenë prezent në terren (mes qytetarëve).

2.3. Preventiva dhe përkrahja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Ligji për mbrojtje sociale parasheh që preventivë sociale të kryejnë qendrat për punë sociale. Gjendjet tregojnë se preventiva sociale nuk praktikohet. Sipas deklaratave të përfaqësueses së IP QNPS – Shkup, ato nuk kanë kushte për të bërë punë preventive mu për shkak të punës së madhe administrative dhe mungesës së kuadrit profesional. Për shkak të kësaj punonjësit profesional kanë propozuar që preventivën sociale të kryej një njësi e posaçme organizuese. Në këtë mënyrë punonjësit profesional do të mund të bëjnë preventivë përmes punës terrenike. Në veçanti theksohet nevoja për punë preventive në procesin arsimor.

2.4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Siqë më e cekëm, IP QNPS – Shkup përpos asaj që nuk ka mekanizma dhe mënyra për ti identifikuar grupet e varfëra dhe të prekshme, në të njejtën kohë as që realizon konsultime me ta. Me të gjitha kategoritë e shfrytëzuesve punohet në nivel individual, pa mos i përcaktuar nevojat e tyre të përbashkëta dhe ajo që është edhe më e rëndësishme, pa mos i marrë parasysh mënyrat e përshtatshme të sigurimit të ndihmës dhe përkrahjes.

2.5. Bashkëpunimi i Qendrës për punë sociale me vetëqeverisjen lokale dhe institucionet/organizatat tjera

Mbrojtja dhe ndihma e përshtatshme për kategoritë e varfëra dhe të prekshme do të thotë edhe bashkëpunim të ndërmjetshëm mes QPS, si bartës të mbrojtjes sociale nga njëra ana dhe institucionet dhe organizatat tjera, të cilat kanë kompetenca ose ofrojnë mbrojtje nga sfera e mbrojtjes sociale. Mu për shkak të kësaj na interesonte bashkëpunimi që IP QNPS – Shkup e realizon me njësitë e vetëqeverisjes lokale (në tekstin e mëtutjeshëm NJVL), Ministrinë për punë dhe politikë sociale (në tekstin e mëtutjeshëm MPPS), shoqatat qytetare dhe biznes sektorin.

Bashkëpunimi i IP QNPS – Shkup me njësitë e vetëqeverisjes lokale, territorin e të cilave, gjegjësisht qytetarët e të cilave i shërben mund të vlerësohet si i pakënaqshëm. Deri më tani, njësitë e vetëqeverisjes lokale drejtohen tek IP QNPS – Shkup vetëm për të marrë të dhëna për numrin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale të cilët jetojnë në territorin e tyre. Një pjesë e bashkëpunimit bëhet përmes anëtarësimit të QPS në këshillet lokale në ato NJVL të cilat i kanë të formuara këto. Në plotësim mungon bashkëpunimi me pushtetin lokal në vendet rurale. E vetmja formë e bashkëpunimit konkret mes këtyre dy subjekteve, të cilat kanë kompetenca të përbashkëta në sferën e mbrojtjes sociale, zhvillohet përmes angazhimeve të përkohshme të një pjese të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para (për një periudhë gjashtë mujore) për nevojat e sekcioneve komunale në NJVL.

Sa i takon bashkëpunimit me ministrinë relevante, gjegjësisht MPPS, IP QNPS – Shkup e vlerëson atë si të përditshme dhe të kënaqshme. Situata ekonomik-politike në shtet dhe përqindja e lartë e varfërisë, mbi 30%, e bëjnë qytetin e

Shkupit një mjedis tepër të eksponuar në rrezikun social. Nga kjo del se nevoja e qytetarëve për ndihmë dhe përkrahje është e madhe, por edhe e shumëllojshme (dukuritë të cilat shfaqen si rezultat i rreziqeve sociale). Mu për këtë shkak këto vlerësime për bashkëpunimin me ministrinë e përgjegjeshme duken joreale. IP QNPS – Shkup ka bashkëpunim të mirë me Agjencinë për punësim në fushën e shkëmbimit të informatave, ndërsa për projektet lidhur me punësimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale (masat aktive për punësim) ato nuk disponojnë me të dhëna. Sipas deklaratës së përfaqësueses së IP QNPS – Shkup, me këto të dhëna disponon ministria resore. Nga projektet të cilat deri tani janë zbatuar – masat aktive për punësim janë vlerësuar si të paqasëshme dhe diskriminuese. Këto masa vitin e kaluar ju ishën të ofruara viktimave të dhunës familjare dhe një pjesë e tyre i shfrytëzuan dhe u punësuan. Nëse viktimat – e punësuar përmes këtyre masave vendos që ta braktisi punën e dhënë përpara afatit të caktuar, Agjencia për punësim ka të drejtë që të njejtën mos ta regjistrojë si të papunësuar, gjegjësisht ta pamundësojë atë që ta shfrytëzojë të drejtën e mbrojtjes sociale në një periudhë tre vjeçare. IP QNPS – Shkup nuk ka informata nëse dhe deri në cilën masë agjencia ofron punësim për klientët e saj.

IP QNPS – Shkup bashkëpunimin e saj me disa shoqata qytetare e vlerëson si të mirë. Duhet të ceket se qendrat për punë sociale nuk kanë politikë as po strategji për bashkëpunim me shoqatat qytetare. Informatat tona të cilat burojnë nga praktika, tregojnë për një bashkëpunim në raste kur i njejtë është i inicuar dhe financiarisht i përkrahur nga vetë shoqatat qytetare.

QPS Shkup nuk ka ndonjë bashkëpunim të madh me biznes sektorin. Në rastin konkret bëhet fjalë për kërkesa për donacione nga ana e QPS. I vetmi shembull i bashkëpunimit të vazhdueshëm realizohet me marketet Tineks, të cilët punësojnë fëmijë pa prindër dhe kujdes prindëror.

3. Të dhëna nga fokus grupet e organizuara

Për ta përcaktuar gjendjen me grupet e prekshme në Komunën e Sarajit, u organizuan intervista me dy fokus grupe. Njëri fokus grupi përbëheshte prej grave të nacionalitet maqedonas dhe shqiptar, ndërsa tjetri prej burrave të nacionalitetit maqedonas dhe shqiptar.

3.1. Personat e moshuar

Për shkak të ardhurave minimale nga pensioni, nga ndihma e përhershme në para dhe nga kujdesi i huaj, tek personat e moshuar në Komunën e Sarajit dominon varfëria. Këto mjete financiare nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale. Në Komunën e Sarajit nuk ka institucion publik shëndetësor për mbrojtje shëndetësore sekondare, kështu që personat e moshuar janë të detyruar të udhëtojnë në komunitat tjera, gjë që në plotësim e vështirëson gjendjen e tyre shëndetësore dhe financiare. Dukuria e mungesës së barnave, të cilat janë në ngarkesë të Fondit për sigurim shëndetësor, gjithashtu e vështirëson gjendjen e personave të moshuar për shkak se ato duhet ti blejnë barnat e nevojshme edhe pse të njejtat janë në listën pozitive. Pagesa e participimit në institucionet për mbrojtje shëndetësore sekondare dhe terciare, gjithashtu paraqet një barrierë për shfrytëzimin e këtyre shërbimeve nga ana e personave të moshuar. Personat e moshuar nuk janë të kënaqur nga kualiteti i shërbimeve të cilat i marrin nga institucionet publike shëndetësore. Ndihma e shpejtë vonohet edhe për disa orë që të intervenojë në thirrje urgjente për personat e moshuar. Kushtet banuese janë relativisht të mira për shkak se familjarët e afërt çdoherë kujdesen për personat e moshuar. Shtëpitë publike dhe private për personat e moshuar të kësaj komune janë të paqasëshme. Personat e moshuar për tu vendosur në shtëpitë publike ballafaqohen me probleme lidhur me numrin e kufizuar të vendeve dhe kushtet e këqia në aspekt të higjienës dhe ushqimit. Personat e moshuar nuk mund të vendosen në shtëpitë private për të moshuarit për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Personat e moshuar për ti realizuar të drejtat nga mbrojtja sociale ballafaqohen me probleme në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm.

3.2. Gra

Si një kategori posaçërisht e prekshme identifikohen nënat e vetme, gratë të cilat janë shfrytëzues të ndihmës në para dhe gratë viktime të dhunës familjare. Kushtet e jetesës janë vlerësuar si të mira.

Sa i takon punësimin, vërehet diskriminim gjatë punësimin të grave në moshë mbi 35 vjeçe. U theksua se ekziston korrupcioni gjatë punësimin. Në Komunën e Sarajit papunësia mes grave dhe burrave është e njejtë.

Gratë janë të njoftuara me të drejtat nga mbrojtja shëndetësore, mirëpo për shkak të gjendjes së vështirë financiare nuk i shfrytëzojnë rregullisht shërbimet shëndetësore. Masat PAP të cilat i promovon qeveria për mbrojtje shëndetësore, nuk janë të mjaftueshme për tu siguruar shërbime kualitative për gratë.

Qendra për punë sociale nuk ju siguron mbrojtje adekuate grave-viktima të dhunës familjare, tregtisë me njerëz dhe prostitucionit, duke i përfshirë edhe të miturat. Shelter qendra nuk është një zgjidhje e përshtatshme për gratë-viktima të dhunës familjare për shkak të kufizimit kohor. Organet persektuese duhet që urgjentisht të reagojnë me çfarë dhunuesi mënjëherë do të sanksionohet për vepër penale. Sa i takon dhunës familjare gruaja nuk mbrohet nga ana e shtetit.

3.3. Fëmijë

Në Komunën e Sarajit nuk ka çerdhe për fëmijët e moshës parashkollore. Më tepër vite qytetarët e Komunës së Sarajit kanë bërë kërkesë në Komunë për hapjen e çerdes por nuk kanë marrë përgjigje. Përpos kësaj u theksua mungesa e terreneve sportive, parqeve dhe objekteve kulturore të dedikuara për fëmijët.

Fëmijët e moshës shkollore të nacionalitetit maqedonas, të cilët janë në numër më të vogël se fëmijët e nacionalitetit shqiptar kanë vështirësi në ndjekjen e mësimit për shkak se ato janë të detyruara që ta ndjekin procesin arsimor në shkollat të cilat gjenden në komunat tjera dhe çdo ditë duhet të udhëtojnë me autobus deri tek ato shkolla. Kjo gjendje është e tillë për shkak se mësimi paralelisht ndiqet nga dy klasa të ndryshme. Për shembull klasa e shtatë dhe e tetë ndjekin mësim së bashku. Njërës klasë i jepet mësim 20 minuta dhe pastaj tjetrës gjithashtu 20 minuta. Për shkak të kësaj fëmijët nuk fitojnë arsim kualitativ, as po kushte të përshtatshme për ndjekjen e mësimit. Kushtet teknike për mësim janë gjithashtu të pakënaqshme (në shkollë nuk ka dërrasë të zezë, shkums, mikroskop).

Fëmijët nuk kanë mundësi që ti realizojnë të drejtat nga sfera e mbrojtjes sociale për shkak të kushteve të cilat duhet të përmbushen, a në veçanti kushti i cili parasheh kufizimin e të ardhurave në familje. Mjetet financiare të ndihmës në para të parapara për fëmijët, nuk i plotësojnë nevojat e tyre kryesore ekzistenciale.

Në çerdhe nuk ka kushte për fëmijët me nevoja të posaçme. Kjo kategori e fëmijëve nuk ka mundësi që ta shfrytëzojë këtë shërbim. Në shkollën e Komunës së Sarajit është anuluar klasa e cila ka qenë e përkushtuar për fëmijët me nevoja të posaçme. Shkollat e specializuara ofrojnë kushte të mira për ndjekjen e mësimit për këtë kategori të fëmijëve.

3.4. Personat me nevoja të posaçme

Personat me nevoja të posaçme janë një kategori e prekshme në Komunën e Sarajit. Për këtë kategori të personave më së shpeti kujdesen familjarët e afërt. Kujdesin të cilin e siguron shteti për personat me nevoja të posaçme është i pamjaftueshëm. Institucionet psikijatrike dhe qendrat për punës sociale nuk kujdesen mjaft për këtë kategori të personave. Është evidentuar përdorimi i dhunës nga ana e të punësuarve në spitalet psikijatrike mbi personat me nevoja të posaçme të cilët i shfrytëzojnë këto shërbime. Për punësimin e kësaj kategorie të personave biznes sektori shfrytëzon subvencione nga shteti. Mirëpo ato i keqërdorin personat me nevoja të posaçme duke ju dhënë atyre rrogë minimale dhe duke mo jua siguruar kushtet e përshtatshme për punë. Për realizimin e të drejtave nga mbrojtje sociale, personat me nevoja të posaçme kanë probleme sa i takon grumbullimit të dokumentacionit të nevojshëm. Gjendja e kërkuesve në plotësim vështirësohet me pagesën e cila duhet të bëhet për një pjesë të dokumenteve. Për shkak të kufizimeve të parapara lidhur me të ardhurat në një familje, ato nuk mund ti realizojnë të drejtat e tyre të cilat jua ofron ligji. Shuma e mjeteve nga ndihma në para nuk është e mjaftueshme për plotësimin e nevojave elementare të këtyre personave.

3.5. Rom

Në Komunën e Sarajit mes popullatës rome mbisundon vafëria. Ato diskriminohen në bazë të përkatësisë etnike. Romët janë me nivel më të ulët të arsimit ose po janë të paarsimuar dhe kjo e vështirëson gjendjen e tyre për

shkak se nuk janë të njoftuar me të drejtat të cilat mund ti realizojnë. Kushtet jetësore tek bashkësia rome janë të pakënaqshme dhe nuk i plotësojnë nevojat kryesor ekzistenciale për jetesë. Ka fëmijë të nacionalitetit rom të cilët nuk janë të regjistruar tek institucionet kompetente dhe nuk kanë çertifikatë nga libri amë i të lindurve. Për shkak të kësaj ato nuk mund ta realizojnë të drejtën e tyre nga mbrojtja sociale, nuk janë rregullisht ose aspak të vaksinuar dhe e kanë të kufizuar të drejtën e arsimit. Sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e të drejtave nga sfera e mbrojtjes sociale paraqet problem për personat e nacionalitetit rom.

3.6. Pakica

Pjesëmarrësit nuk kanë informata për përfaqësinë e pakicave në Komunën e Sarajit.

B. Komuna e Kërçovës

1. Njësia e vetëqeverisjes lokale – intervista u zbatua me Z. Marjan Dimoski, udhëheqës i Sektorit për çështje juridike dhe të përgjithshme në Komunën e Kërçovës.

1.1. Mekanizma institucionale për mbrojtje sociale në Komunën e Kërçovës

Në Komunën e Kërçovës ka Sektor për çështje juridike dhe të përgjithshme. Në këtë sektor të punësuarit të cilët punojnë si nëpunës shtetëror i shqyrtojnë edhe çështjet e mbrojtjes shëndetësore, sociale dhe feminare në komunë.

Në kornizat e Këshillit të Komunës së Kërçovës ka komision të përhershëm për shëndetësi, nën kompetencat e të cilit janë edhe çështjet e mbrojtjes sociale. Sa i takon punës së tij, komisioni takohet për miratimin e programit për mbrojtje sociale dhe ad hoc në varësi nga rastet ose nevoja për zgjidhjen e disa çështjeve të caktuara. Nëse ka ndonjë pikë në agjendën ditore të seancës së Këshillit lidhur me këtë fushë, komisioni domosdoshëm takohet.

1.2. Programe dhe plane vepruese nga sfera e mbrojtjes sociale duke përfshirë edhe programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve

Në Komunën e Kërçovës **në kontinuitet miratohet program pune për mbrojtjen sociale, shëndetësore dhe feminare.** I vetmi përjashtim është viti 2008, për të cilin vit nuk ekziston program pune. Plan-programi për mbrojtjen shëndetësore, sociale dhe feminare për vitin 2010, i cili është përgatitur në dhjetor të vitit 2009, **ende nuk është miratuar nga ana e Këshillit të Komunës.** Për zbatimin e programit, **nuk ka plan veprues adekuat, as edhe kornizë kohore** për ndjekjen e zbatimit të planit. Programi aktual, i përgatitur në dhjetor të vitit 2009, **përbëhet prej 10 projekteve.** I konceptuar në këtë mënyrë **programi është tepër i përgjithshëm, pa qëllime specifike dhe rezultate evidente nga zbatimi eventual i të njejtit.** Për të duhet të ndahen 760.000 denarë nga buxheti i Komunës edhe atë:

1. për përkrahjen dhe stimulimin e studentëve dhe post-diplomikëve nga familjet me të ardhura të ulta - 400.000 denarë;
2. për kujdes të personave të moshuar dhe atyre socialisht të rrezikuar - 300.000 denarë;
3. për përkrahje të fëmijëve me nevoja të posaçme - 30.000 denarë dhe
4. për ndihmë tjetër sociale - 30.000 denarë.

Edhe pse në program qëndron se "në bashkëpunim me segmente të ndryshme, do të realizohen aktivitete projektuese të cilat do të sjellin deri tek realizimi i projekteve vijuese"²², mbetet e paqartë se si program i cili nuk është miratuar nga Këshilli i Komunës do të realizojë aktivitete prej tij në vitin 2010.

Në Komunë **nuk ekziston bashkëpunimi ndër-sektoral për krijimin e planeve dhe propozimeve** me komisionet dhe sektoret e tjera për çështje të kësaj sfere (për shembull me komisionin për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave etj.). Sa u takon krijimit të programeve, shumë shpesh të punësuarit

²² Plan-program për mbrojtje shëndetësore, sociale dhe feminare në Komunën e Kërçovës për vitin 2010.

në administratën shtetërore përgatisin plan rreth disa çështjeve të caktuara dhe japin iniciativa të cilat më vonë vetë këshilltarët i shqyrtojnë në komisionin adekuat.

Komuna e Kërçovës **asnjëherë nuk ka miratuar as po propozuar programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve**, të cilët jetojnë në territorin e saj. Në Komunë **ka vetëm strategji për zhvillim**, por e ndërlihet me tjera sfera të interesit.

1.3. Mekanizma për konsultim dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal dhe ndërkombëtar dhe bashkëpunimi mes institucioneve relevante nga sfera e mbrojtjes sociale dhe shoqatat qytetare

Në Komunën e Kërçovës në çdo seancë të Këshillit thirren mediat lokale. Të gjitha vendimet e Këshillit të Komunës publikohen në Gazetën zyrtare. Qytetarët marrin informata edhe nga ueb faqja e Komunës. Shumë shpesh, në këtë ueb faqe mungon një numër i madh i dokumenteve, të cilat mund të jenë në interes të palëve të ndryshme. Bashkëpunimi më së shpeshti bëhet me kryetarët e bashkësive lokale, gjegjësisht urbane ose shoqatat qytetare. **Në sferën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale deri tani nuk ka pasur asnjë iniciative.** Më tepër konsultime bëhen për sferën e infrastrukturës. Shembull për këtë është iniciativa për ndërtimin e një ure, e inicuar nga shoqatat qytetare dhe bashkësitë lokale. Megjithatë, përpos këtyre formave për veprim dhe dhënie të informatave të cilat janë të rregulluar me ligj, **nuk ka mekanizma të përshtatshme për konsultime dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në këtë Komunë. Nuk është inicuar iniciativë qytetare, e nënkuptuar nga aspekti i rregullave normative** për këto çështje. Iniciativa për bashkëpunim ndërlihet vetëm me rastet kur shoqatat qytetare dorëzojnë projekt në të cilin e përfshijnë edhe komunën.

Bashkëpunimi me qendrat për punë sociale është inicuar në disa projekte. Sidoqoftë, **nuk ka mekanizma të përcaktuar për konsultime dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal.** Si përmbledhje mund të themi se komunikimi zhvillohet përmes lidhjes së drejtëpërdrejtë me qytetarët të cilët kanë nevojë për ndihmë ose përmes takimeve me bashkësitë lokale.

1.4. Mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Në Komunën e Kërçovës nuk bëhet vlerësim i nevojave të grupeve të varfëra dhe të prekshme. **Nuk ka bazë të dhënash për çështjet e ndërlidhura me mbrojtjen dhe përfshirjen sociale.** Nuk ka klasifikim të dhënash sipas kategorive as po grupeve synuese. **Nuk ka kurrëfar mekanizmi për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme.** Informatat për listën e personave të cilët marrin ndihmë sociale merren vetëm nga Qendra për punë sociale. Komunikimi në këtë aspekt bëhet vetëm nëse vjen kërkesë për ndihmë ose konsultim nga qytetarët. Qytetarët të cilët kanë ndonjë problem të caktuar drejtohen me kërkesë tek Këshilli dhe tek kryetari. **Komuna më veti nuk bën vlerësim të nevojave të grupeve të varfëra dhe të prekshme.**

1.5. Sigurimi i shërbimeve sociale nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale

Komuna e Kërçovës ndan mjete financiare për mbrojtje sociale nga alinea buxhetore për rezerva vijuese. Për vitin 2010, janë ndarë gjithsej 760.000 denarë.

Komuna deri tani ka aplikuar për projekte nga sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. Këtu është i vlefshëm për tu përmendur projekti për fëmijët me nevoja të posaçme dhe projekti për përfshirjen e fëmijëve rom. Projekti i dytë është inicuar nga Ministria për transport dhe lidhje në të cilin participon edhe vetë komuna. Projekti për përfshirjen e fëmijëve rom në institucion parashkollor rrjedh gati 3 vite, duke filluar nga viti 2007. Asnjëri fëmijë rom deri tani nuk ka ndjekur çerdhe. Me këtë projekt sigurohet transport falas për fëmijët rom deri te çerdhet. Megjithatë, **nuk ka mekanizma për ndjekjen e asaj se sa fëmijë pas sigurimit të llojit të tillë të shërbimit kanë filluar që ta ndjekin institucionin parashkollor.**

Komuna dy herë e ka ndihmuar qendrën ditore për persona me nevoja të posaçme duke blerë TV, video dhe audio paisje dhe lojëra.

Në bashkëpunim me Ministrinë për punë dhe politikë sociale, është viti i tretë i realizimit të projektit "Kuzhina popullore". Komuna nga Qendra për punë sociale merr listë për marrësit e ndihmës sociale, siguron vend dhe i paguan të punësuarit në kuzhinë. Ministria i siguron produktet. **82 qytetarë e shfrytëzojnë këtë shërbim në "kuzhinën popullore".**

Për personat të cilët marrin ndihmë sociale ndahen nga 4 kub dru për familje, në afat kuartal, që do të thotë 8 kub dru në vit për një familje. Për këtë qëllim të dhënat merren nga Qendrat për punë sociale.

Gjithashtu, Komuna ka siguruar edhe ndihmë financiare për natën e maturës për fëmijët pa prindër dhe të ngjajshëm.

Në sferën e banimit, Komuna posedon baraka për vendosjen e personave në rrezik social, të cilat janë dhuruar nga Republika e Bullgarisë, në të cilat banojnë 17 familje.

Sa u takon projekteve, Komuna përmes diasporës në Amerikë dhe Australi ka dhënë paketa për ndihmë. Është realizuar projekt me USAID për kursimin e energjisë për nxemje me avull.

Në vitin 2009 është zbatuar projekt për ndërtimin e trapeve të qasëshme përpara të gjitha institucioneve relevante, ndërsa përpara tre muajve është organizuar një aksion për shënimin e vend-parkimeve për personat me invaliditet.

1.6. Përmirësim i gjendjes së personave socialisht të rrezikuar

Ligji për mbrojtje sociale²³ parasheh që në realizimin e të drejtës së ndihmës sociale në para, secila njësi e vetëqeverisjes lokale të ketë mundësi që të angazhojë shfrytëzues të aftë për kryerjen e punëve sezonale ose të përkohshme të interesit publik. Komuna e Kërçovës deri tani përmes masave aktive për punësim të qeverisë së R.M., dhe një pjesë përmes UNDP-së, ka angazhuar 30 persona të cilët kanë qenë të ndarë në tre grupe dhe të cilët përmes Sekcionit për

²³ Neni 55 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 79/2009

punë komunale kanë kryer punë sezonale. Komuna u ka paguar honorar prej 8.500 denarë për zbatimin e kryesisht punëve të interesit komunal. Këto angazhmane kanë zgjatur 5 muaj. Megjithatë, **Komuna nuk posedon plan strategjik për përmirësimin e gjendjes së personave socialist të rrezikuar.** Aktivitetet janë projekte afat-shkrutëra nga të cilat nuk mund të shihen rezultate konkrete në afat të mesëm dhe të gjatë.

1.7. Investime kapitale dhe infrastrukturë në sferën e mbrojtjes sociale

Komuna e Kërçovës hyri në fazën e dytë të decentralizimit, gjegjësisht në decentralizimin fiskal në vitin 2010. Si e tillë, komuna përveç posedimit të objekteve të cilat i ka trashëguar me procesin e decentralizimit ose i ka ndërtuar, ka detyrë që të njejtat edhe ti financojë, të investojë në ta dhe ti mirëmbajë.²⁴ Në këtë drejtim, Komuna e Kërçovës në sferën e mbrojtjes sociale në aspekt të infrastrukturës **në çerdhen ka ndërtuar pjesë shtuese për personat me nevoja të posaçme.**

Komuna **ka shtëpi për persona të moshuar, qendër ditore për personat me nevoja të posaçme.** Komuna **nuk ka qendër ditore për të rinj, as po qendër ditore për fëmijët në rrugë.** Në shtëpinë për persona të moshuar Komuna përsëri ndihmon nëse prej atje kërkojnë ndihmë. Me ta deri tani kanë pasur një projekt për kursimin e energjisë elektrike dhe për nxemje me avull.

2. Qendra për punë sociale - Kërçovë

Qendra për punë sociale – Kërçovë me punën e saj përfshin territorin e pesë komunave, gjegjësisht shërben mbi 70.000 qytetarë.

– Intervista u realizua me Znj. Dragica Naumovska, punonjës social në Qendrën për punë sociale në Kërçovë.

2.1. Identifikimi i grupeve të varfëra dhe të prekshme

Në Komunën e Kërçovës janë prezente të gjitha kategoritë e prekshme. Duke e pasur parasysh se QPS – Kërçovë punon në parimin e regjistrimit, problemet e disa kategorive të prekshme adresohen vetëm nëse të njejtat paraqiten nga ana e klientëve. Nga eksperiencia e QPS –Kërçovë, fëmijët paraqiten si një kategori shumë e prekshme e shfrytëzuesve. Mes tyre paraqiten fëmijët delikuentë, fëmijët pa kujdes prindëror dhe fëmijët e involvuar në probleme familjare. Gratë si një kategori e prekshme, përveç me varfërinë e cila është bazë për shfrytëzimin e ndihmës në para, më së shumti paraqiten si viktimat të dhunës familjare dhe si klientë në proceset divorcuese. Romët si nacionalitet janë më të përfaqësuar si grup i prekshëm në shfrytëzimin e ndihmës në para, për shkak të shkallës së theksuar të varfërisë, ndërsa fëmijët rom janë më të përfaqësuar si delikuent të mitur. Gjithashtu, paraqiten si shfrytëzues në bazë të problemeve dhe dhunës familjare. Personat me nevoja të posaçme paraqiten si shfrytëzues të së drejtës së shtesës feminare dhe të drejtës së kujdesit. Në Komunën e Kërçovës ekziston një qendër ditore për persona me nevoja të posaçme, ndërsa strehimi institucional vazhdimisht e më pak po praktikohet. Personat e moshuar janë më pak të përfaqësuar por janë një kategori tepër e prekshme, në veçanti nga aspekti i strehimit, mbrojtjes dhe vendosjes.

²⁴ Neni 22 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 5/2002.

Qendra për punë sociale (në tekstin e mëtuftjeshëm QPS) në Komunën e Kërçovës nuk ka mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme dhe kjo bëhet vetëm me iniciativën e klientëve gjatë regjistrimit. QPS në përgjithësi ballafaqohen me mungesë të resurseve teknike dhe profesionale. Për dallim të tyre, QPS – Kërçovë disponon me profilet e tjera profesionale dhe personelin teknik të nevojshëm. Puna preventive është më pak prezente në QPS Kërçovë. Sipas deklaratës të përfaqësueses të QPS preventivën do ta punojnë vetëm nëse kanë mundësi: *"Nëse kemi vetura dhe njerëz do ta punojmë edhe atë"*.

2.2. Shërbimet dhe qasja në shërbime

Shërbimet të cilat i ofron QPS në Komunën e Kërçovës janë në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale dhe Ligjin për familje.

Numri i shfrytëzuesve të ndihmës në para në Komunën e Kërçovës është 700 – 800 shfrytëzues. Si edhe IP QNPS – Shkup edhe në Kërçovë ndihma në para është minimale dhe nuk i plotëson nevojat reale. Gjatë dorëzimit të kërkesës për ndonjë lloj të mbrojtjes sociale, klientët ballafaqohen me probleme në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm. Nëse të njëjtin nuk mund ta sigurojnë, për shembull dokumentacionin për personat me nevoja të posaçme për shkak të komplikimit të tij, sigurohet me kërkesën zyrtare të punonjësve social deri tek institucionet relevante. Në shfrytëzimin e ndihmës në para është evidentuar problemi në praktikë lidhur me marrjen e mjeteve të cilat fillojnë të mirren pas mbarimit të muajit kur është miratuar kërkesa. Ndhma në para e njëhershme për shkak të mungesave të mjeteve për moment nuk sigurohet në QPS – Kërçovë.

Në Komunën e Kërçovës ka një qendër ditore për personat me nevoja të posaçme. Kapaciteti i kësaj qendre është për 20 persona. Nga shatori i këtij viti (2010), për shkak të mungesës së mjeteve nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale është anuluar një haje në qendrën ditore. QPS-Kërçovë e përshkruan eksperiencën nga qendra ditore si pozitive duke e shfaqur nevojën për hapjen e më tepër qendrave të cilat ku do të përfshijnë edhe kategori të tjera njerëzish.

Në Komunë ka një kuzhinë popullore me kapacitet prej 80 hajeve. Sipas përfaqësueses të QPS – Kërçovë, numri i ushqimeve nuk është i mjaftueshëm në krahasim me numrin e shfrytëzuesve të ndihmës sociale në Komunë. Kuzhina popullore i plotëson nevojat për qytetin e Kërçovës dhe jo nevojat e shfrytëzuesve të komunave tjera (siqë më përmendëm, kjo QPS përfshin një territor prej pesë komunave). Më saktësisht, QPS – Kërçovë për shkak të largësisë së shfrytëzuesve të cilët jetojnë jashtë qytetit (në komunat tjera), të njëjtit nuk i vendos në listën e shfrytëzuesve të kësaj kuzhine. Ato janë të mendimit se komunat tjera duhet me vetë-iniciativë ta shqyrtojnë dhe ta zgjidhin këtë çështje.

Në Komunën e Kërçovës nuk ka shitore sociale për shfrytëzuesit e ndihmave në para, me qëllim që të njëjtit të mund të blejnë produkte ushqimore për çmime më të ulta.

Në QPS – Kërçovë sigurohet diskrecioni i të dhënave të cilat jepen nga klienti dhe ka vend për pritje të përshtatshëm për klientët.

Sipas pikëpamjes së përfaqësueses së QPS – Kërçovë, me qëllim që ky institucion ti përmbushi nevojat reale të qytetarëve në komunat në të cilat punon, duhet të ndërmerren masa për përmirësimin e kushteve materiale dhe teknike, mirëpo edhe për pasurmin e dijeve dhe profesionistëve të resurseve njerëzore.

2.3. Preventiva dhe përkrahja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS – Kërçovë nuk bën punë preventive. Qendra në këtë komunë nuk ka njësi lokale në vendet rurale dhe nuk zbaton aktivitete për njoftimin e qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre nga sfera e mbrojtjes sociale dhe Ligji për familje. QPS – Kërçovë i informon qytetarët përmes mediave elektronike vetëm kur don që ti popullarizojë aktivitetet-projektet e saj, siqë janë: kuzhinat popullore, qendrat ditore ose kur zbaton aktivitete për ndonjë problematikë të caktuar (fëmijë në rrugë, dhunë familjare, familje strehuese).

2.4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS – Kërçovë nuk ka program as mekanizma të përcaktuar për konsultim me grupet e varfëra dhe të prekshme.

2.5. Bashkëpunimi i Qendrës për punë sociale me vetëqeverisjen lokale dhe institucionet/organizatat tjera

QPS – Kërçovë ka bashkëpunim të mirë me vetëqeverisjen lokale. Ky bashkëpunim ndodh në nivelin e informimit dhe konsultimeve. Kështu që, në seancat përmbledhëse të Komunës, Qendra e informon Këshillin për programin e punës të zbatuar gjatë vitit të kaluar. Gjithashtu, Qendra është thirrë nga Komuna për konsultime dhe pjesëmarrje në disa projekte të caktuara. Për një pjesë të shfrytëzuesve, Komuna ofron punësim të përkohshëm me kohëzgjatje prej disa muajve. Angazhimi ka të bëjë me mirëmbajtjen komunale të qytetit. Pas angazhimit në punë, shfrytëzuesve të ndihmës në para të cilët kanë qenë të angazhuar në punë përsëri ju aktivizohet ndihma në para. Qendra nuk ka bashkëpunim me pushtetet lokale në vendet rurale.

Bashkëpunimi mes QPS – Kërçovë dhe ministrisë kompetente vlerësohet si i mirë. Problemi i vetëm në bashkëpunim është mungesa e mjeteve financiare për përmbushjen e nevojave të personave socialisht të rrezikuar, gjegjësisht për realizimin e mandatit të QPS. Sa i takon shkëmbimit të informatave për verifikimin e statusit të punës të klientëve, bashkëpunimi me agjencitë për punësim gjithashtu është i mirë. Sa i takon sferës së punësimit nuk ka angazhim punues të shfrytëzuesve të ndihmës sociale.

Sipas Ligjit për mbrojtje sociale, Qendra mund të bashkëpunojë me sektorin qytetarë. Deri tani është realizuar bashkëpunim në sferën e tregtisë me njerëz dhe dhunës familjare. Gjithashtu, disa shoqata qytetare të caktuara janë drejtuar për të kërkuar listë të shfrytëzuesve për disa kategori të caktuara. Dallohet bashkëpunimi me shoqatat rome, në veçanti për prezencën e martesave të mitura tek kjo popullatë.

QPS – Kërçovë nuk ka bashkëpunim me biznes sektorin. Biznes sektori, gjegjësisht disa firma të caktuara deri tani kanë kërkuar vetëm lista të personave me hendikep të cilët janë shfrytëzues të qendrës, me qëllim që të njejtit ti punësojnë (firmat të cilat punësojnë persona të tillë kanë disa beneficione). QPS nuk ka informatë kthyesë për atë se nëse dhe sa nga këto persona janë punësuar në këtë mënyrë.

3. Të dhënat nga fokus grupet e organizuara

Prezenca e grupeve të prekshme në Komunën e Kërçovës u verifikua me intervistimin e dy fokus grupeve, nga të cilat njëri përbëheshte prej grave të nacionalitetit maqedonas dhe shqiptar. Grupi tjetër përbëheshte prej burrave të nacionalitetit maqedonas dhe shqiptar.

3.1. Persona të moshuar

Përqindja e personave të moshuar, të cilët marrin pension minimal ose janë shfrytëzues të ndihmës në para nga sfera e mbrojtjes sociale, është e madhe. Kushtet shtëpiake për jetesë i përmbushin nevojat e personave të moshuar. Në shtëpitë publike për persona të moshuar nuk janë mundësuar të gjitha kushtet, të cilat do të mundësojnë kushte të sigurt dhe të mira për jetesë. Si problem me të cilin ballafaqohen personat e moshuar janë çmimet e larta për shfrytëzimin e këtij shërbimi. Pensioni nuk i përmbush nevojat kryesore ekzistenciale për personat e moshuar.

Personat e moshuar duhet të paguajnë participim për shërbimet shëndetësore dhe për barnat, gjë e cila e vështirëson qasjen tek ta. Personat e moshuar janë të kënaqur nga shërbimet në institucionet shëndetësore private të cilat bashkëpunojnë me Fondin për sigurim shëndetësor, ndërsa nuk janë të kënaqur nga shërbimet të cilat jepen në institucionet shëndetësore publike. Dokumentacioni i madh i nevojshëm paraqet problem që personat e moshuar ti shfrytëzojnë të drejtat nga sfera e mbrojtjes sociale. Në Komunën e Kërçovës ka një numër të madh të personave të moshuar të cilët janë të palëvizëshëm dhe të cilëve për shkak të mungesës së dokumenteve ju është anuluar e drejta e shfrytëzimit të ndonjë forme të caktuar të mbrojtjes. Personat e moshuar janë të kufizuar në shfrytëzimin e të drejtave nga mbrojtja sociale për shkak të pronës që e posedojnë.

3.2. Gra

Në Komunën e Kërçovës papunësia paraqet një problem serioz me të cilin ballafaqohen gratë. Numri i grave të cilat janë të punësuar dhe fitojnë rroga minimale është i madh. Gratë shpesh janë të diskriminuara në tregun e punës për shkak të moshës së tyre; gratë mbi 35 vjeç më vështirë punësohen. Gjithashtu, si kusht shtesë për punësim përcaktohet edhe planifikimi i familjes, gjegjësisht gruaja nuk duhet të planifikojë zgjerim të familjes nëse do që të punësohet, në të kundërtën marrëdhëniet e punës do të ndërpriten.

Të ardhurat nuk janë të mjaftueshme për ti përmbushur nevojat kryesore ekzistenciale. Gjithashtu u theksua edhe problemi me vjetërsinë në punë e cili nuk mbulohet krejtësisht nga ana e punëdhënësve. Në këtë mënyrë gratë nuk mund ta realizojnë të drejtën e pensionit edhe pse e njejta ju takon. Kushtet për jetesë janë të mira por nuk i plotësojnë nevojat e gruas për një jetë moderne. Gratë janë të njoftuara me të drejtat e tyre nga mbrojtja shëndetësore dhe rregullisht i shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore.

Pasiguria ekonomike është arsyeja se përse gratë-viktima të dhunës familjare nuk e paraqesin dhunën tek institucionet relevante, por gjithashtu një shkak i rëndësishëm janë vlerat patriarkale dhe mbrojtja jo e mjaftueshme nga ana e shtetit. Gratë të cilat janë raste të dhunës familjare në Qendrën për punë sociale u shprehën se kanë pasur eksperiencë pozitive lidhur me zgjidhjen e problemeve.

3.3. Fëmijë

Varfëria në Komunën e Kërçovës reflektohet mbi zhvillimin normal psiko-fizik të fëmijëve. Fëmijët e gjinisë femrore të nacionalitetit turk, rom dhe shqiptar nuk e vazhdojnë procesin arsimor. Në Komunë mungojnë objekte për aktivitete sportivo-rekreative dhe kulturore të dedikuara për fëmijët. Si pasojë e kësaj theksohet mungesa e socializimit të fëmijëve përmes lojrave shoqërore. Shteti nuk siguron punësim dhe banesa për fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror.

Kufizimi i të ardhurave është shkak se përse të gjithë fëmijët nuk mund të shfrytëzojnë të drejtat e tyre nga ligji për mbrojtjen e fëmijëve. Në këtë mënyrë bëhet diskriminim i fëmijëve. Mjetet nga shtesa fëmimore janë minimale dhe në krahasim me shtetet fqinje mjetet janë simbolike dhe të njejtat nuk i përmbushin nevojat kryesore ekzistenciale për fëmijët.

Fëmijët me nevoja të posaçme diskriminohen dhe nuk pranohen nga mjedisi në Komunën e Kërçovës. Për shkak të kësaj arsyeje, prindërit këtyre fëmijëve nuk ju mundësojnë arsim dhe socializim. Në shkolla nuk ka kushte adekuate ambientale dhe teknike, me qëllim që fëmijët me nevoja të posaçme ta ndjekin mësimin.

Në Komunën e Kërçovës nuk ka institucion të posaçëm për strehimin e fëmijëve me nevoja të posaçme. Diskriminuese është edhe shtesa prindërore për fëmijën e tretë: domethënë nëse lindet foshnjë e tretë e gjallë, ndërsa fëmija përpara kësaj ka vdekur, prindërve nuk ju takon që ta shfrytëzojnë këtë shtesë; ose po nëse gjatë shtatëzanisë së tretë lindin binjakë, jepet shtesë vetëm për fëmijën e tretë dhe jo për të katërtën. Ligji i cili i rregullon këto raste nuk është mjaft i qartë.

3.4. Persona me nevoja të posaçme

Në Komunën e Kërçovës personat me nevoja të posaçme paraqesin një kategori të prekshme. Mjedis i diskriminon personat me nevoja të posaçme. Për shkak të kësaj njerëzit nuk i socializojnë personat me nevoja të posaçme të familjeve të tyre.

Kushtet banuese të personave me nevoja të posaçme janë të mira.

Përfaqësuesit e biznes sektorit edhe pse i shfrytëzojnë subvencionet të cilat i ofron shteti për punësimin e këtyre personave, ato e keqpërdorin gjendjen e personave me nevoja të posaçme gjatë punësimit të tyre, me atë që i regjistrujnë me të ardhura minimale për dallim të të punësuarve tjerë të cilët janë dyfish më të paguar. Gjithashtu, personave me nevoja të posaçme nuk ju paguhet në plotësi sigurimi për vjetërsi në punë. Ka raste kur personat me nevoja të posaçme i angazhojnë në punë për një periudhë ta caktuar dhe pastaj jua ndërpresin punën. Inspektimi i punës nuk është mjaft prezent në terren për të konstatuar dhe sanksionuar këto dukuri.

Personat me nevoja të posaçme nuk janë të liruar nga participimi gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore dhe blerjes së barnave, gjë e cila jua vështirëson qasjen tek këto shërbime.

Mbrojtja sociale duhet t'ju mundësojë personave me nevoja të posaçme që ti realizojnë të drejtat e ndihmës së përhershme në para vetëm për shkak sëmundjes së tyre dhe mos kërkohen kritere plotësuese. Mjetet nga ndihma në para të dedikuara për personat me nevoja të posaçme nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale.

3.5. Rom

Romët janë kategori e prekshme në Komunën e Kërçovës. Vitet e fundit, sektori joqeveritar ka kontribuar shumë në përmirësimin e gjendjes së romëve. Mes kësaj kategorie të personave është prezente varfëria dhe analfabetizmi. Romët nuk ju mundësojnë arsim fëmijëve të tyre, prindërit janë ato që vendosin se nëse fëmijët e tyre do të shkollohen dhe deri në cilën shkallë. Profesionin e tyre jua transferojnë fëmijëve dhe në këtë mënyrë mendojnë se ato nuk kanë nevojë për arsim. Ndryshimet e Ligjit për arsim janë pozitive për rritjen e arsimit mes fëmijëve rom.

Në Komunën e Kërçovës ka familje rome të cilat jetojnë në kushte relativisht të mira dhe familje të cilat nuk i kanë kushtet bazike për jetesë.

Romët të cilët kanë arsim të përshtatshëm janë të punësuar dhe gjendja e tyre materiale është e mirë për dallim të romëve, të cilët janë të paarsimuar dhe arsimi është shkaku kryesor se përse ato nuk mund të gjejnë punë. Ka rom të cilët nuk kanë certifikatë nga libri amë i të lindurve, ndërsa mosposedimi i dokumentacionit paraqet pengesë për realizimin e të drejtave nga sfera e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale.

3.6. Pakica

Serbët janë pakicë në Komunën e Kërçovës. Ato ballafaqohen me problemet e njejta si edhe qytetarët tjerë.

C. Komuna e Çashkës

1. Njësia e vetëqeverisjes lokale – intervista u zbatua me Znj. Bojanka Mirova, udhëheqës i Sekcionit për çështje juridike dhe të përgjithshme në Komunën e Çashkës.

1.1. Mekanizma institucionale të mbrojtjes sociale në Komunën e Çashkës

Në pajtim me sistematizimin e miratuar të vendeve të punës, administrata komunale në Komunën e Çashkës ndahet në 5 sekcione. Përpos Sekcionit për punë juridike dhe të përgjithshme, ekziston Sekcioni për arsim, kulturë, shëndetësi, mbrojtje sociale, sport dhe bashkëpunim me shoqatat qytetare. Mu në këtë sekcion, punojnë dy bashkëpunorë me statusin e nëpunësve shtetëror. Kompetencat e tyre janë të ndara sipas fushave të veprimit.

Në kornizat e Këshillit të Komunës së Çashkës nuk ka komision të përhershëm për mbrojtje sociale. Ekziston komision për mundësi të barabarta mes burimeve dhe grave, në sferën e veprimit të cilin përfshihen çështje nga sfera e mbrojtjes sociale, shëndetësia dhe arsimit i grave. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve të Këshillit të Komunës së Çashkës. Megjithatë edhe pse sipas **Statutit të Komunës së Çashkës²⁵, ky komision nuk figuron si komision i përhershëm**, në të njëjtin nen është cekur se Këshilli mund të formojë edhe komisione të tjera të përkohshme dhe të përhershme, përbërja dhe puna e të cilëve do të përcaktohet me aktin për formimin e tyre.

Sa u takon seancave, **komisioni takohet ad hoc**, në varësi nga rasti ose nevoja për zgjidhjen e çështjeve të caktuara nga sfera sociale. Të punësuarit në administratën komunale dhe përfaqësuesit e këshillit diskutojnë për çështjet dhe problemet nga sfera sociale.

1.2. Programe dhe plane vepruese nga sfera e mbrojtjes sociale, përfshirë edhe programet zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve

Në Komunën e Çashkës është miratuar **program për zhvillim të arsimit, sportit, kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale për periudhën 2009-2013**. Programi është përgatitur në muajin nëntor të vitit 2008, **ndërsa është miratuar nga ana e Këshillit të Komunës në muajin dhjetor të vitit 2008²⁶**. Programi është përpiluar me ndihmën e Zyrës për zhvillim të Kombeve të Bashkuara. I njëjti është konceptuar në 5 sfera edhe atë: arsim, sport, kulturë, shëndetësi dhe mbrojtje sociale. Për secilën sferë tematikë është përgatitur strategji e cila përmban qëllime, veprime, tregues dhe verifikues. Për secilën sferë të programit është krijuar SWOT analizë. Për krijimin e programit **është formuar trup koordinues**, i përbërë nga **koordinatori lokal dhe skuadra qytetaro-eksperte**. Gjendjet janë përcaktuar në bazë të **analizave, punëtorive dhe takimeve**. Më në fund, **plani është rishqyrtuar nga ana e vetëqeverisjes lokale** dhe është **miratuar** nga ana e Këshillit të Komunës së Çashkës.

Edhe pse në programin janë theksuar supozimet për realizimin e të njëjtit si dhe vëzhgimin e tij, **nuk ka plan veprues të përshtatshëm as po kornizë kohore**

²⁵ Neni 53 nga Statuti i Komunës së Çashkës, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 8/2007.

²⁶ Vendim i Këshillit të Komunës së Çashkës, nr. 07-2030/9 i datës 26.12.2008.

për ndjekjen e zbatimit të planit. Aktivitetet e zbatuara ndiqen nga ana e personave përgjegjës në administratën komunale, gjegjësisht bashkëpunëtorët për mbrojtje sociale, shëndetësore, zhvillim ekonomik lokal, në pajtim me të cilat përgatisin edhe raporte. Gjithashtu, **çdo sferë tematike përmban 3 qëllime nën-programore, gjë e cila në krahasim me planifikimin është relativisht pak duke e pasur parasyshë periudhën 4 vjeçare për zbatimin e programit.** Megjithatë, gjatë periudhës 2009 – 2010, janë realizuar aktivitete nga të gjitha fushat tematike. Nga sfera e mbrojtjes sociale është zbatuar aktiviteti i ardhshëm: është hapur qendër ditore për personat e moshuar në vendbanimin Çashka dhe Bogomillë (përmes Ministrisë për punë dhe politikë sociale, Qendrës për punë sociale – Veles dhe Komunës së Çashkës).

Në Komunë **ka bashkëpunim ndër-sektoral për krijimin e planeve dhe propozimeve** me komisionet dhe sekcionet e tjera për çështjet e kësaj sfere (për shembull komisioni për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave dhe komisioni për zhvillim ekonomik lokal). Sa u takon krijimit të programeve, shpesh të punësuarit në administratën komunale përgatisin plan-projekte për çështje të caktuara dhe japin iniciativa të cilat më vonë vetë këshilltarët i shqyrtojnë brenda komisionit të përshtatshëm.

Komuna e Çashkës **asnjëherë deri tani nuk ka miratuar as po propozuar programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve** të cilët jetojnë në territorin e saj.

1.3. Mekanizma për konsultimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal dhe kombëtar dhe bashkëpunimi mes institucioneve relevante nga sfera e mbrojtjes sociale dhe shoqatat qytetare

Në Komunën e Çashkës të gjitha aktet të cilat miratohen publikohen në Gazetën zyrtare dhe në ueb faqen, ndërsa raportet e secilës seance pas mbarimit vendosen në dërrasën e shpalljeve.

Gjithashtu, kur **bëhet miratimi i buxhetit, planit gjeneral ose miratimi i statuteve të bashkësive lokale** përpara qytetarëve bëhen prezantime të tyre. Komuna bën konsultime me qytetarët pesë herë në vit në zyrat e Komunës, si dhe me kryetarët e bashkësive lokale, për ti informuar për disa çështje të caktuara. Shembull për këtë është iniciativa e pushtetit lokal për ti informuar qytetarët për hyrjen në fuqi të Ligjit për legalizimin e ndërtesave të palegalizuara nga janari i vitit 2011. Komuna ka organizuar tubim me qytetarët me qëllim që ti informojë për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme. E tërë iniciativa është zbatuar përmes bashkësitë lokale dhe kryetarët e tyre.

Edhe një iniciativë e tillë transparente është realizuar lidhur me ndërtimin e rrugës për në fshatin Mokren. Donuesi i cili ka dhënë 400.000 euro ka kërkuar që Komuna të takohet me të gjitha 42 vendbanimet në Komunën e Çashkës, gjegjësisht me bashkësitë e tyre lokale dhe si vërtetim kanë kërkuar raporte nga takimet e mbajtur dhe lista të pjesëmarrësve.

Komuna gjithashtu organizon takime individuale me banorët, ju sygjeron atyre iniciativa dhe probleme të cilat mendon se janë më të pranishme në Komunë, për të cilat pastaj qytetarët duhet të deklarohen.

Bashkëpunimi më së shpeti ndodh me kryetarët e bashkësive lokale ose me shoqatat qytetare. Në territorin e Çashkës edhe pse ka 42 vendbanime, bashkësi

lokale ekzistojnë vetëm në 35 prej tyre. Nga **sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale deri tani janë inicuar disa iniciativa**. Shembull eklatantik është iniciativa e ndërmarrë nga komuna përpara 5 muajve **për hapjen e strehimores (qendrës ditore) për fëmijët me nevoja të posaçme në Komunën e Çashkës**.

Në territorin e kësaj komune ka 20 fëmijë me nevoja të posaçme. Për realizimin e këtij qëllimi komuna ka hyrë në kontakt me drejtoreshën e shkollës fillore, me drejtoreshën e shkollës për fëmijë me nevoja të posaçme në Veles, me MPPS për të biseduar me të gjitha palët për mënyrën e investimit në këtë strehimore. Lokalin për këtë synim do ta sigurojë Komuna, ndërsa MPPS do ti sigurojë kuadrot e përshtatshme profesionale dhe paisjet për lokalin.

Ministria për punë dhe politikë sociale e ka marrë për obligim që në buxhetin e vitit 2011, të ndajë mjete financiare për këtë qendër ditore për fëmijët me nevoja të posaçme.

Sidoqoftë, përpos këtyre formave të veprimit dhe të dhënies së informatave, të cilat janë të rregulluara me ligj **nuk ka mekanizëm të përshtatshëm për konsultimin ose pjesëmarrjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme në këtë Komunë. Iniciativë qytetarë, e nënkuptuar sipas rregullave normative²⁷ deri tani është inicuar** vetëm për hapjen e qendrës ditore për personat e moshuar në vendbanimin Bogomillë. Komunikimi në këtë aspekt më së tepërmi bëhetë përmes dorëzimeve të kërkesave për ndihmë nga vetë qytetarët, të cilat në ditë sillen rreth 2-3 kërkesa për barna, dru dhe të ngjajshme.

Me qendrat për punë sociale **ka bashkëpunim të madh**. Megjithatë, **nuk ka mekanizma për konsultimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme të cilat janë të përcaktuara në nivel lokal**.

1.4. Mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Në Komunën e Çashkës **nuk ka mekanizma të përcaktuara për vlerësimin e nevojave të grupeve të varfëra dhe të prekshme**. Edhe pse ekzistojnë informata për çështjet e mbrojtjes sociale, përmes kërkesës së të dhënave në nivel vjetor që bëhet në Qendrën për punë sociale në Veles, **nuk ka bazë të dhënash për çështjet lidhur me mbrojtjen dhe përfshirjen sociale**. Të dhënat lidhur me listën e personave të cilët marrin ndihmë sociale merren vetëm nga Qendra për punë sociale. Komunikimi në këtë drejtim bëhet vetëm nëse ka kërkesë nga qytetarët për sigurimin e ndihmës ose konsultimit. Qytetarët të cilët kanë ndonjë problem të caktuar drejtohen me kërkesë tek Këshilli dhe tek kryetari.

1.5. Sigurimi i shërbimeve sociale nga ana e njësisë së vetëqeverisjes lokale

Komuna e Çashkës ndan mjete për mbrojtje sociale nga alinea buxhetore për rezerva vijuese. Sipas raportit vjetor të Komunës së Çashkës, për vitin 2009 nga gjithsej të planifikuarat **mjete për rezerva vijuese, nën të cilën bien edhe shërbimet sociale, sipas nën-programit AO – Këshilli i Komunës, alinea 413 – Rezerva vijuese** (shpenzime të ndryshme) në shumë prej 180.000

²⁷ Qytetarët drejtëpërdrejt marrin pjesë në sjelljen e vendimeve për çështjet e domethënies lokale përmes iniciativës qytetare, tubimeve të qytetarëve dhe referendumit, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me ligj, neni 25 nga Ligji për vetëqeverisje lokale. Gazeta zyrtare e R.M. nr. 5/2002.

denarë, **për vitin 2009 janë shpenzuar gjithsej 180.000 denarë²⁸**. Gjegjësisht, këto mjete janë realizuar nga periudha 08.04.2009 deri më 11.12.2009 dhe atë kryesisht për mjekimin e fëmijë të sëmurë, për ndihmë të vështirë financiare dhe sociale, për ndihmë të njëhershme financiare dhe për manifestimin tradicional "Ditët e Bistrës".

Pastaj, nga shuma totale e planifikuar për rezerva vijuese **sipas nën-programit DO – Kryetar, alinea 413 – rezerva vijuese** (shpenzime të ndryshme) në shumë prej 150.000 denarësh, **për vitin 2009 gjithsej janë shpenzuar 134.464 denarë**. Këto mjete kryesisht janë dedikuar për vdekjen e prindit ose ndonjë anëtar të afërt të familjes dhe dy si paisje për dalje në pension.

Buxheti total i realizuar nën alinenë rezerva vijuese për vitin 2009 në Komunën e Çashkës është **314.464 denarë**.

Gjithashtu, Komuna përpara 10 viteve ka dhënë objekt në shfrytëzim i cili për momentin përdoret si **Klub për personat e moshuar**. Komuna ka hapur edhe një klub të tillë në vendbanimin e **Bogomillës**.

Në bashkëpunim me pushtetin lokal, gjegjësisht Ministrinë për punë dhe politikë sociale, sigurohet shërbimi **"kuzhina popullore"**, për qëllimin e të cilës Ministria për punë dhe politikë sociale në muaj ndan 280.000 denarë. **90 persona të cilët marrin ndihmë sociale marrin ushqim**, i cili përgatitet në shkollë.

Në spitalin për sëmundjet e mushkërive të bardha "Jasenovo" duhet të hapet sekcion për geriatri. Ky aktivitet përsëri zhvillohet në bashkëpunim me Qendrën për punë sociale – Veles. Gjithashtu, në bashkëpunim me ta Komuna organizon ekskurzione për fëmijë dhe pensionerë të moshuar.

1.6. Përmirësim i gjendjes së personave socialisht të rrezikuar

Ligji për mbrojtje sociale²⁹ parasheh që në realizimin e të drejtës së ndihmës sociale në para secila njësi e vetëqeverisjes lokale të ketë mundësi që të angazhojë shfrytëzues të aftë për punë për kryerjen e punëve sezonale ose të përkohshme të interesit komunal. Komuna e Çashkës deri tani përmes masave aktive për punësim të qeverisë së R.M., në vitin 2009 ka angazhuar 38 shfrytëzues të ndihmës sociale në para për zbatimin e kryesisht punëve të interesit komunal. Këto angazhmane kanë zgjatur 6 muaj. Kjo vlen vetëm për vitin 2009.

Megjithatë, **Komuna nuk posedon plan strategjik për përmirësimin e gjendjes së personave socialisht të rrezikuar**. Aktivitetet janë projekte afatshkrutëra nga të cilat nuk mund të shihen rezultate konkrete në afat të mesëm dhe të gjatë.

1.7. Investime kapitale dhe infrastrukturë në sferën e mbrojtjes sociale

Komuna e Çashkës hyri në fazën e dytë të decentralizimit, gjegjësisht në decentralizimin fiskal në vitin 2009. Si e tillë, Komuna përveç posedimit të objekteve të cilat i ka trashëguar me procesin e decentralizimit ose i ka ndërtuar, ka detyrë që të njejtat edhe ti financojë, të investojë në ta dhe ti mirëmbajë.³⁰ Në këtë aspekt, Komuna e Çashkës në sferën e mbrojtjes sociale nga aspekti

²⁸ Raport vjetor i Komunës së Çashkës për vitin 2009, faq. 14.

²⁹ Neni 55 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta zyrtare e R.M. nr. 79/2009.

³⁰ Neni 22 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta zyrtare e R.M. nr. 5/2002.

infrastruktural, **ka hapur qendër ditore për personat e moshuar në vendbanimin Çashkës dhe Bogomillës.**

Komuna **përpos për qendrën ditore për personat e moshuar, ka bërë negociata edhe për hapjen e qendrës ditore për personat me nevoja të posaçme.** Komuna përpara disa muajve ka hapur **qendër multi-etnike për të rinj.** Kjo qendër është ekuipuar me kompjuter dhe është siguruar edhe internet.

2. Qendra për punë sociale - Veles

Qendra për punë sociale – Veles (në tekstin e mëtutjeshëm QPS) shërben tre komuna, gjegjësisht 60.000 deri më 70.000 qytetarë. Në dy komuna rurale, QPS Veles ka njësi të shpërndara.

– Intervista u realizua me Znj. Nada Trajkova, drejtoreshë e Qendrës për punë sociale në Veles.

2.1. Identifikimi i grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS në Komunën e Velesit nuk ka përcaktuar procedura të posaçme me të cilat do ti identifikojë grupet e varfëra dhe të prekshme. Situata e kësaj çështjeje është identike si në komunat tjera. Gjendjet e prezantuara më poshtë janë për komunën e Çashkës, qytetarët e të cilës shërbehen nga ana e QPS – Veles.

Grupet e prekshme më të përfaqësuara në territorin e Komunës së Çashkës, sipas të dhënave të QPS – Veles janë personat e moshuar dhe personat me nevoja të posaçme. Më pak të përfaqësuara janë gratë – viktima të dhunës familjare dhe fëmijët si një kategori e prekshme. Personat me nevoja të posaçme janë njëra nga kategoritë më të përfaqësuara në këtë komunë. Mu për shkak të kësaj ka edhe iniciativë për hapjen e qendrës ditore. Në moment një pjesë e këtyre personave ndjekin shkollë speciale. Personat e moshuar si një kategori e prekshme kryesisht gjenden në Çashkë dhe Bogomillë, për shkak të cilës janë hapur dy qendra ditore për këto persona në këto komunë.

2.2. Shërbime dhe qasja në shërbimet e Qendrës për punë sociale

QPS – Veles i ofron të gjitha shërbimet e parapara me Ligjin për mbrojtje sociale si dhe me statutin e këtij institucioni.

Numri i shfrytëzuesve të ndihmës në para në Komunën e Velesit është 1200 shfrytëzues, gjegjësisht 150 shfrytëzues në një punonjës social (8). Pengesat me të cilat ballafaqohen klientët janë pamundësimi i diskrecionit gjatë intervistave për të gjitha kategoritë e shfrytëzuesve dhe dokumentacioni i madh për të gjitha format e mbrojtjes sociale. Banorët e kësaj komune gjithashtu ballafaqohen me problemin e participimit me një shumë të caktuar, për marrjen e dokumentacionit të nevojshëm. Rrjetëzimi i institucioneve i cili do të mundësojë shkëmbimin e informatave të nevojshme ende nuk është në funksion. Mjetet nga të gjitha format e mbrojtjes sociale nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale të personave me nevoja të posaçme të cilët i shfrytëzojnë këto lloje të mbrojtjes në këtë komunë. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare nga ana e MPPS, ndihma e njëhershme në para për moment nuk ofrohet nga ana e QPS – Veles. Në të kaluarën kjo ndihmë në para është dhënë në mënyrë jo të rregullt, gjegjësisht është miratuar një herë në tre muaj.

Në Komunën e Velesit ka tre kuzhina popullore. Një është vendosur në Komunën e Velesit dhe ka kapacitet prej 100 ushqimeve; e dyta është vendosur në Çashkë dhe ka kapacitet prej 60 ushqimeve të ngrohta dhe e treta është vendosur në Bogomillë, me kapacitet prej 30 ushqimeve të ngrohta. Nga kjo mund të përfundojmë se në Komunën e Çashkës ka dy kuzhina popullore. Shfrytëzues më të shpeshtë të kuzhinave popullore janë shfrytëzuesit e ndihmës së përhershme në para, kujdesit nga personi i huaj dhe një pjesë e shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para (më të rrezikuarit). Sipas deklaratës së përfaqësuese të QPS, ky numër në fillim të projektit ka qenë më i vogël ndërsa tani është rritur. Megjithatë, edhe përpos kësaj rritjeje vetëm një pjesë e shfrytëzuesve mund ta shfrytëzojnë këtë shërbim. Shkaku kryesor për kufizimin e tillë janë mjetet financiare të pamjaftueshme të cilat i siguron Ministria për punë dhe politikë sociale. Për shkak të këtyre kufizimeve QPS – Veles përpiket që t’jua mundësojë këtë shërbim më tepër shfrytëzuesve. *"Përpiqemi që mos të ketë revolt mes shfrytëzuesve duke i ndryshuar ato çdo vit. I jepet mundësi edhe tjetrit"*. – deklaratë e përfaqësues së QPS.

Për momentin, nevojat e personave me nevoja të posaçme përmbushen nga ana e Komunës së Velesit, e cila ka një qendër ditore për personat me nevoja të posaçme dhe një qendër për personat e moshuar. Qendra ditore është tepër e rëndësishme për socializimin e personave me nevoja të posaçme. Në qendrën ditore pranohen persona me retardim mesatarë dhe të rëndë. Kapaciteti i qendrës ditore për personat e moshuar është 24 persona dhe për momentin këtë shërbim e shfrytëzojnë 20 persona. Shërbimi përfshin edhe transport dhe ushqim të siguruar për shfrytëzuesit.

Për nevojat e personave me nevoja të posaçme në Komunën e Çashkës është identifikuar nevoja për hapjen e një qendre ditore dhe iniciativa për hapjen e saj është ndërmarrë.

Në Komunën e Çashkës ka dy qendra ditore, në Çashkë me kapacitet prej 150 personave dhe në Bogomillë me kapacitet prej 105 personave. Shërbimi i cili për moment ju ofrohet këtyre personave përbëhet nga klubi ditor, përmes të cilit ofrohet socializim, shoqërim dhe aheng për personat e moshuar. Ato të cilët janë më të rrezikuar kanë mundësi që ti lajnë teshat. Për më të rrezikuarit, gjithashtu sigurohet edhe ushqim i cili sillet nga kuzhina ditore e cila gjithashtu është vendosur në Komunën e Çashkës.

QPS – Veles ka dy njësi të shpërndara (Komuna e Çashkës dhe Komuna e Gradskos), të qëlluara për dhënien e ndihmës në para. Në Komunën e Çashkës, njësia e shpërndarë është e vendosur në qendrën ditore – klubi për personat e moshuar. Më saktësisht, njësia e shpërndarë është vetëm emrim për një punonjës social, i cili një herë në muaj (data caktohet nga QPS – Veles) i pret klientë të cilët duhet që ta verifikojnë statusin e të qenit të papunësuar.

Nga aspekti i kushteve për punë me klientë në QPS – Veles, vendet për pritje nuk janë të adaptuara për ulje.

Sipas QPS – Veles për përmbushjen adekuate të nevojave të qytetarëve duhet të lehtësohet puna administrative, gjegjësisht janë të mendimit se shërbimet lidhur me ndihmat në para duhet ti kryej Agjencia për punësim, siqë ka funksionuar më parë. Në këtë mënyrë klientët nuk do të duhet që dy herë në muaj ta vërtetojnë statusin e tyre të të qenit të papunësuar (tani ato duhet të vërtetojnë në Qendrën për punë sociale dhe në Agjencinë për punësim).

Gjithashtu, janë të mendimit se nëse kanë në disponim vetura terrenike, mjete për benzin, paisje teknike, kuadro profesionale; ato do të kenë mundësi që adekuatshëm ti përmbushin nevojat e qytetarëve. Sa u takon llojeve të specializuara të shërbimeve të cilat mungojnë në Komunën e tyre, janë të mendimit se ka nevojë që të hapet strehimore për viktimat e dhunës familjare dhe strehimore për personat pa shtëpi.

2.3. Preventivë dhe përkrahje e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS – Veles nuk ka kushte për realizimin e punës preventive për shkak të mungesës së numrit të mjaftueshëm të kuadrove profesionale. Gjatë kontrollave të drejtëpërdrejta në vendet rurale qytetarët ju drejtohen për këshilla punonjësve social dhe në këtë mënyrë qendra pjesërisht e kryen punën preventive.

Për shkak të pamundësive, QPS – Veles nuk i informon qytetarët për të drejtat e tyre nga sfera e mbrojtjes sociale dhe familjare. Zakonisht gjatë ndryshimeve ligjore ato i informojnë qytetarët për të njejtat përmes mediave. Gjatë vitit vijues kanë zbatuar vetëm një punëtori me Shoqatën e prindërve të fëmijëve me paralizë celebrale, lidhur me të drejtat e personave me nevoja të posaçme.

Përpos të pamundësisë për informim adekuat dhe njohje të qytetarëve për të drejtat e tyre, evidente është mungesa e qasjes adekuate për informimin dhe njohjen e kategorive të varfëra dhe të prekshme. Kjo në veçanti për shkak se përfaqësuesja e QPS – Veles e ceku mundësinë e shfrytëzimit të ueb faqes së MPPS në të cilën janë shpallur të gjitha ligjet, për tu informuar për të gjitha të drejtat e kësaj problematike.

2.4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS – Veles nuk ka program dhe mekanizma të përcaktuara për konsultime me qytetarët e Komunës së Velesit. *"Nga shfrytëzuesit tanë marrim informata për nevojat e tyre, megjithatë duhet të merren parasysh edhe mundësitë tona."* – deklaratë e përfaqësues së QPS.

2.5. Bashkëpunimi i Qendrës për punë sociale me vetëqeverisjen lokale

Qendra për punë sociale në Veles ka bashkëpunim të mirë me njësinë e vetëqeverisjes lokale të kësaj komune.

Familjeve të cilat janë në rrezik social dhe janë të prekura nga fatkeqësitë elementare natyrore, Komuna ju siguron ndihmë në para të njehershme. Secilin vit, Qendra merr donacion nga Komuna për mjete shkollore dhe i njejtë ju dedikohet fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror. Këtë vit, Komuna për herë të parë ka siguruar mjete për viktimat e dhunës familjare. Vitin e kaluar, 2009, përmes një projekti të Agjencisë për punësim dhe vetëqeverisjes lokale, tek QPS – Veles është dorëzuar kërkesë për listën e shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para. Në këtë mënyrë janë punësuar shfrytëzues të ndihmës sociale në para për rregullimin e qytetit në afat prej gjashtë muajve. Pas angazhimit, siqë ndodh edhe në komunat tjera, aktivizohet ndihma sociale nga QPS. Përmes projektit për punësimin e grave-viktima të dhunës familjare, janë punësuar pesë nëna të vetme, ndërsa mes fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror nuk ka pasur punësim.

QPS – Veles bashkëpunon me Ministrinë për punë dhe politikë sociale. Mjetet buxhetare të parapara për punën e Qendrës për punë sociale nuk janë të mjaftueshme. QPS – Veles bashkëpunon edhe me Agjencinë për punësim. Çdo muaj QPS tek ky agjencion dorëzon listë të shfrytëzuesve të shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe merr informata kthyesë për ndryshimin e statusit punësorë të shfrytëzuesve.

QPS – Veles deritani ka bashkëpunuar me shoqatat qytetare siqë janë OJQ e prindërve për kujdes të gjeneratave të shëndosha dhe shoqatat e të sëmurëve nga paraliza cerebrale.

QPS – Veles nuk ka bashkëpunim të drejtëpërdrejtë me biznes sektorin. I vetmi bashkëpunim ka ndodhur kur një fabrikë private e cila ka punëtorë të mbrojtur për personat me nevoja të posaçme, është drejtuar tek kjo QPS përmes Agjencisë për punësim për të kërkuar listë për këtë kategori të personave.

3. Të dhëna nga fokus grupet e zbatuara

Gjendja e grupeve të prekshme në Komunën e Çashkës u përcaktua përmes diskutimit me dy fokus grupe. Në njërin ishën prezente gratë e bashkësisë maqedonase, shqiptare dhe turke. Grupi tjetër përbëheshte prej burrave të nacionalitetit të njëjti si grupi i grave.

3.1. Personat e moshuar

Personat e moshuar janë një kategori e prekshme në Komunën e Çashkës. Ato gjenden në gjendje të vështirë materiale për shkak se nuk mund ti përmbushin nevojat e tyre kryesore ekzistenciale me të ardhurat e pensionit. Mu për shkak të kësaj nga ana e Komunës janë hapur dy qendra ditore, prej të cilave njëra është e vendosur në Bogomillë, ndërsa tjetra në Çashkë. Gjithashtu, funksionojnë edhe dy kuzhina popullore të cilat sigurojnë ushqime të ngrohta për këtë kategori të personave. Personat e moshuar kanë kushte relativisht të mira jetese.

Në Komunën e Çashkës është i vogël numri i institucioneve shëndetësore ku do të mund qytetarët ti shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore. Kjo gjendje në plotësim e vështirëson gjendjen shëndetësore të personave të moshuar dhe të nejtut u janë të eksponuar shpenzimeve shtesë për shfrytëzimin e shërbimeve të mbrojtjes shëndetësore.

Për shkak të largësisë së qytetit të Velesit, ndihma e shpejtë intervenon me vonesë.

Personat e moshuar për realizimin e të drejtave nga mbrojtja shëndetësore duhet ti përmbushin kriteret ligjore, gjë e cila mund të paraqesë pengesë për realizimin e këtyre të drejtave. Nëse një nga kriteret nuk është i përmbushur, personat e moshuar nuk mund ti realizojnë të drejtat nga mbrojtja sociale.

3.2. Gra

Në Komunën e Çashkës u cek problemi me arsimin e ulët të grave shqiptare. Ato nuk e kryejnë as edhe arsimin fillor dhe një përqindje tepër e vogël e vazhdon arsimin e mesëm. Varfëria është një nga arsyet se përse fëmijët të gjinisë femrore nuk arsimohen. Vërehet se traditat janë shumë të përhapura tek popullata shqiptare, gjë e cila në plotësim e vështirëson gjendjen e gruas shqiptare.

Ndryshimet në Ligjin për arsim të obligueshëm nuk sollën ndonjë avancim më të madh për shkak se dënimet paguhet, ndërsa fëmijët e gjinisë femrore të nacionalitetit shqiptar mbesin ende të paarsimuar.

Prindërit e nacionalitetit shqiptar inicojnë martesë të aranzhuara për vajzat dhe ato nuk e kanë të drejtën e zgjidhjes. Kushtet për jetesë për gratë në Komunën e Çashkës janë relativisht të mira.

Gratë në moshë mbi 35 vjeç diskriminohen në tregun e punës. Papunësia është në një shkallë të lartë. Në fabrikat tekstile ka keqpërdorim të fuqisë punuese, gratë paguhën minimalisht dhe nuk kanë orar pune të caktuar.

Edhe përpos faktit se gratë janë të njoftuara me të drejtat e tyre nga mbrojtja shëndetësore, të njejtit nuk i shfrytëzojnë mjaft shërbimet shëndetësore.

Për shkak të papunësisë dhe çështjes banuese të pazgjidhur, gratë janë të varura nga bashkëshortët e tyre dhe prandaj nuk e paraqesin dhunën familjare. Nëse shteti e siguron këtë siguri, drastikisht do të ulet përqindja e dhunës familjare.

3.3. Fëmijë

Fëmijëve të gjinisë femrore të nacionalitetit shqiptar nuk ju mundësohet arsim. Si shkaqe cekën vafëria dhe vlerat tradicionale patriarkale.

Shteti nuk siguron punësim dhe nuk e zgjidh çështjen banuese për të gjithë fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror. Të drejtat e fëmijëve të cilat ju takojnë në pajtim me ligjin për mbrojtje fëmimore, nuk mund të realizohen për shkak të kushteve të përcaktuara. Me këto kufizohet numri i fëmijëve të cilët mund ti shfrytëzojnë të drejtat nga Ligji për mbrojtje fëmimore.

Mjetet e ndihmës në para nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale të fëmijëve.

Në Komunën e Çashkës nuk ka shkollë të specializuara për fëmijët me nevoja të posaçme. Për shkak të kësaj, këto fëmijë duhet të shkojnë në shkollat e specializuara në qytetin e Velesit, ku sigurohen kushte të përshtatshme që fëmijët me nevoja të posaçme të mund ta ndjekin mësimin.

3.4. Personat me nevoja të posaçme

Në Komunën e Çashkës personat me nevoja të posaçme gjenden si kategori e prekshme. Janë evidentuar 29 persona me nevoja të posaçme. Për këtë qëllim, Komuna në bashkëpunim me Ministrinë për punë dhe politikë sociale dhe Qendrën për punë sociale në Veles, ka inicuar hapjen e qendrës ditore për këtë kategori të personave.

Personat me nevoja të posaçme diskriminohen nga mjedisi në të cilin jetojnë.

Personat me nevoja të posaçme nuk kanë të siguruara kushte të mira jetese.

Spektori i biznesit privat, personave me nevoja të posaçme ju jep paga më të ulta në krahasim me të punësuarit tjerë dhe nuk ju mundëson kushte të përshtatshme për punë sipas nevojave të tyre.

Për realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale, personat me nevoja të posaçme janë të kufizuar me kushtin i cili e parashihet kufizimin e shumës së të ardhurave

dhe kushtet tjera të cilat sipas ligjit duhet ti plotësojnë, ndërsa ato paraqesin pengesë për realizimin e të drejtave të tyre.

Mjetet nga ndihma sociale në para nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale të kësaj kategorie të personave.

3.5. Rom

Në Komunën e Çashkës nuk ka popullatë të bashkësisë rome.

3.6. Pakica

Si pakica në Komunën e Çashkës janë prezent boshnjakët, tuqit dhe serbët. Ato ballafaqohen me të njejtat probleme si edhe qytetarët tjerë të Komunës së Çashkës. Si probleme më të shpeshta paraqiten papunësia, probleme me transportin dhe mosinformimin lidhur me të gjitha sferat e ndodhive sociale.

Ç. Komuna e Radovishit

1. Njësia për vetëqeverisje lokale – intervista u realizua me Znj. Olivera Dudullova, udhëheqës i Sektorit për çështje normativo-juridike, të përgjithshme dhe publike në Komunën e Radovishit.

1.1. Mekanizma institucionale për mbrojtje sociale në Komunën e Radovishit

Në Komunën e Radovishit ka Sektor për punë normativo-juridike, të përgjithshme dhe publike. Në kuadër të këtij sektori, të punësuarit të cilët punojnë në rolin e nëpunësve shtetëror merren edhe me çështjet e mbrojtjes shëndetësore, sociale dhe feminare, arsim, sport dhe kulturë në Komunë. Megjithatë, **nuk ka person i cili posaçërisht është i punësuar për mbrojtje sociale.** Aktivitetet të cilat ndërlihen me këtë tematikë përpunohen nga ana e Sekcionit për zhvillim ekonomik lokal në korelacion me udhëheqësin e Sektorit për çështje normativo-juridike, të përgjithshme dhe publike në Komunën e Radovishit.

Në kornizat e Këshillit të Komunës së Radovishit, ka komision të përhershëm për shëndetësi dhe mbrojtje sociale. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve të Këshillit të Komunës së Radovishit. Sa u takon seancave, komisioni takohet në varësi të lëndës ose nevojës për zgjidhje të disa çështjeve të caktuara. Nëse ka pikë në rendin e ditës në senacën e Këshillit, Komisioni detyrimisht takohet. Ajo e cila është interesante për këtë komision, është ajo se edhe pse anëtarët e këtij komisioni janë këshilltarë në Këshillin komunal, ato janë persona kompetent edhe atë mjek, punonjës social, profesor për gjuhë maqedonase dhe person i cili e përfaqëson një bashkësi etnike e cila jeton në territorin e kësaj Komune. Gjithashtu, nëse ka kërkesë të qytetarëve për ndonjë fushë të caktuar, për shembull mbrojtja feminare, thirren edhe persona të jashtëm si për shembull drejtori i çerdhes dhe persona të ngjajshëm.

1.2. Programe dhe plane vepruese nga sfera e mbrojtjes sociale, duke i përfshirë edhe programet zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve

Në Komunën e Radovishit **nuk ka program pune për mbrojtje sociale në komisionin e përhershëm për shëndetësi dhe mbrojtje sociale.** Program i tillë **deri tani nuk është miratuar.** Në Komunën e Radovishit, **nuk ka as plan veprues adekuat për mbrojtje sociale. Vetëm në vitin 2007** është miratuar plan veprues njëvjeçarë për mbrojtje sociale. Prej atëherë nuk është miratuar plan veprues shumëvjeçarë.

Në Komunë **ka bashkëpunim ndër-sektoral për krijimin e planeve dhe propozimeve** me komisionet dhe sektoret tjera për çështje të kësaj sfere (për shembull me Komisionin për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave, Sekcionin për zhvillim ekonomik lokal në Komunën e Radovishit). Gjithashtu edhe Komisioni për shëndetësi dhe mbrojtje sociale bashkëpunon me komisionin për mundësi të barabarta. Dy anëtarë të komisionit për shëndetësi dhe mbrojtje shëndetësore janë anëtarë të komisionit për mundësi të barabarta.

Sa i takon krijimit të strategjive dhe planeve lokale ka bashkëpunim ndër-sektoral jo vetëm me komisionet e Këshillit por edhe me shoqatat qytetare, shkollat, institucionet shëndetësore etj.

Komuna e Radovishit **asnjëherë nuk ka miratuar as po ka propozuar programe për nevojat specifike të qytetarëve** të cilët jetojnë në territorin e saj.

Megjithatë, në Komunë **ka Strategji për zhvillim lokal të përbashkët për mikro-regjionin Radovish dhe Konçe** për periudhën 2007-2011 dhe **Strategji për zhvillim të arsimit** për vitet 2009-2020. Për Strategjinë për zhvillim të arsimit ende nuk është miratuar plan veprues. Gjegjësisht, edhe pse në të ka plan vëzhgues, dispozitat nga i njejtë nuk zbatohen sipas planifikimit.

1.3. Mekanizma për konsultim dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal dhe kombëtar dhe bashkëpunimi mes institucioneve relevante nga sfera e mbrojtjes sociale dhe shoqatat qytetare

Në Komunën e Radovishit informatat plasohen në ueb faqen e Komunës, ndërsa të gjitha vendimet e Këshillit komunal shpallen në Gazetën zyrtare. Gazeta zyrtare deponohet edhe në bibliotekën kombëtare, mirëpo sipas përfqësuese së intervistuar të Komunës, qytetarët nuk tregojnë interes të posaçëm për marrjen e informatave të cilat botohet në të.

Bashkëpunimi më së shpeshti bëhet me kryetarët e bashkësive lokale, gjegjësisht bashkësive urbane dhe shoqatave qytetare. Megjithatë, përpos këtyre formave për veprim dhe dhënie të informatave të cilat janë të rregulluar me ligj, **nuk ka mekanizëm të përshtatshëm për konsultime dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në këtë komunë.**

Nga **sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale deri tani është bashkëpunuar me** shoqatën e personave me kufizime intelektuale "Poraka", të cilëve Komuna në vitin 2006 u ka liruar hapsirë në objektin e çerdhes për shkak se atëherë ka pasur vend. Për shkak të rritjes së numrit të fëmijëve Komuna u ka dhënë tjetër hapsirë për shfrytëzim. Megjithatë, **iniciativë qytetare të nënkuptuar sipas rregullave normative deri tani nuk është ndërmarrë** për këtë lloj të çështjeve. Bashkëpunimi ndodh vetëm kur vetë shoqatat qytetare drejtohen në Komunë. Komunikimi me qytetarët ndodh vetëm përmes lidhjes së drejtëpërdrejtë me ato të cilët kanë nevojë për ndihmë: gjatë përgatitjes së dokumenteve, persona të cilët kanë nevojë për ndihmë të njëhershme në para etj.

Komuna e Radovishit **bashkëpunon me Qendrën për punë sociale**, kur ka nevojë, posaçërisht gjatë fitimit të të dhënave. Komuna merr të dhëna edhe nga institucioni shëndetësor për shkak se gjatë krijimit të disa planeve lokale të caktuara të cilat i përpilon Komuna, të dhënat mund të sigurohen vetëm prej tyre. Megjithatë, **nuk ka mekanizma të caktuara për konsultimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal.** Bashkëpunimi formalizohet vetëm nëse Komuna përgatit plan, në të cilin përfshin institucione dhe veprues relevant nga niveli lokal.

1.4. Mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Në Komunën e Radovishit **nuk bëhet vlerësim i nevojave të grupeve të varfëra dhe të prekshme.** Komuna e Radovishit, sipas përfaqësueses të intervistuar është *"mbledhës i informatave në bazë të kërkesave të qytetarëve"*, për të cilat më vonë Komuna ndan mjete, gjegjësisht prioritete për planifikimin e veprimeve. Kur realizohet buxheti komunal, nëse në vitin paraprak janë buxhetuar mjete financiare në një shumë të caktuar, ndërsa e njejtë është

tejkualuar, atëherë kjo shumë vitin e ardhshëm rritet. Kjo shumë më së shpeshti jepet për ndihmë të njëhershme në para, probleme shëndetësore dhe të ngjajshme.

Nuk ka bazë të dhënash për çështjet lidhur me mbrojtjen dhe përfshirjen sociale. Nuk ka as klasifikim të dhënash sipas kategorive as po sipas grupeve synuese. Nuk ka kurrëfar mekanizmi për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme. Informatat për listën e personave të cilët marrin ndihmë sociale merren vetëm nga Qendra për punë sociale. Komunikimi në këtë aspekt bëhet vetëm nëse vjen kërkesë nga ana e qytetarëve për sigurimin e ndihmës ose për konsultim. Qytetarët të cilët kanë ndonjë problem të caktuar drejtohen me kërkesë tek Këshilli ose tek kryetari.

Komuna më veti nuk bën vlerësim të nevojave të grupeve të varfëra dhe të prekshme.

1.5. Sigurimi i shërbimeve sociale nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe aktivitetet projektuese/programike të realizuara nga sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale

Komuna e Radovishit ndan mjete financiare për mbrojtje sociale nga alinea buxhetore për rezerva vijuese. Për vitin 2010, janë ndarë rreth 200.000 denarë.

Kjo shumë e mjeteve financiare është identike me vitin 2009, kur nga buxheti komunal janë ndarë 191.500 denarë. Në përqindje, ky numër është 0.23% nga buxheti i përgjithshëm komunal.

Komuna deri më tani ka aplikuar për projekte nga sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. Përmes CARDS projektit, të emruar si "Përkrahje e politikës për punësim - faza III", janë përforcuar kapacitetet e institucioneve relevante për zbatimin, vëzhgimin dhe vlerësimin e qëllimeve të caktuara me Strategjinë kombëtare për punësim të viti 2010 dhe Planin veprues kombëtar për punësim 2006-2008. Për këtë qëllim, është përgatitur edhe **Plan veprues lokal për punësim** për Komunën e Radovishit.

Në Komunën e Radovishit është hapur dhe aktivisht punon qendra ditore për personat mbi 18 vjeç me pengesa mesatare dhe të rënda në zhvillimin intelektual, në bashkëpunim me shoqatën qytetare "RCPLIP Poraka" – Shkup. Këtë qendër e vizitojnë 10 deri më 15 shfrytëzues. Komuna e Radovishit ka vënë në dispozicion hapsirë komunale për nevojat e qendrës ditore.

Në bashkëpunim me Ministrinë për punë dhe politikë sociale aktualisht zbatohet projekti "Kuzhina popullore". Komuna përmes Qendrës për punë sociale merr listë për marrësit e ndihmës sociale dhe siguron vend ku përgatitet ushqimi. **63 qytetarë e shfrytëzojnë këtë shërbim në "kuzhinën popullore".**

Përmes Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara është zbatuar projekti EMI 2 – për praktikë vullnetare dhe punësim të personave të ri të papunësuar të cilët kanë arsim të lartë. Megjithatë, efektet e këtyre projekteve janë afatshkurtëra dhe nuk dihet se nëse këto të rinj janë punësuar dhe nëse mëtutje Komuna ka investuar në masa të ngjajshme.

Në vitin 2009 është zbatuar projekt për trape të qasëshme përpara institucioneve relevante, për t'u lehtësuar qasja e personave me hendikep.

Më në fund, përmes GEF, Komuna ka realizuar projekt për efikasitet energjetik, me të cilin në tre objektet e çerdheve janë ndërruar dyert dhe dritaret me qëllim që të kursehet energjia elektrike dhe të sigurohet ndriçim i përshtatshëm. Me një pjesë të mjeteve të këtij projekti, në bulevardin e Komunës së Radovishit është ndërruar ndriçimi, me qëllim që i njëjti të jetë energjetikisht efikas dhe të mundësohet kursim i energjisë elektrike.

1.6. Përmirësim i gjendjes së personave socialisht të rrezikuar

Në Komunën e Radovishit, në pajtim me programin qeveritar për politika aktive në tregun e punës në nivel kombëtar janë realizuar një sërë projektesh.

Në këtë aspekt, në periudhën 2008-2009, 14 persona kanë qenë pjesë e projektit për përkrahje të punësimit dhe fillimit të biznesit. Grupe synuese të kësaj mase kanë qenë personat e papunësuar nga vendet e pazhvilluara, të papunësuarit në afat të gjatë, shfrytëzuesit e ndihmës në para dhe personat e rinj.

Personat e papunësuar në një kohë më të gjatë dhe ato të cilët shfrytëzojnë ndihmë sociale, janë angazhuar nga njësi për vetëqeverisje lokale për kryerjen e punëve publike dhe kanë marrë përkrahje financiare prej 6.000 denarëve, transport të paguar, ushqim dhe sigurim në rast të aksidentit për një periudhë 6 mujore. Numri i këtyre personave të cilët kanë kryer punë publike komunale për vitin 2008 ka qenë 45, ndërsa në vitin 2009 është dyfishuar, gjegjësisht bëhet fjalë për 100 persona të angazhuar për zbatimin e punëve publike. Në vitin 2010, **me këtë masë nuk është përfshirë asnjë person.**

Në periudhën 2007-2009, përmes Agjencisë për punësim dhe Qendrës për punë sociale në Radovish, është subvencionuar punësimi i invalidëve. Subvencionet për punësimin e prindërve të vetëm dhe fëmijëve pa prindër kanë qenë prej 11.200 denarë në muaj për një periudhë 6 mujore, me detyrë që punëdhënësi ti mbajë për një periudhë prej më së paku 18 muaj. **Megjithatë, efektet e kësaj mase mbeten të panjohura për shkak se nuk dihet numri i saktë i personave të cilët kanë mbetur të punësuar dhe nëse fare kanë mbetur si të tillë.**

Në territorin e Komunës së Radovishit janë angazhuar 8 persona të papunësuar nga regjionet më të pazhvilluara për kryerjen e punëve ndërtimore. Me këtë masë, është siguruar kompenzim për punën e bërë në shumë prej 5.100 denarë, tatim personal dhe kompenzim për ushqim dhe transport në shumë prej 3.200 denarëve në muaj për gjithsej 6 muaj.

Me masën për trajnime dhe këshillime për kualifikime të reja, kontakte me punëdhënësit, përmirësim të dijenive dhe aftësive dhe trajnime për kompjutera, është organizuar trajnim për personat e papunësuar me obligim që punëdhënësi ti punësojë personat të cilat me sukses do ta kryejnë trajnimin. Përkrahje përbëheshite nga dhënia e mjeteve financiare në një shumë prej 2.000 denarëve për punëdhënësin dhe 4.000 denarë për personin e papunësuar për një periudhë 3 mujore. Qendra për punësim në Radovish rregullisht ka organizuar trajnime të tilla për mjeshtëri kompjuterike dhe gjuhë angleze.

Megjithatë, **Komuna nuk posedon plan strategjik për përmirësimin e gjendjes së personave socialisht të rrezikuar.** Aktivitetet janë projekte afat-shkrutëra nga të cilat nuk mund të shihen rezultate konkrete në afat të mesëm dhe të gjatë.

1.7. Investime kapitale dhe infrastrukturë në sferën e mbrojtjes sociale

Komuna e Radovishit hyri në fazën e dytë të decentralizimit, gjegjësisht në decentralizimin fiskal në vitin 2005. Në këtë drejtim, Komuna e Radovishit në sferën e mbrojtjes sociale, gjegjësisht në institucionin për moshë parashkollore në periudhën 2005-2010 ka investuar prej 4.500.000 deri më 5.000.000 denarë në infrastrukturë.

Sa i takon çerdhes, Komuna ka investuar në garthëzimin e njëjës prej tre çerdheve, përmes ndërtimit të murit rrethues, ndriçimit publik, kanalizimit fekal dhe administrativ.

Në shkollën fillore "Nikolla Karev", Komuna ka kontribuar financiarisht për ndërtimin e kanalizimit atmosferik dhe ndërtimin e çatisë.

Për rindërtimin e çatisë në shkollën e mesme, Komuna ka investuar 1.000.000 denarë.

Komuna ka **shtëpi pensionerësh**, në të cilën vendosen personat me të ardhura të vogla ose personat të cilët janë raste sociale. **Komuna nuk ka shtëpi për personat e moshuar.**

Komuna **ka qendër ditore për personat me nevoja të posaçme**. Komuna **nuk ka paralele për personat me nevoja të posaçme**. Këto fëmijë shkollohen në Strumicë. Gjithashtu, edhe fëmijët me kufizime intelektuale e ndjekin shkollën në Strumicë.

2. Qendra për punë sociale - Radovish

Qendra për punë sociale – Radovish (në tekstin e mëtutjeshëm QPS) shërben dy komuna, me rreth 32.000 qytetarë.

– Intervista u realizua me Znj. Pavlinka Petrusheva, punonjës social në Qendrën për punë sociale në Radovish.

2.1. Identifikimi i grupeve të varfëra dhe të prekshme

Për gjendjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme në Komunën e Radovishit, përfaqësuesja i shfrytëzonte evidencat e QPS. Si kategori e prekshme më e përfaqësuar janë **romët**. Ato në përqindje janë shfrytëzues më të përfaqësuar të ndihmës sociale në para. Përfaqësuesja e QPS ceku se në vitet e fundit shumë shpesh ndodh që romët të deklarohen si turq. Është evident dallimi mes popullatës turke e cila gjendet në vendet rurale, për dallim të romëve të cilët deklarohen si turq dhe e flasin gjuhën turke.

Fëmijët më së shpeshti paraqiten si kategori e prekshme gjatë proceseve divorcuese, përderisa shumë më rrallë ka raste të fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror.

Si kategori e prekshme, **gratë** paraqiten si nëna të vetme, shfrytëzuese të ndihmës sociale në para ose ndihmës së përhershme në para.

Pakicat gjenden si shfrytëzues të të gjitha ndihmave në para.

Në një përqindje shumë të vogël gjenden **personat me nevoja të posaçme**, të cilët i shfrytëzojnë të drejtat të cilat burojnë nga ligji për mbrojtje sociale.

Personat e moshuar nuk janë shumë të përfaqësuar, mirëpo në QPS më së shpeshti gjenden si shfrytëzues të ndihmës së përhershme në para në bazë të varfërisë.

QPS – Radovish, nuk ka procedura dhe mekanizma të përcaktuara posaçërisht për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme. Identifikimin e përcaktojnë individualisht, pas regjistrimit të rastit. Gjendja lidhur me këtë çështje përsëritet dhe është identike si edhe në komunat tjera.

2.2 Shërbimet dhe qasja në shërbimet e Qendrës për punë sociale

Shërbimet të cilat i ofron QPS - Radovish janë në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale dhe Ligjin për familje.

Në QPS numri i bartësve (shfrytëzuesve) të ndihmës sociale në para është 900 shfrytëzues. Për të dhënat në para janë përgjegjës tre punonjës social, si dhe një punonjës social i cili kujdeset për punën sociale të kategorive tjera. Në procedurën për realizimin e një të drejte të posaçme nga sfera e mbrojtjes sociale, të ardhurat duhet të jenë të kufizuara dhe kjo gjë paraqet problem për grupet e varfëra dhe të prekshme për ti realizuar të drejtat e tyre të cilat u takojn me ligj. Nga ky aspekt klientët ndjehen të dikriminuar. Përfaqësuesja e QPS, Znj. Petrusheva dha deklaratë me qëndrim se medoemos të ketë kufizim të të hyrave në një familje: "*Medoemos të ketë kufizim, përndryshe ne nuk do të dimë se si të punojmë*". Procedura për të dhënat në para për personat me paaftësi pune të pjesërisht ose të plotë duhet të lehtësohen, pa kufizime dhe kushte shtesë. Mjetet nga të dhënat në para nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale të shfrytëzuesve.

Në Komunën e Radovishit ka një qendër ditore për personat e moshuar dhe një kuzhinë popullore. Numri për shfrytëzim të kuzhinës popullore është i kufizuar dhe i njejtë përmban 80 haje. Këtë shërbim mund ta shfrytëzojnë vetëm një numër i personave më të rrezikuar.

Si edhe në QPS tjera, edhe këtu përsëritet problemi me sigurimin e dokumentacionit. Klientët në plotësim ballafaqohen me vështirësi gjatë nxjerrjes së letërnjoftimeve. Ministria për punë të brenshme takimet për letërnjoftim të ri i cakton pas një periudhe më të gjatë kohore. Pa këtë dokument për identifikim personal, klienti nuk mund të bëjë kërkesë në QPS. Për një pjesë të dokumenteve, klientët duhet të paguajnë një shumë ta caktuar të parave, gjë e cila në plotësim e vështirëson gjendjen e tyre financiare. Për tu lehtësuar procedura për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm është i nevojshëm rrjetëzimi me të gjitha institucionet.

QPS – Radovish nuk disponon me ambient të përshtatshëm për pritje dhe pranim të klientëve. Personat profesional ballafaqohen me probleme gjatë sigurimit të diskrecionit për shkak të mungesës së zyrave. QPS ka nevojë që të punësojë personel profesional dhe teknik. Është tepër e rëndësishme të përmendet se në QPS nuk ka person të punësuar për mirëmbajtjen e higjienës në objekt. Duhet të krijohen kushte më të mira për shërbimin e qytetarëve, siqë është sistemi sportelit dhe veturë terrenike e cila do të jetë në disponim të tyre në çdo kohë.

Sa u takon ndihmave në para, të njejtat duhet të zmadhohen ndërsa shuma nga ndihma sociale në para duhet të jetë fikse për të gjithë periudhën e shfrytëzimit. Në Komunën e Radovishit nga shërbimet e specializuara, e domosdoshme është hapja e strehimores për gratë-viktima të dhunës familjare dhe qendra ditore për të gjitha kategoritë e personave. QPS – Radovish nuk ka njësi të shpërndara në komunat rurale.

2.3. Preventiva dhe përkrahja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS – Radovish nuk ka kushte për ta zbatuar preventivën sociale. Si arsye ceket mungesa e kuadrove profesionale. Preventiva zbatohet në raste individuale, sipas nevojave të klientit, në kornizat e QPS ose gjatë kontrollës së drejtëpërdrejtë.

QPS – Radovish nuk ka mekanizma dhe procedura të përcaktuara posaçërisht për mbrojtjen dhe përkrahjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme.

Qytetarët e Komunës së Radovishit informohen për të drejtat e tyre nga sfera e mbrojtjes familjare dhe Ligji për familje përmes broshurave dhe kontaktit të drejtëpërdrejtë me QPS.

2.4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS – Radovish nuk ka program as mekanizma të përcaktuara për konsultim me qytetarët e Komunës së Radovishit. Klientët konsultohen me personat kompetent në QPS – Radovish. Sipas deklaratës së përfaqësues së QPS – Radovish: *"Të gjithë klientët tanë vijnë rregullisht për tu regjistruar çdo muaj prej 1 deri më 15. Nëse ka ndonjë problem ato e tregojnë atë."*

2.5. Bashkëpunimi i Qendrës për punë sociale me vetëqeverisjen lokale

QPS – Radovish ka bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale. Një pjesë e shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para janë angazhuar në punë nga ana e Komunës së Radovishit. Angazhimi i tyre në punë ka qenë i kufizuar dhe ka zgjatur 5 ditë deri më 6 muaj. Në periudhën kohore kur shfrytëzuesit kanë qenë të punësuar, ndihma sociale në para u ka pushuar dhe e njejta është aktivizuar pas mbarimit të angazhimit në punë. Një numër i vogël i kësaj kategorie të shfrytëzuesve janë punësuar. QPS – Radovish nuk ka bashkëpunim të mirë me vetëqeverisjen lokale në vendet rurale.

QPS – Radovish bashkëpunimin me Ministrinë për punë dhe politikë sociale e vlerëson si të mirë. Megjithatë, është evidente gjendja e mungesës së mjeteve financiare të cilat do ta përmirësojnë gjendjen materiale të grupeve të varfëra dhe të prekshme. Kjo situatë ndodh për një kohë më të gjatë dhe nuk ka ndryshuar. QPS – Radovish bashkëpunon me Agjencinë për punësim. Kjo agjenci çdo muaj i dorëzon QPS raport mujor për statusin punësor të shfrytëzuesve të shërbimeve nga mbrojtja sociale. Përmes Agjencisë për punësim, gjegjësisht përmes projekteve janë punësuar nëna të vetme, mirëpo QPS nuk disponon me të dhëna për atë se sa është numri i tyre.

QPS – Radovish bashkëpunon me shoqatat qytetare. Kanë pasur bashkëpunim të mirë me shoqatën qytetare "Poraka". Kjo shoqatë ofron shërbime për personat me nevoja të posaçme dhe ka qendër ditore për qëndrim gjatë ditës. QPS këtë kategori të njerëzve e drejton në këtë shoqatë ku do të mund ti shfrytëzojnë shërbimet e tyre.

QPS – Radovish nuk ka bashkëpunim me sektorin e biznesit privat.

3. Të dhëna nga fokus grupet e organizuara

Në Komunën e Radovishit u organizuan dy fokus grupe. Njëri përbëheshte prej grave të nacionalitetit maqedonas, ndërsa tjetri përbëheshte prej grave dhe burrave të nacionalitetit maqedonas. Përmes intervistave në Komunën e Radovishit u diskutua për gjendjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme.

3.1. Persona të moshuar

Gjendja e personave të moshuar në Komunën e Radovishit është brengosëse, për shkak të asaj se një numër i madh i pensionistëve kanë pensione minimale. Për shkak të shkallës së madhe të varfërisë, pensionerët jetojnë në një familje me më shumë gjenerata. Anëtarët tjerë të familjes janë të papunësuar dhe varen nga të ardhurat e pensionit të prindërve të tyre.

Kushtet e jetesës së personave të moshuar janë relativisht të mira, si në shtëpitë e tyre ashtu edhe në shtëpitë publike për personat e moshuar. Sa i takon mbrojtjes shëndetësore, personat e moshuar nuk janë të kënaqur nga shërbimet e tyre, parimisht për shkak të asaj se duhet të paguajnë participim për shërbimet shëndetësore si dhe participim për barnat. Pensionerët gjenden në një gjendje të pakënaqshme për shkak se gjatë gjithë kohës që kanë punuar kanë kontribuar në Fondin për sigurim shëndetësor, ndërsa tani nuk mund ti shfrytëzojnë shërbimet dhe barnat e tyre falas. Si problem paraqitet edhe ajo që nuk funksionon shërbimi për ndihmë urgjente mjekësore. Pjesëmarrëset nuk kishin informata lidhur me atë se me çfarë problemesh ballafaqohen personat e moshuar gjatë realizimit të së drejtave nga mbrojtja sociale.

3.2. Gra

Në Komunën e Radovishit gratë janë më së shumti të përfaqësuara si viktimat të dhunës familjare. Dhunën nuk e paraqesin për shkak të frikës nga dhunuesi, vlerave tradicionale patriarkale dhe pasigurisë ekonomike. Është e nevojshme që institucionet të punojnë në rritjen e vetëdijes tek qytetarët për mbrojtje nga dhuna familjare, ndërsa viktimat të fitojnë ndihmë dhe përkrahje të përshtatshme nga ana e shtetit.

Kushtet e jetesës për gratë janë të kënaqshme, në një nivel modest të jetesës. Gruaja diskriminohet në tregun e punës para së gjithash për shkak të moshës. Si problem shtesë paraqitet edhe gjendja e grave në moshë mbi 40 vjeç, të cilat janë me shëndet të dobët, kanë disa sëmundje të caktuara, për shkak të cilave nuk janë të afta për punë, mirëpo këto diagnoza nuk janë pjesë e kategorisë me të cilat do të mund të realizojnë ndihmë nga sfera e mbrojtjes sociale. Për shkak të papunësisë dhe luftës për ekzistencë, gratë janë të detyruara të punojnë punë fizike në formacionet agrikuturore. Gratë e punësuara cekën se në firmat private ka mobing në të gjitha format. Atyre nuk ju paguhet në plotësi sigurimi për vjetërsi në punë, marrin rrogë minimale dhe nuk kanë orar të caktuar pune. Me këtë punëdhënësit e keqpërdorin punën e lirë femrore. Shkalla e papunësisë në Komunën e Radovishit në përgjithësi është e lartë.

Tek gratë nuk është e zhvilluar vetëdija për mbrojtje të rregullt shëndetësore dhe nuk janë të njoftuara me të drejtat e tyre nga sfera e mbrojtjes shëndetësore. Duhet të inicohet edukim shëndetësor në kornizat e procesit të rregullt arsimor. Si problem tjetër për shkak të cilit gratë nuk i shfrytëzojnë rregullisht shërbimet shëndetësore është pafuqia financiare, për shkak se për të gjitha shërbimet shëndetësore të mbrojtjes sekondare dhe terciare paguhet participim. Shërbimet shëndetësore në institucionet private shëndetësore paguhet në tërësi.

3.3. Fëmijë

Si një kategori posaçërisht e prekshme janë fëmijët e familjeve ku ka dhunë familjare. Kjo gjë reflektohet në zhvillimin e tyre psiko-fizik. Si problem tjetër ceket varfëria, për shkak të cilës prindërit nuk kanë mundësi që t'jua mundësojnë kushtet e përshtatshme lidhur me nevojat për zhvillim të drejtë të fëmijëve.

Varfëria paraqet parakusht që fëmijët të konsumojnë alkool, drogë dhe të merren me dukuri të tjera negative, ndërsa gjithashtu paraqet problem që fëmijët të mos mund ta vazhdojnë arsimin.

Shteti nuk i punëson dhe nuk ju siguron banim fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror pas arritjes së moshës madhore. Fëmijët diskriminohen nga vetë Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, për shkak se si parakusht për ta marrë shtesën feminare kërkohet që më së paku njëri prind të jetë i punësuar si dhe ka kufizime të parapara të të ardhurave për secilin anëtarë të familjes dhe mu për shkak të kësaj, këtë ndihmë nuk mund ta shfrytëzojnë fëmijët prindërit e të cilëve janë të papunësuar. Ndihma në para e dedikuar për fëmijët është minimale dhe nuk i përmbush nevojat kryesore ekzistenciale të një fëmiu. Në çerdhe nuk ka kushte të përshtatshme për strehimin e fëmijëve me nevoja të posaçme, ndërsa në shkollat e specializuara sigurohen kushte të përshtatshme për ndjekjen e mësimin të kësaj kategorie të fëmijëve.

3.4. Persona me nevoja të posaçme

Personat me nevoja të posaçme nuk janë shumë prezente në Komunën e Radovishit. Sa i takon angazhimin në punë të kësaj kategorie të personave, punëdhënësit sigurojnë kushte të mira për punë dhe rrogë adekuate. Ligji nga sfera për ndihmë sociale është diskriminues ndaj këtyre persona mu për shkak të kushtit lidhur me kufizimin e të ardhurave në një familje, por gjithashtu edhe ndihma në para nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale të këtyre personave.

3.5. Rom

Në Komunën e Radovishit, romët deklarohen si anëtarë të bashkësisë etnike turke. Romët çdoherë gjatë regjistrimit janë deklaruar si rom, mirëpo në vitet e fundit është shpeshuar shprehia që të njëjtit të quhen turq dhe ta flasin gjuhën turke. Pjesëmarrësit si shkak për këtë dukuri i cekin donacionet e lajmëruara nga ana e organizatave turke për të cilat romët mendojnë se nëse deklarohen si turq do të mund të marrin një pjesë të këtyre donacioneve. Romët nuk kanë kushte të përshtatshme jetese dhe ato jetojnë në pragun e varfërisë. Një pjesë e madhe e popullatës rome nuk ka arsim dhe aspak nuk janë të evidentuar nga ana e institucioneve shtetërore, gjegjësisht nuk posedojnë as edhe çertifikatë lindje. Në veçanti theksohet se fëmijët e gjinisë femrore aspak nuk evidentohen për dallim të fëmijëve të gjinisë mashkullore, të cilët më së shpeshti regjistrohen në librin amë. Kjo është shkak që romët mos kenë mbrojtje të përshtatshme shëndetësore për shkak se nuk kanë sigurim shëndetësor. Një numër i madh i fëmijëve të popullatës etnike rome nuk arsimohen. Romët janë më të përfaqësuar mes shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para.

3.6. Pakica

Pjesëmarrësit si pakica përsëri i ceken romët, të cilët deklarohen si turq dhe ceken se ka një përqindje të vogël të përfaqësuesve të bashkësisë etnike shqiptare.

D. Komuna e Shtipit

1. Njësia e vetëqeverisjes lokale – intervista u zbatua me Znj. Vishna Shorova-Angelova, bashkëpunëtore në Sekcionin për zhvillim ekonomik lokal në Komunën e Shtipit.

1.1. Mekanizma institucionale për mbrojtje sociale në Komunën e Shtipit

Në Komunën e Shtipit **ka Sektor për çështje juridiko-normative, informim dhe shërbime dhe punë të përgjithshme.** Në suazat e këtij sektori ka Sekcion për punë juridiko-normative, furnizime publike dhe përkrahje të Këshillit dhe **Sekcion për punë publike dhe të përgjithshme. Sekcioni për punë publike dhe të përgjithshme punon me çështjet e lidhura me arsimin dhe mbrojtjen sociale.**

Gjegjësisht, edhe pse në Komunën e Shtipit **nuk ka person të punësuar për të punuar në veçanti me çështjet e sferës së mbrotjes sociale,** të punësuarit në Sekcionin për zhvillim ekonomik lokal, të cilët punojnë si nëpunës shtetëror, i elaborojnë edhe çështjet e shëndetësisë, ato sociale, mbrojtje fëmimore, arsim, sport dhe kulturë. Aktivitetet lidhur me këtë problematikë trajtohen në korelacion me Sektorin për punë normativo-juridike, të përgjithshme dhe publike në Komunën e Shtipit.

Në kornizat e Këshillit të Komunës së Shtipit ka komision të përhershëm për veprime shoqërore. Ky komision i shqyrton çështjet të cilat janë përgjegjësi e Komunës dhe ndërlihen me kulturën, sportin, rekreimin, mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve, arsimin, mbrojtjen shëndetësore, sigurinë publike dhe sigurinë në komunikacion, si dhe mbrojtjen nga zjarri. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve të Këshillit të Komunës. Sa u takon seancave, komisioni takohet sipas nevojës për zgjidhje të disa çështjeve të caktuara nga sfera e mbrojtjes sociale.

Edhe pse në Statutin e Komunës së Shtipit³¹, nuk është paraparë komisioni për mbrojtjen e të drejtave fëmimore, **i njejt komision është formuar dhe ekziston në suazat e Komunës së Shtipit** dhe përbëhet prej 5 anëtarëve të Këshillit.

1.2. Programe dhe plane vepruese nga sfera e mbrojtjes sociale duke përfshirë edhe programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve

Në Komunën e Shtipit **nuk ka program pune për komisionin e përhershëm për veprime shoqërore.** Programi i tillë **deri tani asnjëherë nuk është miratuar.**

Komuna e Shtipit **ka Plan lokal veprues për zhvillim të mbrojtje sociale për periudhën 2007-2012,** i përpiluar nën patronazhin e Ministrisë për punë dhe politikë sociale. Komuna e Shtipit është bartës kryesor i Planit veprues për mbrojtje sociale. Për qëllimet e këtij plani është formuar trup koordinativ i cili ka detyrë që të bëjë kontrollë të vazhdueshme të realizimit të aktiviteteve të parapara me të. Trupi koordinativ përbëhet prej vepruesve të rëndësishme në Komunën e Shtipit; këshilltarë në komunën e Shtipit, bashkëpunëtorë nga

³¹ Neni 26 nga Statuti i komunës së Shtipit, Gazeta zyrtare e komunës nr. 01/03, 18/07, 11/08, 07/09, 16/09.

Sekcioni për zhvillim ekonomik lokal dhe mbrojtje të mjedisit jetësor, referent për çështje rreme, punonjës social dhe përfaqësues i një shoqate qytetare.

Sa i takon planit lokal veprues për mbrojtje sociale, është interesante të shënohet se ai në fakt është konceptuar në disa plane vepruese dhe është përgatitur dhe ndarë në 6 grupe synuese:

1. Fëmijë në rrugë;
2. Persona të moshuar;
3. Persona me kufizime intelektuale dhe fizike mbi 18 vjeç;
4. Viktima të sëmundjeve të varësisë (alkool, drogë dhe nikotin);
5. Viktima të dhunës familjare dhe
6. Viktima të tregtisë me njerëz.

Për secilin grup synues është përgatitur program dhe gjithashtu edhe plan veprues. Është përgatitur edhe buxhet për realizimin e planit lokal veprues, ku janë cekur burime konkrete të financimit të mundshëm të veprimeve dhe aktiviteteve të planit.

Megjithatë, në kornizën kohore **afatet për realizimin e aktiviteteve nuk janë qartësisht të precizuara** dhe nga kjo ndjekja e asaj që është realizuar me planin është e pamundshme. Kjo arsyetohet me faktin se mjetet financiare të planifikuara për realizimin e aktiviteteve janë potenciale, gjë e cila e pamundëson precizimin e saktë të afateve.

Është paraparë që trupi koordinues të shpallë raporte vjetore për ndjekjen e zbatimin të aktiviteteve dhe progresin e planit veprues për zhvillim social, si dhe të mbajë takime të rregullta dhe të ndajë informata me të gjitha forcat sociale në nivel të Komunës së Shtipit. Megjithatë duke e pasur ndërmend faktin se shumica e përfaqësuesve të përfshirë në përpilimin e planit lokal janë këshilltarë në Këshillin e Komunës së Shtipit, mandati i të cilëve ka mbaruar, len një zbrastirë në aspekt të realizimit të kompetencave dhe aktiviteteve të cilat ky trup koordinues duhet që ti ketë. Si pasojë e kësaj, **ka diskontinuitet lidhur me aktivitetet për vëzhgimin dhe vlerësimin e planit lokal veprues për mbrojtje sociale.** Të punësuarit në administratën komunale, më saktësisht në Sekcionin për zhvillim ekonomik lokal, në koordinacion me Sekcionin për punë publike përgatisin raport për aktivitetet e realizuara lidhur me planin lokal për veprim. Më saktësisht, **administrata komunale është bartës kryesor** i të gjitha aktiviteteve raportuese lidhur me planet e miratuara të Komunës.

Në Komunën e Shtipit, përpos planit lokal veprues për mbrojtje sociale, **ka edhe Plan lokal veprues për të drejtat fëmimore** për periudhën 2009-2014, ndërsa i njejti është miratuar në janar të vitit 2009.

Plani veprues lokal për të drejtat fëmimore është i ndarë në 6 qëllime programike, gjegjësisht strategjike dhe atë:

1. ARSIM - Qëllimi strategjik: Sigurim i kualitetit më të lartë në arsim;
2. MBROJTJE SOCIALE DHE KUJDES FËMINOR – Qëllimi strategjik: Fëmijë i cili mund ti realizojë të drejtat e tij formale;
3. FAMILJA SI SHTYLLË E JETESËS SHOQËRORE – Qëllimi strategjik: Secili fëmijë të jetojë në familje;
4. MBROJTJE SHËNDETËSORE DHE KUJDES FËMINOR – Qëllimi strategjik: Ruajtja dhe përmirësimi i shëndetit të fëmijëve;
5. MANIFESTIME KULTURORE DHE SPORTIVE PËR FËMIJË – Qëllimi strategjik: Kultura dhe sporti të qasëshme për secilin fëmijë;

6. RREGULLIMI URBAN DHE MJEDISI I SHËNDOSHË PËR FËMIJËT – Qëllimi strategjik: Parqe, terrene sportive dhe sipërfaqe të gjelbërta për të gjithë fëmijët.

Ky plan për dallim të PLV për mbrojtje sociale **nuk ka buxhet saktësisht të precizuar për zbatimin e aktiviteteve**, por një shumë totale ose vetëm një buxhet indikues të paraparë për secilin nën-aktivitet të qëllimeve strategjike. Në plan **mungon korniza e përshtatshme kohore** për realizimin e aktiviteteve.

Komuna është bartës kryesor i planit dhe ka formuar trup koordinues me detyrë që të bëjë kontrollë të vazhdueshme në përpilimin dhe realizimin e planit lokal, si dhe në gjendjet dhe nevojat e fëmijëve në nivelin e Komunës së Shtipit. Edhe pse ky trup koordinues, si edhe në planin lokal veprues për mbrojtje sociale, trupi përbëhet prej organizatave relevante dhe institucioneve në nivel lokal (këshilltarë nga Këshilli i Komunës së Shtipit, përfaqësues të shkollave fillore dhe të mesme, institucione parashkollore, Sektori për punë të brendshme, Enti për mbrojtje shëndetësore). Përsëri vëzhgimi i aktiviteteve dhe përgatitja e raporteve për përparimin e zbatimit bëhet nga komisioni i përhershëm për të drejtat femënore, në bashkëpunim me Sekcionin për punë publike dhe Sekcionin për zhvillim ekonomik lokal. Si edhe në planin paraprak, edhe në këtë plan **ka diskontinuitet lidhur me vëzhgimin e aktiviteteve nga trupi koordinues**, për shkak se vetë këshilltarët ndërrohen dhe pas mbarimit të mandatit të tyre nuk dihet se kush do të jetë pjesë e trupit koordinues.

Në Komunë **ka bashkëpunim ndër-sektoral** me komisionet dhe sektoret tjera për çështje të kësaj sfere (për shembull me komisionin për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave, i cili posedon plan veprues vetanak, për zbatimin e të cilit komunikon dhe bashkëpunon edhe me komisionet tjera të Këshillit komunal). Komisionet e Këshillit bashkëpunojnë me Sekcionin për punë publike për shkak se qytetarët për ndihmë drejtohen mu në këtë sekcion. Sa i takon krijimit të strategjive dhe planeve lokale, ka bashkëpunim ndër-sektoral jo vetëm me komisionet e Këshillit por edhe me shoqatat qytetare, shkollat, institucionet shëndetësore etj.

Komuna e Shtipit, **asnjëherë deri tani nuk ka miratuar as po ka propozuar programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve** të cilët jetojnë në territorin e saj.

Sidoqoftë, në komunë **ka plan strategjik** të përgatitur përmes Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara, sipas të cilit edhe po përgatiten planet vepruese në Komunë.

1.3. Mekanizma për konsultim dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal dhe ndërkombëtar dhe bashkëpunimi mes institucioneve relevante nga sfera e mbrojtjes sociale dhe shoqatat qytetare

Në Komunën e Shtipit **ka kulturë të mirëmbajtjes së lidhjeve me publikun**. Gjegjësisht, mediat marrin gazetë elektronike, me qëllim që të raportojnë për aktivitetet e Komunës. Kryetari i komunës përmes konferencave të shtypit, raporton për aktivitetet kryesore komunale. Të gjitha vendimet e Këshillit të Komunës shpallen në Gazetën zyrtare.

Kryetari i viziton bashkësitë lokale për të shqyrtuar problemet dhe nëse ai nuk mundet ta bëjë këtë, të njëjtat vizitohen nga përfaqësues të Komunës.

Në sferën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale deri tani ka pasur bashkëpunim me organizatat joqeveritare, në veçanti në sferën e krijimit të planeve lokale vepruese. Sidoqoftë, në Komunë **nuk është ndërmarrë iniciativë qytetare e nënkuptuar sipas rregullave normative**, lidhur me këtë lloj të çështjeve. Komunikimi me qytetarët zhvillohet përmes lidhjes së drejtëpërdrejtë me ato që kanë nevojë për ndihmë gjatë përgatitjes së dokumenteve, personat të cilët kanë nevojë për ndihmë të njëhershme etj.

Nuk ka mekanizma të përshtatshëm për konsultime dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në këtë Komunë.

Komuna e Shtipit **bashkëpunon me Qendrën për punë sociale**, posaçërisht sa u takon të dhënave. Në këto raste, personat të cilët vijnë në Komunë për të kërkuar ndihmë, udhëzohen për tu drejtuar në Qendrën për punë sociale. Gjithashtu, mes shoqatave qytetare, përfaqësuesve të qendrave për punë sociale dhe vetëqeverisjes lokale ka bashkëpunim sa i takon dhënies së propozimeve nga sfera e mbrojtjes sociale, gjë e cila paraqet bazë për krijimin e politikave në interes të qytetarëve.

Edhe përpos të këtij bashkëpunimi, i cili ndodh më së shpeshti kur krijohen projekte ose plane lokale vepruese, në Komunën e Shtipit **nuk ka mekanizma të përcaktuara për konsultimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal.**

1.4. Mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Në Komunën e Shtipit edhe pse janë miratuar plane lokale vepruese për të drejtat femërore dhe mbrojtje sociale, në të cilat kanë marrë pjesë të gjithë vepruesit relevant në nivel lokal, mungon **mekanizëm për vlerësimin e nevojave të grupeve të varfëra dhe të prekshme, i cili rregullisht do të zbatohet nga të punësuarit në administratën komunale**, pavarësisht a duhet të përgatitet plan apo strategji e përshtatshme lokale. Kjo do të ndihmojë që në afat më të gjatë, Komuna të disponojë me informata të përshtatshme për nevojat e grupeve të varfëra dhe të prekshme, dhe do të jetë bazë për krijimin e programeve zhvillimore të këtyre grupeve në Komunë në një afat të mesëm dhe të gjatë.

Nuk ka bazë të dhënash për çështjet lidhur me mbrojtjen dhe përfshirjen sociale. Kryetarët e bashkësive lokale/urbane e vizitojnë komunën, e cila ju tregon për ndonjë problem për të cilin diskutohet a është i përshtatshëm për tu zgjidhur në nivel lokal dhe i njejtë pason në rendin ditor të Këshillit të Komunës. Megjithatë, praktika e tillë nuk siguron efekte gjithë-përmbledhëse dhe afatgjata në procesin e identifikimit të grupeve të varfëra dhe të prekshme.

Informatat për listën e personave të cilët marrin ndihmë sociale merren **vetëm nga Qendra për punë sociale**. Komunikimi në këtë aspekt zhvillohet vetëm nëse vjen kërkesë nga ana e qytetarëve për sigurimin e ndihmës ose për konsultim.

Qytetarët të cilët kanë ndonjë problem të caktuar drejtohen me kërkesë tek Këshilli ose tek kryetari.

Në Sekcionin për punë publike ka një person i cili punon me çështjet e mbrojtjes femërore. Ky person mban evidencë për nevojat e fëmijëve. Megjithatë, ky segment është vetëm një pjesë e asaj e cila duhet të ekzistojë si mekanizëm dhe praktikë në komunë sa i takon identifikimit të grupeve të varfëra dhe të prekshme.

1.5. Sigurimi i shërbimeve sociale nga ana e njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe realizimi i aktiviteteve projektuese/programike nga sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale

Komuna e Shtipit ndan mjete financiare për qëllime sociale nga alinea buxhetore për rezerva vijuese. Për vitin 2009, janë ndarë mjete financiare në shumë prej 1.100.000 denarë, ndërsa në vitin 2010, 900.000 denarë.

Komuna **deri më tani ka aplikuar për projekte nga sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale.** Është i rëndësishëm për tu përmendur **projekti për ndërtimin e shtëpisë për personat e moshuar.** Gjegjësisht, për qëllimet e këtij projekti, Komuna e Shtipit ka bërë hulumtim në 5 komuna të cilat gjenden rreth saj (Radovish, Sveti Nikole, Probishtip, Karbinci dhe Vinicë). Janë bërë 800 anketa me qytetarë, nga të cilët 300 kanë shprehur interes për tu shpërngulur në shtëpinë për persona të moshuar në Shtip në momentin kur e njejta të ndërtohet. Komuna synon që këtë projekt ta ndërtojë përmes modelit të partneritetit publiko-privat.

Komuna ka realizuar projekt për mundësi të barabarta përmes të cilit janë organizuar ligjerata lidhur me dhunën familjare, barazinë mes gjinive dhe të ngjajshme.

Përmes programit të UNICEFIT, për zhvillim të hershëm fëmënor, ka organizuar vizitë të grupeve të fëmijëve të moshës parashkollore dhe të fëmijëve nga vendet rurale ku nuk ka institucion parashkollor. Për këtë qëllim, komuna ka organizuar transport, a për qëllimet e edukimit në bashkëpunim me Universitetin ka angazhuar profesorë dhe studentë të cilët mund të punojnë me këto fëmijë.

Komuna ka përgatitur dhe dorëzuar projekt në Ministrinë për punë dhe politikë sociale për **hapjen e qendrës ditore për persona të moshuar.** Tek e njejt ministri është dorëzuar edhe **kërkesë për hapjen e qendrës ditore për personat në moshë mbi 18 vjeç me kufizime fizike dhe psikike.** Në gusht 2010, është përgatitur dhe dorëzuar projekt tek një donator potencial për hapjen e **paraleleve speciale për fëmijët me nevoja të posaçme të moshës parashkollore.**

Sa u takon fëmijëve të cilët konsumojnë alkool dhe drogë, komuna ka përgatitur fletushka të cilat janë shpërndarë në shkollën e mesme dhe me të cilat nxënësit informohen për pasojat e dëmshme prej tyre.

Në bashkëpunim me Ministrinë për punë dhe politikë sociale vijon projekti "kuzhina popullore". Komuna nga Qendra për punë sociale merr listë për marrësit e ndihmës sociale dhe siguron vend (në tre çerdhe) në të cilat përgatitet ushqimi. **85 qytetarë e shfrytëzojnë shërbimin e "kuzhinës popullore".**

Nga plani lokal veprues për mbrojtje sociale 2007-2010 janë realizuar 7 aktivitete dhe atë:

1. Projekt i përpiluar për qendër ditore për personat e moshuar në Shtip;
2. Strehimore për persona të moshuar me njësi geriatrike – në vijim është përgatitja e dokumentacionit për ndërtimin e strehimores për persona të moshuar sipas modelit të PPP dhe identifikim i personave të moshuar të cilët janë të interesuar për ti shfrytëzuar shërbimet e strehimores për persona të moshura;

3. Inicimi i ndërtimit të infrastrukturës së përshtatshme për personat me nevoja të posaçme – në kërkesë të kryetarit të Komunës së Shtipit, të gjitha institucionet publike janë detyruar që të bëjnë hyrje të qasëshme për personat me nevoja të posaçme;
4. Klub dhe qendër ditore për animimin, strehimin dhe edukimin e personave me nevoja të posaçme – është për persona mbi 26 vjeç;
5. Aktivitete preventive në arsim – organizimin e ligjeratave për fëmijët nga shkollat fillore dhe të mesme për sëmundjet aktuale sezonale dhe sëmundjet transmetuese seksuale;
6. Funkcionimi i qendrës për rehabilitim dhe resocializim – është hapur qendër ku të varurit nga droga e marrin terapinë e tyre dhe një herë në javë bisedojnë me psikolog;
7. Identifikimi i grave me vjetërsi pune mbi 35 vjet për zgjidhjen e problemit të tyre lidhur me pamundësinë e realizimit të pensionit.

Nga plani lokal veprues për të drejtat femënore në periudhën janar-dhjetor 2010 janë realizuar aktivitetet e ardhshme:

1. Përfshirje e një numri më të madh të fëmijëve në programin për zhvillim të hershëm femënor dhe hulumtim për atë se sa fëmijë nuk ndjekin institucione parashkollore. Gjatë muajit shkurt, në bashkëpunim me Shërbimin polivalent patronazh në IPSH shtëpia shëndetësore "Dr. Pançe Karagjov", janë përgatitur kërkesa të cilat janë dërguar tek prindërit, fëmijët e të cilëve duhet të përfshihen në programin për zhvillim të hershëm femënor, me qëllim që të vlerësohet interesi i prindërve për këtë program dhe të planifikohen aktivitetet e ardhshme të Komunës;

2. Organizimi i kurseve falas për gjuhë të huaja dhe kompjuterë – Komuna e Shtipit ka organizuar kurse falas për gjuhën angleze, gjermane, franceze, spanjolle dhe italiane si dhe për kompjuterë. Kurset janë ndjekur nga 1500 shtipjanë;

3. Përgatitje dhe zbatim i aktiviteteve shëndetësore-preventive. Procter&Gamble dhe Grey Worldwide – program edukativ shkollor "Për ty" për vitin shkollor 2009/2010. Aktivitetet janë zbatuar në shkollat fillore dhe të mesme dhe janë përfshirë vajzat e klasës së 6 në shkollat fillore dhe të vitit të 1 në shkollat e mesme. Temat janë drejtuar kah kujdesi për një jetë të shëndoshë tek popullata e re dhe preventiva nga sëmundjet transmetuese seksuale;

4. Organizimi i manifestimit "Festivali pranveror" (Aprilijada 01.04.2010). Në shënimin e ditës botërore të shakasë kanë marrë pjesë mbi 862 fëmijë. Bëhet fjalë për fëmijët e klasës së parë nga shkollat fillore të Shtipit dhe fëmijët e grupeve më të moshuara të çerdheve;

5. Realizimi i projektit "Droga – vrasës i të rinjve". Organizimi i tribunës publike "Droga-vrasës i të rinjve" si pjesë e projektit të cilin e ka realizuar Seksioni për preventivë në SPB – Shtip në bashkëpunim me Komunën e Shtipit. Organizimi i garave sportive në futboll të vogël mes skuadrave të shkollave fillore në Shtip. Projekti është në përkrahje të Qendrës për punë sociale, institucioneve arsimore, punonjësve social dhe të tjerë; dhe i njejt i ka filluar në nëntor të vitit 2009 dhe është realizuar në disa faza;

6. Rritje e numrit të manifestimeve kulturore për fëmijë. Komuna e Shtipit me qëllim që t'ju japë vend të posaçëm fëmijëve dhe manifestimeve kulturore për fëmijë në kuadër të "Verës kulturore të Shtipit" ka paraparë tema të posaçme për fëmijët të cilat kanë zgjatur prej më 22 deri më 29 qershor të titulluara si "Ditët e fëmiut";

7. Edukim i fëmijëve të çerdheve për selektim primar të mbeturinave. Prezantimin e kanë ndjekur 600 fëmijë në periudhën 29.09-9.10.2010;

8. Organizimi i manifestimit (Maraton biçiklistik).

Komuna e Shtipit në bashkëpunim me Këshillin për siguri dhe shkollat fillore komunale me rastin e 22 shtatorit, dita ndërkombëtare pa automobila, organizon manifestim "Maraton biçiklistik". Në manifestim kanë marrë pjesë rreth 100 fëmijë të shkollave fillore të Komunës së Shtipit dhe Karbincit. Qëllimi i maratonit biçiklistik ka qenë që të rritet vetëdija e banorëve të Komunës së Shtipit për mbrojtje të planetit-Tokë nga gazrat e serës.

1.6. Përmirësim i gjendjes së personave socialisht të rrezikuar

Ligji për mbrojtje sociale³² parasheh që në realizimin e të drejtës së ndihmës sociale në para, secila njësi e vetëqeverisjes lokale të ketë mundësi që të angazhojë shfrytëzues të aftë për punë për kryerjen e punëve sezonale ose të përkohshme të interesit publik. Komuna e Shtipit deri tani përmes programit qeveritar për kryerjen e punëve publike, kryesisht në sferën komunale ka angazhuar 50 persona, marrës të ndihmës sociale. Ky aktivitet është realizuar vetëm në vitin 2009 dhe Komuna ka marrë pjesë financiarisht me një shumë prej 2.298.920 denarë nga gjithsej 4.578.920 denarë.

1.7. Investime kapitale dhe infrastrukturë në sferën e mbrojtjes sociale

Komuna e Shtipit hyri në fazën e dytë të decentralizimit, gjegjësisht në decentralizimin fiskal në vitin 2007. Si e tillë, komuna e Shtipit në sferën e mbrojtjes sociale, përpos objekteve të cilat i ka trashëguar me procesin e decentralizimit, ka kontribuar në ndërtimin e objekteve të reja.

Gjegjësisht, Komuna **ka shtëpi pensionerësh**, e cila i takon shoqatës së pensionerëve nga Shtipi. Në të ka 12 krevatë, të rregulluar si garsonjera të cilat nuk i përmbushin kapacitetet në masë të mjaftueshme. **Komuna nuk ka shtëpi për persona të moshuar.**

Komuna **ka qendër ditore për persona me pengesa në zhvillim**. Në Komunë, gjegjësisht në shkollën fillore **ka paralele për fëmijët me autizëm**. **Nuk ka qendër ditore për fëmijët në rrugë**, thjeshtë për shkak se numri i këtyre fëmijëve është më i vogël se 10.

Në Komunë është hapur qendër, ku shfrytëzuesit e drogës e marrin terapinë e tyre dhe një herë në javë bisedojnë me psikolog.

Gjatë muajit nëntor është filluar ndërtimi i terrenit sportiv për fëmijë në lagjen "Senjak". Ky aktivitet është pjesë e Planit lokal veprues për të drejtat fëmimore, si pjesë e iniciativës për ndërtim të terreneve sportive për fëmijë në qytet dhe vendet rurale.

³² Neni 55 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta zyrtare e R.M. nr. 79/2009.

Gjithashtu, në muajin tetor është vendosur gurrëthemeli për ndërtimin e dy klasave shtesë në objektin e çerdhes. Ky aktivitet është pjesë e Planit lokal veprues për të drejtat femënore, si pjesë e iniciativave për rritjen e kapacitetit ambiental të IPFA "Astibo", objekti Sonçogledi në lagjen "Senjak".

Në fund Komuna ka bërë aktivitete përgatitëse për ndërtimin e 6 klasave dhe një sallë sportive në shkollën fillore "Dimitar Vllahov", shkolla territoriale "Babi". Ky aktivitet është pjesë e Planit lokal veprues për të drejtat femënore si pjesë e iniciativës për përmirësimin e kushteve në shkollat fillore dhe të mesme në Komunë.

2. Qendra për punë sociale – Shtip

Qendra për punë sociale – Shtip (në tekstin e mëtutjeshëm QPS) shërben dy komuna, gjegjësisht rreth 56.000 qytetarë.

– Intervista u realizua me Znj. Natalija Panova, drejtoreshë e Qendrës për punë sociale në Shtip.

2.1. Identifikimi i grupeve të varfëra dhe të prekshme

Sipas të dhënave me të cilat disponon QPS – Shtip, kategoria më e prekshme e përfaqësuar janë **romët**. Ato janë më të përfaqësuar mes shfrytëzuesve të të gjitha të dhënave në para. Tek popullata rome ekzistojnë ende bashkësitë jashtë-martesorë të të miturve. Në QPS më së shpeshti paraqiten si klientë pas ndërprerjes së bashkësisë jashtë-martesorë, ndryshim të partnerëve bashkëshortorë dhe fitimin e kujdestarisë së fëmijëve të mitur.

Fëmijët shumë shpesh paraqiten si kategori e prekshme gjatë divorceve, takime me prindërin me të cilin nuk jetojnë dhe fëmijë të cilët nuk janë të regjistruar në institucionet kompetente. Sa u takon takimeve, nëse bëhet fjalë për prind, ku marrëdhëniet prind-fëmijë janë të mira, problemi paraqitet lidhur me kohën e kufizuar të takimit. QPS më së shpeshti i përcakton takimet, ku gjatë secilës jave të dytë pason fundjava (fëmija flen tek prindëri me të cilin nuk jeton). Gjatë fundjavës fëmija vetëm një ose dy ditë qëndron tek prindi dhe secilën javë të dytë, gjatë ditëve të punës përcaktohen disa orë pasdite. Për një muaj këto janë katër ditë e gjysëm. Në Republikën e Maqedonisë nuk praktikohet kujdestaria e përbashkët. Përdoret vetëm kur bashkëshortët kanë kontratë të ndërmjetëshme. Në rastet tjera më së shpeshti përdoret shembulli i cekur i takimeve, për të cilin mund të thuhet se nuk është i përshtatshëm për nevojat e fëmijëve nga aspekti i kohës së kufizuar dhe minimale për tu parë me prindërin me të cilin nuk jetojnë. Fëmijëve, të cilët nuk janë të regjistruar në institucionet kompetente, ju janë thyer të drejtat themelore njerëzore nga mbrojtja shëndetësore, arsimi dhe të drejtat nga mbrojtja sociale. QPS çdo ditë ballafaqohet me vështirësi në përcaktimin e identitetit të kësaj kategorie të fëmijëve

Gratë shumë rralë paraqiten në kategorinë e prekshme të grave viktime të dhunës familjare. Shkaku se përse gratë mbesin të jetojnë edhe tutje me dhunuesin është pasiguria e tyre ekonomike dhe banuese.

Personat e moshuar si një kategori e prekshme gjenden më së shumti në vendet rurale ku jetojnë vetë. Një numër i madh i personave të moshuar nuk janë socialisht të siguruar për shkak të pamundësisë për ta siguruar dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e të drejtave të tyre në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale.

Nga **pakicat**, më të përfaqësuar janë jurukët të cilët janë të bashkësisë etnike turke dhe gjenden si një **popullatë e vjetër** e cila jeton në vendet malore vetëm në Komunën e Shtipit dhe Komunën e Radovishit. Ato nuk e flasin gjuhën maqedonase dhe sa i takon punës janë marrë me blegtori. Mesatarisht sipas moshës, këto persona të moshuar janë mbi 70 vjeç dhe nuk janë të aftë për punë. Fëmijët e tyre janë shpërngulur shumë më herët dhe i kanë lënë që të jetojnë vetë. Për shkak të jetës së izoluar dhe mungesës së informatave, personat e moshuar nga kjo bashkësi etnike turke nuk mund ti realizojnë të drejtat nga mbrojtja sociale.

Personat me nevoja të posaçme dhe kufizim fizik gjenden si kategori e prekshme. Kapaciteti i qendrës është për 25 persona, ndërsa në moment përfshihen 14 fëmijë. Si problem paraqitet moshja e tyre për shkak se sipas moshës ato kanë edhe nevoja dhe interesa të posaçme. Në qendrën ditore nuk ka hapsirë të mjaftueshme për tu formuar dy grupe fëmijësh sipas moshës së tyre dhe për këtë shkak momentalisht kapaciteti i qendrës nuk është i përmbushur në plotësi.

Në Komunën e Shtipit nuk ka shitore sociale. Ka një kuzhinë popullore me kapacitet prej 85 ushqimesh. Numri është i kufizuar dhe të gjithë shfrytëzuesit e ndihmës sociale nuk kanë mundësi që ta shfrytëzojnë këtë shërbim. Për bashkëshfrytëzuesit (anëtarët e familjes së bartësit të ndonjë lloji të ndihmës sociale) nuk sigurohet ushqim. Në këtë aspekt shfrytëzuesit janë të diskriminuar. Shërbimin e njejtë nuk mund ta përdorin klientët të cilët jetojnë në komunat rurale. Ushqimi shërbehet në tre çerdhe në Komunën e Shtipit.

QPS – Shtip nuk ka mekanizma të posaçme për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme.

Identifikimin e bëjnë në nivel individual gjatë regjistrimit të qytetarëve ose me paraqitje nga institucionet.

2.2. Shërbimet dhe qasja në shërbime tek Qendra për punë sociale

Shërbimet të cilat i ofron QPS në Komunën e Shtipit janë në pajtim me Ligjin për mbrojtje sociale dhe Ligjin për familje.

QPS ka vështirësi në sigurimin e diskrecionit për secilin klient. Si shkak ceket mungesa e hapsirës. Mjetet nga ndihmat në para nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale të një personi. Shuma e ndihmave në para çdoherë duhet të jetë sipas shportës shpenzuese dhe shpenzimet tjera të regjisë së një familjeje.

Shfrytëzuesit e ndihmave në para ballafaqohen me probleme gjatë sigurimit të dokumentacionit të nevojshëm. Për një pjesë të dokumenteve klientët duhet të paguajë një shumë të caktuar të parave. QPS me detyrë zyrtare drejtohet tek institucionet kompetente për një pjesë të dokumenteve të cilat klientët nuk kanë mundësi që ti sigurojnë. Një numër i madh i klientëve janë të paarsimuar, nuk kanë dokumente personale për identifikim, gjë e cila paraqet problem shtesë për qasjen në të drejtat e mbrojtjes sociale.

Sa u takon ndihmave në para, shfrytëzuesit të cilët janë të aftë për punë janë në numër më të madh se sa shfrytëzuesit me aftësi punë të pjesërisht ose krejtësisht të paaftë. Numri më i madh i shfrytëzuesve janë klientët e ndihmës sociale në para dhe sipas drejtoreshës së QPS – Shtip kjo kategori e klientëve të cilët janë të aftë për punë duhet të shërbehen vetëm nga Agjencia për punësim.

Në këtë mënyrë QPS do të ketë më shumë mundësi për ta kryer punën profesionale në pajtim me mandatin e saj.

Kërkuesit e ndihmës në para diskriminohen nga kushtet të cilat kërkojnë kufizimin e të ardhurave në familje. Shuma e mjeteve nga të gjitha ndihmat në para është minimale dhe nuk i përmbush nevojat kyresore ekzistenciale të një personi. Kërkuesve së të drejtave nga sfera e mbrojtjes sociale (siqë është shembulli për kujdesin nga personi i huaj), duhet t'ju mundësohet që ti shfrytëzojnë këto të drejta vetëm sipas sëmundjes dhe paaftësisë së tyre për punë.

QPS – Shtip nuk disponon me numër të mjaftueshëm të personelit profesional dhe teknik. Kanë nevojë për veturë terrenike, të aftësuar për vendet malore, të cilat janë më të vështira për tu qasur. QPS ka nevojë për një shërbim për përzgjedhjen e lëndëve. Personat e këtij shërbimi do të jenë përgjegjës për përzgjedhjen dhe grupimin e të gjitha lëndëve dhe pastaj të njejtat do t'jua dorëzojnë personave profesional.

Gjithashtu, është i nevojshëm riadaptimi i të gjithë hapsirës së QPS për shkak se kanë mungesë të zyrave, sallë për këshillime grupore, sallë të përshtatshme për pritje dhe ambiente të tjera me të cilat do të sigurohen kushte të përshtatshme për punë me të gjitha kategoritë e qytetarëve.

Duhet të zhvillohen programe për punësimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme nga ana e Ministrisë për punë dhe politikë sociale në bashkëpunim me agjencitë për punësim.

Duhet të hapen më tepër qendra ditore të cilat do ti përfshijnë të gjitha kategoritë e qytetarëve.

QPS nuk ka njësi të shpërndara në komunat rurale.

2.3. Preventiva dhe përkrahja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS – Shtip nuk ka kushte të krijuara për zbatimin e preventivës sociale.

QPS – Shtip nuk ka mekanizma dhe procedura të posaçme për mbrojtjen dhe përkrahjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme.

Qytetarët e Komunës së Shtipit përmes drejtimit të drejtëpërdrejtë në QPS informohen për të drejtat e tyre nga sfera e mbrojtjes sociale dhe të gjitha të drejtat sipas mandatit të QPS.

2.4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS – Shtip nuk ka program as mekanizma të përcaktuar për konsultim me qytetarët Komunës së Shtipit. Konsultimin e bëjnë në hapsirat e QPS dhe gjatë kontrollës së drejtëpërdrejtë në terren.

2.5. Bashkëpunimi i Qendrës për punë sociale me vetëqeverisjen lokale

QPS – Shtip ka bashkëpunim të mirë me vetëqeverisjen lokale të Komunës së Shtipit. Bashkëpunimi ndodh përmes krijimit të trupave koordinues për klientët të cilët paraqiten në QPS, vetëqeverisjen lokale dhe në institucionet tjera të Komunës së Shtipit.

Gjithashtu, QPS dorëzon listat e klientëve tek vetqeverisja lokale, klientë të cilët më vonë angazhohen në punë në Sekcionin komunal për një periudhë të caktuar kohore. Gjatë angazhimit në punë klientët nuk marrin ndihmë në para dhe e njejta aktivizohet menjëherë pas ndërprerjes së angazhimit në punë. Për shkak të kufizimit të angazhimit në punë, klientët heqin dorë nga ky shërbim dhe e drejta e ndihmës në para nga ana e QPS ju ndërprehet për një periudhë gjashtë mujore.

QPS ka ngritur iniciativë për hapjen e njësisë qarkore në Komunën rurale të Karbincit.

QPS – Shtip bashkëpunon me Ministrinë për punë dhe politikë sociale. Financat paraqesin problem për funksionimin e përshtatshëm të QPS dhe në veçanti ceken mjetet minimale të ndihmave në para të dedikuara për grupet e varfëra dhe të prekshme.

Shfrytëzuesit e ndihmave në para edhe përpos të qenit të mbrojtur me të drejtat nga sfera e mbrojtjes sociale ende gjenden në gjendje të rrezikut social.

QPS – Shtip si me institucionet tjera, bashkëpunon edhe me Agjencinë për punësim. Bashkëpunimi zhvillohet vazhdimisht përmes shkëmbimit të informatave për klientët të cilët shërbehen nga këto dy institucione. Agjencia për punësim nuk mundëson punësim për shfrytëzuesit e të drejtave nga sfera e mbrojtjes sociale.

QPS ka bashkëpunim të mirë me shoqatat qytetare në Komunën e Shtipit. Kanë bashkëpunim të mirë me shoqatat qytetare rome, shoqatën qytetare Eho, shoqatën qytetare Energija, Klubin e të rinjve dhe shoqata të tjera qytetare. Shoqatat rome ju ofrojnë shërbime romëve për sigurimin e dokumentacionit personal dhe dokumentacion të llojit tjetër. QPS e vlerëson si pozitive eksperiencën nga bashkëpunimi me sektorin qytetarë.

QPS – Shtip nuk ka bashkëpunim të vazhdueshëm me sektorin e biznesit privat. Gjatë disa aktiviteteve, Ministria për punë dhe politikë sociale, biznes sektorit i ofron një lloj të caktuar të beneficioneve për punësimin e një kategorie të caktuar të shfrytëzuesve të ndihmave të QPS. Për këtë qëllim sektori i biznesit shpesh herë është drejtuar tek QPS për të kërkuar listë për ndonjë kategori të caktuar të qytetarëve.

3. Të dhëna nga fokus grupet e organizuara

Gjendja e grupeve të prekshme dhe të varfëra në Komunën e Shtipit u verifikua me intervistimin e dy fokus grupeve. Njëri fokus grup përbëheshte prej grave maqedonase dhe rome, ndërsa tjetri përbëheshte prej burrave maqedonas dhe rom.

3.1. Persona të moshuar

Personat e moshuar në Komunën e Shtipit janë mjaft të përfaqësuar. Ato janë në një gjendje të pafavorshme për shkak të shumës së vogël të pensionit me të cilën nuk mund ti përmbushin nevojat e tyre kryesore ekzistenciale.

Në Komunën e Shtipit, mbisundon papunësia, për shkak të cilës personat e moshuar jetojnë në familje me më shumë gjenerata, ku jo edhe shumë rrallë pensioni edhe përpos të qenit minimal është e ardhur e vetme për të gjithë anëtarët e familjes.

Gjithashtu, u cek se personat e moshuar shfrytëzohen ekonomikisht nga familjarët e tyre të afërt dhe po ato të njejtit nuk kujdesen për ta. Në disa raste ka edhe dhunë familjare mbi personat e moshuar.

Si problem tjetër me të cilin ballafaqohen personat e moshuar në Komunën e Shtipit është paqasëshmëria e shtëpive për persona të moshuar. Nga njëra anë, numri i vendeve në këto shtëpi është i kufizuar, ndërsa nga ana tjetër financiarisht nuk janë në gjendje për ta shfrytëzuar këtë shërbim, as po familjarët e tyre të afërt nuk kanë mundësi që të kontribuojnë për strehimin e personit të moshuar në shtëpi për persona të moshuar.

Personat e moshuar kanë kushte të mira jetese, mirëpo ka edhe përjashtime të personave të moshuar të cilët jetojnë në kushte të këqia banuese.

Në shtëpitë për persona të moshuar kushtet janë të mira. Në institucionet shëndetësore publike kushtet janë nën të gjitha standardet. Nuk ruhet higjiena, inventari është i vjetëruar dhe më i vjetër se më tepër dekada, teknika medicinale dhe paisjet janë të vjetruara ose aspak nuk janë ekzistuese, krevatët dhe mbulesat janë në një gjendje të keqe. Ndërtesat nuk janë renovuar nga vetë fillimi i përdorimit të tyre.

Personat e moshuar për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore dhe për barnat paguajnë një shumë të caktuar për participim. Për një përqindje të vogël të barnave paguajnë një shumë të caktuar për participim ndërsa për përqindjen më të madhe të barnave e paguajnë shumën e plotë.

Ndihma e shpejtë vonohet për të intervenuar tek personat e moshuar, ndërsa ka edhe raste kur aspak nuk ka interevenuar. Personat e moshuar kanë nevojë për terapi fizikale, mirëpo për shkak të gjendjes së keqe financiare nuk mund ti shërbejnë këto shërbime.

Procedura për realizimin e të drejtave nga sfera e mbrojtjes sociale është e gjatë. Vetëm për lloje të caktuara të diagnozave mbrojtja sociale është e qasëshme, ndërsa për llojet e tjera të diagnozave personat e moshuar nuk mund ti realizojnë të drejtat nga sfera e mbrojtjes sociale.

3.2. Gra

Si një kategori veçanërisht e prekshme janë gratë-viktima të dhunës familjare.

Kushtet për jetesë të grave janë relativisht të mira.

Gratë më së shpeshti janë të punësuar në fabrikat e konfekcionit, përderisa në administratë dhe në institucionet tjera shtetërore punësimi është politikisht i përcaktuar. Gratë mbi 35 vjeç, diskriminohen në tregun e punës për shkak të moshës. Fabrikat e konfekcionit nuk i respektojnë të drejtat nga Ligji për marrëdhënie pune, ku nuk ka orar të përcaktuar pune, punohet tejararit dhe gratë nuk paguhen për orët e punuara shtesë, ndërsa rroga është minimale. Shpesh gratë keqpërdoren si fuqi e lirë pinuese dhe janë viktima të mobingut nga ana e punëdhënësve të tyre. Në sektorin e biznesit privat mbisundon korrupcioni.

Tek gratë vetëdija për mbrojtjen e rregullt shëndetësore është e zhvilluar në një nivel të kënaqshëm.

Qendra për punë sociale nuk ofron ndihmë adekuate për gratë-viktima të çdo lloji të dhunës. Gratë-viktima të dhunës familjare nuk janë të kënaqura me veprimi i

QPS dhe MPB lidhur me mbrojtjen e tyre. MPB rastin e regjistron si ankesë, ndërsa QPS rastin e regjistron si marrëdhënie të prishura bashkëshortore.

Dhuna psiqike nuk sanksionohet nga këto dy institucione. Gratë-viktima të dhunës familjare nuk kanë siguri ekonomike që paraqet një arsye të madhe për mosparaqitjen e dhunës familjare në institucionet kompetente.

3.3. Fëmijë

Varfëria ceket si shkak për paraqitjen e fëmijëve si një kategori e prekshme në këtë Komunë.

Në komunën e Shtipit ka dukuri të keqpërdorimit të fëmijëve nga ana e prindërve të cilët i detyrojnë që të lypin. Mjetet financiare të cilat fëmijët i fitojnë nga lëmosha, jua japin prindërve të tyre. Ka raste shumë të shpeshta, kur babai mjetet financiare i përdor për blerjen e alkoolit, ndërsa fëmijët ende mbesin të paushqyer dhe të paveshur. Vazhdimisht e më tepër rritet numri i fëmijëve që lypin, ndërsa saqë vjen më shumë ka fëmijë me nevoja të posaçme të cilët lypin. Në karrocë invalidësh i vendosin përpara objekteve hotelierike dhe ato janë të detyruar që të lypin.

Si shembull tjetër ceken fëmijët të cilët punojnë punë fizike me prindërit e tyre, me çfarë familja siguron mjete minimale për tu ushqyer.

Gjatë diskutimit u cek se rritet pedofilia, delikuenca juvenile dhe prostitucioni mes të miturve. Për shkak të vlerave patriarkale këto raste shumë rrallë paraqiten tek institucionet relevante.

Qendra për punë sociale mban kujdes për fëmijët pa prindër dhe kujdes prindëror. Pas braktisjes së institucionit, Qendra për punë sociale inicon bashkëpunim me më tepër institucione, duke e përfshirë edhe Agjencinë për punësim dhe vetëqeverisjen lokale për punësimin e kësaj kategorie të fëmijëve. Pjesëmarrësit ceken se kjo është një eksperiencë pozitive e bashkëpunimit.

Si problem i madh mbetet sigurimi i banimit për këtë kategori të fëmijëve.

Fëmijët diskriminohen për shkak të pamundësisë që të gjithë ta shfrytëzojnë shtesën fëminore. Si kusht për fitimin e të drejtës së shtesës fëminore janë vendosur kushte lidhur me kufizimin e të ardhurave sipas anëtarit në një familje dhe punësim i më së paku njërit të prindërve. Fëmijët, prindërit e të cilëve janë të papunësuar nuk kanë të drejtë që ta shfrytëzojnë shtesën fëminore. Shuma e shtesës fëminore është minimale dhe nuk i plotëson nevojat kryesore për ekzistencë të fëmijut.

Fëmijëve me nevoja të posaçme ju sigurohen kushte të përshtatshme për ndjekje të mësimin në shkollë.

3.4. Persona me nevoja të posaçme

Në Komunën e Shtipit personat me nevoja të posaçme nuk kanë socializim adekuat. Për këtë qëllim është e nevojshme që të hapet qendër ditore për personat me nevoja të posaçme në moshë mbi 26 vjeç.

Sektori privat e keqpërdor këtë kategori të njerëzve. Atyre nuk ju mundësohen kushte të përshtatshme për punë dhe ju jep rroga minimale.

Të drejtat të cilat ju takojnë nga sfera e mbrojtjes sociale janë kufizuese sa u takon të ardhurave. Gjithashtu, mjetet nga ndihma sociale janë minimale dhe nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale të personave me nevoja të posaçme.

3.5. Rom

Romët janë kategoria me e prekshme e qytetarëve në Komunën e Shtipit. Romët kanë shkallë të ulët të arsimit dhe kjo është problem për punësimin e tyre.

Ato jetojnë në objekte të palegalizuara. Një numër i madh i fëmijëve rom nuk janë të vaksinuar as po të regjistruar në institucionet kompetente. Sipas traditës së popullatës rome ende janë prezente martesat e të miturve. Fëmijët më së shpeshti hynë në bashkësi jashtë-martesore në moshë 12 deri më 15 vjeçare.

3.6. Pakica

Në Komunën e Shtipit ka më tepër pakica edhe atë romë, turqë, vlllehë, boshnjakë, serbë, kroatë dhe pakica të tjera. Problemi më i madh për të gjithë qytetarët e Shtipit është papunësia, kështu që edhe për pakicat ky është problemi më i kryesor të cilin ballafaqohen. Pjesa më e madhe romëve deklarohen si turqë.

Si një bashkësi e margjinalizuar u cek bashkësia e jurukëve e cila jeton në viset malore. Arsimi paraqet një problem serioz për këtë bashkësi.

DH. Komuna e Prilepit

1. Njësia e vetëqeverisjes lokale – intervista u zbatua me Z. Marjan Prodanoski, udhëheqës i Seksionit për çështje juridike në Komunën e Prilepit.

1.1. Mekanizma institucionale për mbrojtje sociale në Komunën e Prilepit

Në Komunën e Prilepit ka **Sektor për punë të përgjithshme dhe juridike**. Në këtë sektor ka **Seksion për punë publike** me të cilën udhëheq udhëheqësi i cili punon me çështjet e ndërlidhur me mbrojtjen sociale, mbrojtjen fëmimore, kulturë, arsim, sport dhe të ngjajshme.

Në suazat e Këshillit të Komunës së Prilepit ka komision të përsershëm për punë shoqërore dhe të drejtat fëmimore, nën kompetencat e të cilit bien edhe çështjet e mbrojtjes sociale. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve të Këshillit të Komunës së Prilepit. Sa u takon seancave, komisioni udhëhiqet sipas programit të punës së Këshillit ose në varësi nga rastet ose nevoja për zgjidhjen e disa çështjeve të caktuara. Nëse ka ndonjë pikë në agjendën ditore të seancës së Këshillit, komisioni domosdoshëm takohen.

1.2. Programe dhe plane vepruese nga sfera e mbrojtjes sociale duke përfshirë edhe programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve

Në Komunën e Prilepit **nuk ka program për mbrojtje sociale dhe sipas kësaj as plan veprues për mbrojtje sociale**.

Sa u takon planeve lokale vepruese të përgatitura dhe të miratuara, Komuna e Prilepit ka 3 plane kyçe edhe atë:

- Plan lokal veprues për punësim 2009-2010;
- Plan lokal veprues për të drejtat fëmimore 2009-2013;
- Plan lokal për çështjet e personave me hendikep 2008 - 2010.

Plani veprues lokal për të drejtat fëmimore për periudhën 2009-2013 është përgatitur në janar të 2009. Plani është përgatitur nga Komisioni për punë shoqërore dhe të drejtat fëmimore, në suazat e Këshillit të Komunës së Prilepit me përkrahje të UNICEF, Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe BNJVL. Krijimi i planit lokal është një nga aktivitetet e projektit "Përkrahja e decentralizimit nga perspektiva e të drejtave fëmimore" e Qendrës për të drejta fëmimore dhe zgjidhjen e konflikteve, i cili plan duhet të zbatohet përmes Komisionit për punë shoqërore dhe të drejta fëmimore në suazat e Këshillit të Komunës së Prilepit.

Ky komision pas përcaktimit të kriterëve në bazë të cilave më vonë janë krijuar qëllimet strategjike (përfshirja kuantitative, marginalizimi, urgjenca, realizueshmëria dhe mundësia për përkrahje nga bashkësia), ka përcaktuar tre sfera prioritare edhe atë:

- 1.Përfshirje;
- 2.Shëndet më të mirë për të gjithë fëmijët;
- 3.Mbrojtje të fëmijëve nga keqpërdorimi, lënia pas dore, shfrytëzimi dhe dhuna.

Në përgatitje e planit lokal veprues janë përfshirë palë relevante nga niveli lokal (organizata joqeveritare, përfaqësues të administratës komunale, këshilltarë nga Këshilli i Komunës së Prilepit, Qendra për punë sociale etj.).

Për zbatimin e suksesshëm dhe ndjekjen e aktiviteteve të realizuara, përgjegjës duhet të jetë trupi koordinues i përbërë nga institucionet dhe organizatat e lartpërmendura, si dhe komisioni për punë shoqërore dhe të drejta femërore i Këshillit të Komunës së Prilepit.

Plani veprues është konceptuar me kornizë kohore për realizimin e aktiviteteve, institucione përgjegjëse për zbatim, burime të mjeteve financiare si dhe mënyra të ndjekjes së zbatimit.

Megjithatë, **brengos fakti që korniza kohore nuk është konceptuar në mënyrë adekuate**, për shkak se e njëjta është planifikuar indikativisht, gjegjësisht pjesa më e madhe e aktiviteteve janë planifikuar në kontinuitet për periudhën 2009-2013; pa kornizë të përshtatshme mujore dhe vjetore për realizimin e aktiviteteve si dhe **pa buxhet të hollësishëm**, krijohet zbrastirë dhe pamundësohet vëzhgimi adekuat i aktiviteteve të realizuara.

Ne u drejtuam në Komunën e Prilepit lidhur me sigurimin e informatave për aktivitetet e realizuara nga plani dhe **nuk morrëm informata për realizimin eventual të tyre**. Prej atje na thanë se një pjesë e madhe e aktiviteteve të planifikuara janë paramenduar që të zhvillohen në kontinuitet gjatë periudhës pesë vjeçare të zbatimit dhe se në plotësim është krijuar listë me tregues për ndjekjen e situatës, të cilët tregues do të përfshihen edhe në një bazë të dhënash të posaçme, të cilën Komuna e ka fituar nga UNICEF – MAKINFO, në të cilën secilin vit do të futen tregues për tu bërë krahasim vjetore.

Në planin veprues, gjithashtu ka edhe aktivitete të cilat janë të planifikuara për tu zbatuar në periudhën 2009-2010, për të cilat përsëri nuk janë dhënë të dhëna nga Komuna. Në këtë mënyrë mungon mekanizmi i përcaktuar për vëzhgimin e rregullt në nivel vjetor si dhe tregues të përcaktuar në nivel vjetor.

Në fazën përmbyllëse është Plani veprues për punësim të romëve në Komunën e Prilepit.

Në komunë **ka bashkëpunim ndër-sektoral për krijimin e planeve dhe propozimeve** me komisionet dhe sektoret e tjera për çështje të kësaj sfere (për shembull me komisionin për mundësi të barabarta mes burrave dhe grave etj.).

Sa u takon krijimit të programeve, shumë shpesh të punësuarit në administratën shtetërore përgatisin plan rreth disa çështjeve të caktuara dhe japin iniciativë të cilat më vonë vetë këshilltarët i shqyrtojnë në komisionin adekuat.

Komuna e Prilepit **asnjëherë nuk ka miratuar as po ka propozuar programe zhvillimore për nevojat specifike të qytetarëve** të cilët jetojnë në territorin e saj.

1.3. Mekanizma për konsultim dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal dhe kombëtar dhe bashkëpunimi me institucioneve relevante nga sfera e mbrojtjes sociale dhe shoqatat qytetare

Në Komunën e Prilepit të gjitha vendimet e Këshillit të Komunës shpallen në Gazetën zyrtare, ndërsa ekziston edhe gazetë në formë elektronike. Qytetarët informatat i marrin edhe përmes ueb faqes. Bashkëpunimi realizohet me së shpeshti me bashkësitë lokale, gjegjësisht urbane ose me organizatat joqeveritare.

Nga **sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale deri tani është bashkëpunuar me organizatat joqeveritare** vetëm në raste kur ato drejtohen në komunë duke kërkuar bashkëpunim për ndonjë projekt të caktuar. Në varësit të projektit ose aktivitetit i cili duhet të zbatohet, të punësuarve me kualifikime të përshtatshme në pajtim me sferën me të cilën punohet ju përcaktohen detyrat. Iniciativa për bashkëpunim do të thotë atëherë vetëm kur organizatat joqeveritare kanë aplikuar me projekt me të cilin e përfshijnë komunën ose e kundërta.

Me qendrat për punë sociale ka bashkëpunim në një masë të caktuar, konkretisht në krijimin e planit lokal veprues për të drejta fëmijore ose nëse komuna ka nevojë për informata lidhur me personat të cilët marrin ndihmë sociale.

Sidoqoftë, **nuk ka mekanizma të përcaktuar për konsultime dhe pjesëmarrje të grupeve të varfëra dhe të prekshme në nivel lokal.**

Si përmbledhje mund të themi se i tërë komunikimi zhvillohet përmes lidhjes së drejtëpërdrejtë në kërkesë të qytetarëve, të cilët kryesisht kanë nevojë për ndihmë financiare, kërkesa e të cilëve dorëzohet në komisionin për financa dhe buxhet, ku edhe e njejta miratohet ose rrefuzohet. Përfaqësuesi i intervistuar i komunës është i mendimit se këto mjete financiare, të cilat jepen si ndihmë e njëhershme në para, duhet të transferohen në Qendrën për punë sociale, që ato ta analizojnë kërkesën dhe të vendosin për miratimin e ndihmës.

1.4. Mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme

Në Komunën e Prilepit nuk bëhet vlerësim i nevojave të grupeve të varfëra dhe të prekshme. **Nuk ka bazë të dhënash për çështjet e ndërlidhura me mbrojtjen dhe përfshirjen sociale.** Nuk ka klasifikim të dhënash sipas kategorive, as po grupeve synuese. **Nuk ka kurrëfar mekanizmi për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme.** Informatat për listën e personave të cilët marrin ndihmë sociale merren vetëm nga Qendra për punë sociale. Komunikimi në këtë aspekt bëhet vetëm nëse vjen kërkesë nga ana e qytetarëve për sigurimin e ndihmës ose për konsultim. Qytetarët të cilët kanë ndonjë problem të caktuar drejtohen me kërkesë tek Këshilli ose tek kryetari. Sipas përfaqësuesit të intervistuar të komunës *"këto punë duhet të kryhen vetëm nga Qendra për punë sociale për shkak se komuna nuk është qendër"*.

1.5. Sigurimi i shërbimeve sociale nga ana e njësisive të vetëqeverisjes lokale dhe aktivitetet projektuese/programike të realizuara nga sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale

Komuna e Prilepit ndan mjete financiare për mbrojtje sociale nga alinea buxhetore për rezerva vijuese. Për vitin 2009, janë ndarë gjithsej 600.000 denarë

nga pushteti lokal edhe atë 100.000 denarë për ushqim të fëmijëve me nevoja të posaçme dhe 500.000 denarë për kompenzime sociale në kërkesë të qytetarëve.

Komuna deri tani ka aplikuar për projekte nga sfera e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. Në bashkëpunim me organizatën joqeveritare italiane INTERSOS, më tej edhe me COSVI (organizatë joqeveritare italiane), Komuna e ka realizuar dhe përkrahur projektin Qendra multikulturore në lagjen Trizlla (kryesisht e banuar nga popullata rome). Projekti ka për qëllim përmirësimin e kualitetit të jetesës së romëve dhe përmirësim të marrëdhënieve mes bashkësive prezente në Prilep, favorizim të proceseve për integrim, dialog mes bashkësive të ndryshme përmes integritit socio-ekonomik dhe komponentës arsimore.

Komuna në bashkëpunim me Ministrinë për punë dhe politikë sociale dhe Qendrën për punë sociale – Prilep e përkrah qendrën ditore për personat me nevoja të posaçme.

Në bashkëpunim me Ministrinë për punë dhe politikë sociale realizohet projekti "Kuzhina popullore". Komuna nga Qendra për punë sociale merr listë për marrësit e ndihmës sociale dhe siguron vend për ngrënie në shtëpinë për personat e moshuar "Kiro Krsteski Platnik". **100 qytetarë e shfrytëzojnë këtë shërbim në "kuzhinën popullore".**

Në vitin 2007, Komuna e Prilepit është shpallur si komuna më e qasëshme dhe ka fituar çmim nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Maqedoni dhe OJQ "Polioplus". Është realizuar vendosja e trapeve të qasëshme në shkolla dhe ndërtesën komunale, është bërë përshtatja e kryqëzimeve dhe vendeve për parkim dhe është vendosur sinjalizim i zëshëm në komunikacion në disa udhëkrye më të frekuentuara.

1.6. Përmirësim i gjendjes së personave socialisht të rrezikuar

Ligji për mbrojtje sociale³³ parasheh që në realizimin e të drejtës së ndihmës sociale në para, secila njësi e vetëqeverisjes lokale të ketë mundësi që të angazhojë shfrytëzues të aftë për punë për kryerjen e punëve sezonale ose të përkohshme të interesit publik.

Komuna e Prilepit deri tani përmes masave aktive për punësim të qeverisë së R.M., përmes programit për punë publike, ka angazhuar 328 persona për kryerjen e punëve sezonale. Këto persona kanë marrë honorar për 6.300 denarë për zbatimin e punëve kryesisht të interesit komunal. Këto angazhime kanë zgjatur deri më 6 muaj dhe janë realizuar gjatë vitit 2009. Aktivitetet i tillë nuk është realizuar në vitin 2010.

Megjithatë, **Komuna nuk posedon plan strategjik për përmirësimin e gjendjes së personave socialisht të rrezikuar.** Aktivitetet janë projekte afat-shkrutëra, nga të cilat nuk mund të shihen rezultate konkrete në afat të mesëm dhe të gjatë, të cilat konkretisht kanë qenë të finacuara nga pushteti qendror.

1.7. Investime kapitale dhe infrastrukturë në sferën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale

Komuna e Prilepit hyri në fazën e dytë të decentralizimit, gjegjësisht në decentralizimin fiskal në vitin 2007. Si e tillë, Komuna përveç posedimit të objekteve të cilat i ka trashëguar me procesin e decentralizimit ose i ka ndërtuar,

³³ Neni 55 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 79/2009.

ka detyrë që të njejtat edhe ti financojë, të investojë në ta dhe ti mirëmbajë.³⁴ Në këtë drejtim Komuna e Prilepit në sferën e mbrojtjes sociale dhe arsimit ka investuar në infrastrukturë në rindërtimin e një sërë objektivash të shkollave fillore dhe të mesme.

Sa u takon investimeve kapitale në sferën sociale, Komuna e Prilepit në vitin 2008 ka investuar 600.000 denarë pjesëmarrje vetanake komunale për ndërtimin e lulishtes feminare.

Në SHF "Kire Gabriloski" në një sipërfaqe prej 900 m² janë ndërtuar klasa amfiteatrale për organizimin e ligjeratave në të hapur. Janë ndërtuar 6 klasa me kapacitet prej 186 karrikeve të betonit. Këtë aktivitetet Komuna e Prilepit e ka bërë në bashkëpunim me NP "Komunalec" nga Prilepi.

Në SHF "Rampo Levkata", Komuna ka investuar në rregullimin e sipërfaqes së oborrit me mjete financiare prej 62.000 denarë. Në shkollën e njejtë është vendosur video sistem i vëzhgimit në shumë prej 160.000 denarë, ndërsa për rindërtimin e xhevshtores, Komuna ka investura 1.000.000 denarë.

Në SHFS "Gjorge Petrov", Komuna ka investuar një shumë prej 5.000.000 denarë pjesëmarrje vetanake komunale për vendosjen e nxemjes me avull. Ky projekt është realizuar me përkrahje financiare nga Ministria për arsim dhe shkencë.

Në SHFS "Riste Risteski", Komuna në bashkëpunim me Ministrinë për arsim dhe shkencë ka investuar 3.000.000 denarë për vendosjen e sistemit të ri të nxemjes.

Është renovuar SHF "Dobre Jovanoski", e cila gjendet në lagjen Trizlla, në të cilën shumica e nxënësve janë të nacionalitetit rom, me çfarë janë siguruar kushte më të mira për mësimdhënie dhe integrim mes dy grupeve etnike. Komuna ka investuar në riparimin e dyshemeve, korridoreve, mureve dhe tavaneve, në shumë prej 900.000 denarë, ndërsa shumë tjetër e ka siguruar OJQ italiane COSVI.

Komuna **nuk ka shtëpi për persona të moshuar** ose po **persona të cilët janë të eksponuar në rrezik social**, as qendër ditore për fëmijët në rrugë.

2. Qendra për punë sociale - Prilep

Qendra për punë sociale – Prilep (në tekstin e mëtutjeshëm QPS) shërben tre komuna, me rreth 120.000 qytetarë.

– Intervista u realizua me Z. Zoran Mallkovski, punonjës social në Qendrën për punë sociale në Prilep.

2.1. Identifikimi i grupeve të varfëra dhe të prekshme

Në territorin e Komunës së Prilepit **fëmijët** janë kategori e prekshme më e përfaqësuar. Ato më së shpeshti paraqiten si kategori e prekshme gjatë proceseve të divorcit, anëshkalimit edukues nga prindërit e tyre, tregtisë me njerëz dhe delikuencës juvenile. Për rritjen e numrit të këtyre dukurive si tregues shërben numri i rritur i proceseve të anulimit të të drejtave prindërore të cilat janë inicuar nga QPS. Në QPS ka shërbim kujdestar 24 orë.

Si grup tjetër i prekshëm janë **gratë-viktima të dhunës familjare**. Në Komunën e Prilepit nuk ka strehimore për gratë-viktima të dhunës familjare. QPS ka

³⁴ Neni 22 nga Ligji për mbrojtje sociale, Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 5/2002.

bashkëpunim të mirë me gjyqin kompetent dhe institucionet publike për masa të përkohshme për mbrojtje. Megjithatë, sipas deklaratës së përfaqësuesit të QPS "Është sukses kur shohim 5 vendime gjyqësore për ndalim të shpallura nga gjyqi". Masat më të shpeshta për mbrojtje janë masat për mjekim të detyrueshëm.

Popullata rome gjendet si kategori e prekshme në komunën e Prilepit. Romët më së shpeshti janë të paarsimuar. Ato janë më të përfaqësuar mes shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para. Për realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale çdoherë dokumentacioni paraqitet si problem. Brengos fakti që edhe sot ende ka një pjesë të madhe të popullatës rome e cila nuk është e regjistruar në institucionet kompetente. Sa i takon kësaj dukurie theksi vendoset mbi fëmijët.

Më të përfaqësuar janë **pakicat** e kombësisë etnike shqiptare dhe boshnjake. Ato paraqiten si shfrytëzues të ndihmave në para.

Personat me nevoja të posaçme gjenden si kategori e prekshme dhe ato i shfrytëzojnë të drejtat nga mbrojtja sociale. Në QPS nuk ka qasje të përshtatur për personat me nevoja të posaçme, përveç asaj në katin e parë të ndërtesës.

Personat e moshuar janë më të përfaqësuar si shfrytëzues të ndihmës së përhershme në para në bazë të pleqërisë. QPS ju mundëson mbrojtje shëndetësore kësaj kategorie të personave. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare nga Ministria për punë dhe politikë sociale, kartonat e shëndetësisë për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale nga QPS arrijnë prej më 10 deri më 20 të muajit. Në këtë mënyrë shfrytëzuesve ju shkurtohet e drejta e mbrojtjes sociale, ndërsa shërbimet të cilat i shfrytëzojnë nga mbrojtja shëndetësore i participojnë në plotësi. Si kriter shtesë për shfrytëzimin e ndihmës së përhershme në para në bazë të pleqërisë vendoset numri i viteve të vjetërsisë në punë. Personat të cilët gjenden në gjendje të rrezikut social dhe kanë vjetërsi pune prej 6 viteve deri më 14 nuk mund ti realizojnë të drejtat nga ndihma e përhershme në para në bazë të pleqërisë dhe në bazë të sëmundjes. Personat e moshuar nëse duan që ta realizojnë të drejtën e ndihmës së përhershme në para në bazë të varfërisë nuk duhet të kenë vjetërsi pune më tepër se 5 vite. I njëjti kusht vlen edhe për ndihmën e përhershme në para e cila jepet në bazë të sëmundjes. Gjithashtu, si kusht vendosen edhe të ardhurat në familje të cilat kufizohen, gjë e cila paraqet një problem të madh që personat e moshuar ta shfrytëzojnë këtë të drejtë. Në këtë kontekst është edhe deklarata e përfaqësuesit të QPS: "*Kishte shumë lëndë të cilat për 100-200 denarë e humbin të drejtën e shfrytëzimit të ndihmave në para, ndërsa në një rast kjo ndodhi për 24 denarë*".

QPS – Prilep nuk ka mekanizma për identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme. Si shkak shtesë ceket mungesa e personelit profesional dhe puna e madhe administrative të cilën e bëjnë këto profesionistë.

Identifikimin e grupeve të varfëra dhe të prekshme e bëjnë përmes kontrollit të drejtëpërdrejtë në nivel individual.

2.2. Shërbimet dhe qasja në shërbime në Qendrën për punë sociale

QPS – Prilep i jep shërbimet në pajtim me ligjet dhe mandatin e saj.

Në Komunën e Prilepit numri i shfrytëzuesve i të gjitha ndihmave në para është rreth 6.639. Kërkuesit e ndihmave në para diskriminohen për shkak të kushtit i cili parasheh kufizim e të ardhurave. Nëse kërkuesit e ndihmë e tejkalojnë limitin

e paraparë të të hyrave në një familje, i cili është minimal dhe është 4.000 denarë për një anëtar, ato nuk mund ta realizojnë këtë të drejtë.

Kërkuesit e ndihmës së përhershme në para në bazë të sëmundjes dhe pleqërisë janë kategoritë më të prekshme të personave. Mjetet nga ndihma në para nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale për një

person. Është e nevojshme që secili rast individualisht të shqyrtohet dhe sipas shportës shpenzuese, shpenzimeve dhe nevojave të familjes, të përcaktohet shuma e ndihmave në para.

Në Komunën e Prilepit ka qendër ditore për fëmijët me nevoja të posaçme. Kapaciteti i qendrës është për 30 fëmijë. Në qendrën ditore fëmijëve ju mundësohet transport, ushqim dhe socializim. QPS deri tani ka eksperiencë pozitive nga puna e qendrës ditore.

Në këtë komunë nuk ka strehimore për viktimat e dhunës familjare. QPS ka ngritur iniciative deri tek Ministria për punë dhe politikë sociale, mirëpo për shkak të mungesës së mjeteve financiare ende nuk ka strehimore për gra – viktimat të dhunës familjare.

Sa u takon shërbimeve speciale urgjentisht duhet të hapet qendër ditore për konsumuesit e mjeteve narkotike. Të varurit janë në një gjendje tepër të vështirë, për shkak se nuk kanë qendër ku do të mund ta marrin terapinë metadonale. Për shkak të kësaj janë të detyruar që të udhëtojnë në Manastirë, me çfarë ekspozohen në shpenzime plotësuese financiare. Familjet nuk kanë mundësi që financiarisht ti përkrahin fëmijët e tyre për të udhëtuar në qytete tjera për këtë lloj të shërbimit. Ndihma në para për personat të cilët janë të varur nga mjetet narkotike nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale. Për shkak të parandalimit të mjekimit, personat e varur nga droga dhe substancat tjera psikotropike, vazhdojnë që ti shfrytëzojnë mjetet narkotike.

Në Komunën e Prilepit nuk ka strehimore për personat pa shtëpi. Kjo kategori e personave udhëzohen në strehimoren për persona të pashtëpi në Shkup.

Nga QPS është ngritur iniciativa për hapjen e qendrës ditore për fëmijët në rrugë.

Në Komunën e Prilepit nuk ka shitore sociale. Ka një kuzhinë popullore me kapacitet prej 100 ushqimeve. Në fillim shfrytëzues të këtij shërbimi kanë qenë vetëm shfrytëzuesit e ndihmës së përhershme në para, mirëpo më vonë janë përfshirë edhe shfrytëzuesit e ndihmës sociale në para. Numri i shfrytëzuesve është i kufizuar dhe ky shërbim nuk është i qasëshëm për klientët të cilët jetojnë në vendet rurale.

Në QPS – Prilep nuk ka kushte të përshtatshme ambientale për punë me klientë. Duhet të krijohet sportel dhe vend për pritje të përshtatshme. QPS nuk ka mundësi që të sigurojë diskrecion për të gjithë klientët. Në një zyrë janë të vendosur dy ose më tepër profesionistë, të cilët mund të shërbejnë nga dy ose më tepër klientë në të njëjtën kohë. Ndodh që klienti vetë të kërkojë diskrecion dhe në këtë rast personi profesional siguron zyrë të posaçme. Sipas deklaratës së përfaqësuesit të QPS: *"Ndodh që nëse klienti do që të bisedojë vetë të sigurojmë ambient ose po kolegu e liron zyrën. Me mundësitë të cilat i kemi përpiqemi që të sigurojmë diskrecion"*.

QPS – Prilep nuk ka njësi të shpërndara në komunat rurale. Është e nevojshme që shfrytëzuesit e ndihmave sociale në para të shërbehen nga agjencitë për

punësim. Deri tani shfrytëzuesit dy herë e vërtetojnë statusin e papunësisë, një herë në QPS dhe edhe një herë në Agjencinë për punësim.

QPS – Prilep ka nevojë për më tepër vetura për kryerjen e kontrollit. Duhet të hapen këshilltore dhe qendra ditore të cilat do të shërbejnë më tepër kategori të personave.

Punonjësit profesional nuk paguhen për punën jashtë orarit të punës dhe për shkak të kësaj nuk ka kushte për zhvillimin e terapisë grupore.

QPS ka nevojë që të angazhojë sigurim privat dhe të vendosi detektor për armë. Punonjësit profesional u janë shpesh të ekspozuar kërcnimeve, sjelljes agresive dhe të papëlqyeshme nga një pjesë e klientëve të pakënaqur.

2.3. Preventiva dhe përkrahja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS – Prilep nuk kryen preventivë sociale për shkak të mungesës së resurseve njerëzore dhe kushteve të përshtatshme për punë. Duhet të punësohen punonjës social në shkollat dhe firmat ku ka mbi 300 të punësuar. Për zbatimin e preventivës sociale duhet të krijohen kushte në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Në QPS duhet të hapet seksion i posaçëm për preventivë sociale.

QPS – Prilep nuk ka mekanizma dhe procedura të posaçme për mbrojtjen dhe përkrahjen e grupeve të varfëra dhe të prekshme.

QPS – Prilep i njofton qytetarët për të drejtat e tyre përmes mediave lokale, fletushkave dhe gjatë drejtimit të drejtëpërdrejtë të klientëve në qendër.

2.4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e grupeve të varfëra dhe të prekshme

QPS – Prilep nuk ka program as mekanizma të përcaktuar për konsultim me qytetarët Komunës së Prilepit.

2.5. Bashkëpunimi i Qendrës për punë sociale me vetëqeverisjen lokale

QPS – Prilep bashkëpunon me njësinë e vetëqeverisjes lokale. Familjet kur gjenden në rrezik social gjatë fatkeqësive elementare natyrore, vetëqeverisja lokale i ndihmon financiarisht me ndihmë të njëhershme në para.

Gjithashtu, paraqiten si donues të mjeteve financiare për qendrën ditore për fëmijët me nevoja të posaçme. QPS bashkëpunon me vetëqeverisjen lokale për angazhimin e përkohshëm në punë të shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para. Gjatë periudhës kohore që klienti është i angazhuar në punë, ndihma sociale në para pauzon dhe e njëjta aktivizohet pas mbarimit të angazhimit në punë. Një pjesë e shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para në këtë mënyrë janë punësuar në seksionet komunale të vetëqeverisjes lokale. QPS nuk ka bashkëpunim të mirë me vetëqeverisjen lokale në vendet rurale.

QPS – Prilep ka bashkëpunim të mirë me Ministrinë për punë dhe politikë sociale. Profesionistët e punësuar në QPS kanë inicuar disa iniciativa të caktuara në pjesën e shërbimeve speciale, mirëpo për shkak të mungesës së mjeteve financiare, të njëjtat ende nuk janë realizuar. Bashkëpunimi i QPS – Prilep me Agjencinë për punësim ka të bëjë me shkëmbimin e informatave lidhur me statusin punues të klientëve. Agjencia për punësim nuk ofron punësim për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale.

QPS – Prilep ka realizuar bashkëpunim të mirë me organizatat joqeveritare romë dhe qendrën kulturore rinore. Organizatat joqeveritare romë ju ndihmojnë klientëve gjatë sigurimit të dokumenteve të nevojshme për dorëzim të kërkesës për ndonjë ndihmë të caktuar në para.

Ndihma e qendrës rinore kulturore ka të bëjë me donimet e mjeteve në para dhe veshjeve për nënat e vetme.

Bashkëpunimi i QPS – Prilep me biznes sektorin bëhet përmes donimit të veshjeve, mbulesave dhe artikujve tjerë nga industria tekstile. Nuk kanë bashkëpunim lidhur me punësimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale.

3. Të dhëna nga fokus grupet e organizuara

Gjendja e grupeve të prekshme dhe të varfëra në Komunën e Prilepit u verifikuan me intervistimin e dy fokus grupeve. Njëri fokus grup përbëheshte prej grave të nacionalitetit maqedonas dhe rom, ndërsa tjetri përbëheshte prej burrave të nacionalitetit maqedonas dhe rom.

3.1. Personat e moshuar

Personat e moshuar në Komunën e Prilepit janë të përfaqësuar në një numër të madh. Kushtet shtëpiake të jetesës janë modeste për këtë kategori të personave. Në shtëpitë për pensionerë kushtet e jetesës janë të mira, por kapaciteti nuk është i mjaftueshëm. Personat e moshuar nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të shfrytëzuar shërbimet e shtëpive për pensionerë.

Si problem më i madh me të cilin ballafaqohen personat e moshuar janë mbrojtja shëndetësore dhe mjetet minimale nga ndihma në para e mbrojtjes sociale dhe nga pensionet. Personat e moshuar nëse nuk kanë numër të mjaftueshëm të vjetërsisë në punë nuk mund ta realizojnë të drejtën e pensionit. Gjithashtu, ka më shumë kushte të cilat duhet të plotësohen, që personat e moshuar të realizojnë të drejtat nga sfera e mbrojtjes sociale. Personat e moshuar nuk janë në gjendje që të sigurojnë dokumentet e nevojshme për të bërë kërkesë për ndihmë në para nga mbrojtja sociale. Nëse personat e moshuar nuk e realizojnë të drejtën e pensionit dhe të drejtat nga sfera e mbrojtjes sociale, nuk do të kenë qasje në sigurim shëndetësor.

Shërbimet shëndetësore i paguajnë në plotësi si dhe shumicën e barnave, të cilat nuk janë në listën pozitive të Fondit për sigurim shëndetësor. Duhet të krijohen programe të posaçme për mbrojtje shëndetësore për personat e moshuar. Gjithashtu, këto duhet të lirohen nga participimi për shërbime shëndetësore dhe barna.

Shuma e pensioneve dhe e ndihmës në para nga mbrojtja sociale është minimale dhe nuk i përmbush nevojat kryesore ekzistenciale për personat e moshuar. Si kategori e prekshme mbesin të pambrojtur nga shteti.

3.2. Gra

Gratë në Komunën e Prilepit gjenden si kategori e prekshme. Shkaku më i madh për gjendjen e tillë të grave është papunësia. Gjatë punësimit ndikon politika për shkak të cilës gratë nuk mund të punësohen në institucionet publike. Gratë më së tepërmi janë të punësuar në sektorin privat dhe atë në fabrikat konfekcionuese. Në këto fabrika nuk respektohen të drejtat e grave sipas Ligjit për marrëdhënie pune. Të drejtat nuk respektohen në aspekt të asaj se nuk ka orar të caktuar pune, nuk paguhen orët jashtë orarit të punës dhe rroga është minimale.

Është e rëndësishme për tu cekur se mobingu në fabrikat e konfekcionit është tepër i përfaqësuar. Viktimat nuk e paraqesin mobingun për shkak se nuk mund të gjejnë punë tjetër, ndërsa të ardhurat minimale janë burim i vetëm për ekzistencë. Gratë diskriminohen në tregun e punës për shkak të moshës së tyre.

Kushtet banuese për jetesë janë të mira.

Gratë janë të njoftuara me të drejtat e mbrojtjes shëndetësore, mirëpo për shkak të gjendjes së keqe financiare nuk kanë mundësi që rregullisht ti shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore. Në institucionet publike ka korrupsion. Në QPS ndihma e njëhershme në para jo gjithmonë është e qasëshme për gratë të cilat gjenden në gjendje të keqe shëndetësore. Një përqindje e vogël e grave – viktimat të dhunës familjare nuk e paraqesin dhunën në institucionet kompetente. Si arsye se përse gratë nuk e paraqesin dhunën në institucionet kompetente ceket gjendja e keqe ekonomike dhe çështjet e pazgjidhura të banimit. Në QPS kjo kategori e grave fiton ndihmë dhe mbrojtje të përshtatshme.

3.3. Fëmijë

Për shkak të ekzistimit të varfërisë edhe fëmijët paraqiten si kategori e prekshme në Komunën e Prilepit. Prindërit nuk kanë mundësi që fëmijëve t'ju sigurojnë veshje dhe mjete financiare për tu arsimuar. Në këtë mënyrë fëmijëve ju shkurtohet e drejta e arsimit. Problem tjetër prezent tek fëmijët e moshës shkollore është anëshkalimi edukues nga ana e prindërve. Në arsim, gjithashtu mungon procesi edukues, ndërsa ekziston vetëm procesi arsimues. Në këtë mënyrë fëmijët janë të ekspozuar në rreziqe të ndryshme sociale. Në shkollë është e nevojshme që të zbatohet preventiva sociale dhe edukimi shëndetësor i fëmijëve. Gjithashtu, në shkollë duhet të punësohet një punonjës social. Fëmijët diskriminohen për shkak të pamundësisë së përmbushjes së kushteve për realizim të së drejtës së shtesës feminare të paraparë me Ligjin për mbrojtje feminare. Mjetet nga kjo ndihmë në para janë minimale dhe nuk i përmbushin nevojat kryesore ekzistenciale të fëmijëve. Është e rëndësishme të ceket se në një familje ku ka më tepër se dy fëmijë, shuma totale mujore e shtesës feminare është 2.415 denarë. Fëmijët kur paraqiten si bashkë-shfrytëzues të ndihmës sociale në para dhe nuk kanë të drejtë që të marrin edhe shtesë feminare. Shtesa feminare duhet të jetë e qasëshme për të gjithë fëmijët dhe të drejtën e saj fëmijët duhet ta kenë që në lindje.

Fëmijët me nevoja të posaçme kanë të siguruara kushte të përshtatshme për ndjekjen e mësimin në shkollat e specializuara.

3.4. Personat me nevoja të posaçme

Personat me nevoja të posaçme gjenden në Komunën e Prilepit si një kategori e prekshme. Kjo kategori e personave ka vështirësi në sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e të drejtave nga sfera e mbrojtjes sociale. Mjetet e ndihmës në para të mbrojtjes sociale, nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e nevojave kryesore ekzistenciale të kësaj kategorie të personave. Kushtet për realizimin e ndihmës së përhershme në para në bazë të sëmundjes janë diskriminuese kundrejt personave me nevoja të posaçme. Kushtet për jetesë të kësaj kategorie të personave janë të mira.

Spektori i biznesit privat i keqpërdor personat me nevoja të posaçme, duke mos i respektuar të drejtat e parapara me Ligjin për marrëdhënie pune. Personat me nevoja të posaçme marrin rrogë minimale dhe nuk kanë të siguruara kushte të përshtatshme për punë. Kjo kategori e personave duhet të lirohet nga pagesa e

participimit për shërbimet shëndetësore dhe barnat. Shfrytëzuesite e të drejtave të mbrojtjes sociale kanë sigurim shëndetësore përmes Qendrës për punë sociale. Këto persona janë të kufizuar në shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore për shkak se kartonat e gjelbërt i marrin prej më 15 deri më 20 të muajit.

3.5. Rom

Më e përfaqësuar tek romët është varfëria. Familjet rome nuk mund të sigurojnë mjete financiare për përmbushjen e nevojave kryesore për ushqim, veshje dhe banim. Për shkak të kesaj gjendjeje nuk mund ti arsimojnë fëmijët. Një numër i madh i romëve janë të paarsimuar dhe nuk kanë profesion të formuar, gjë e cila paraqet problem për punësimin e tyre. Romët janë më të përfaqësuar mes shfrytëzuesve të ndihmës sociale në para. Mjetet nga kjo ndihmë në para nuk i përmbushin nevojat kryesore ekzistenciale të këtyre shfrytëzuesve.

3.6. Pakica

Në Komunën e Prilepit, pakica më të përfaqësuar janë tuqit, boshnjakët dhe shqiptarët. Si problem më i shpeshtë me të cilin ballafaqohen pakicat është procedura për marrjen e nënshtetësisë. Pa nënshtetësi nuk mund ti realizojnë të drejtat e përcaktuara me anë të ligjeve.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

352:364(497.7)(047.31)
352:364-22(497.7)(047.31)

ANALIZË e gjendjeve në përfshirjen sociale në nivel lokal. -
Shkup : Institut për të drejtat e njeriut "Lludvig Bolltman", 2011.
- 109 стр. ; 21 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-65251-4-9

а) Локална самоуправа - Социјална заштита - Македонија -
Истражувања б) Локална самоуправа - Стратегии за социјална инклузија
- Македонија - 352:364-22(497.7)(047.31)
COBISS.MK-ID 86753034

